



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.12.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it”.

2. Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, të ndryshuar.”

3. Vazhdimi i shqyrtimit nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar.”

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço dhe Silva Caka.

Të ftuar:

Besmir Beja – Këshilltar në Ministrinë e Drejtësisë

Aulona Mersini - Këshilltare në Ministrinë e Drejtësisë

Ketrin Treska - Drejtoreshë e Përgjithshme në Ministrinë e Drejtësisë

Odeta Fengjilli - Drejtoreshë në Ministrinë e Drejtësisë

Kujtim Luli - Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.

Gianluigi Pratola – Ekspert ndërkombëtar i misionit ndërkombëtar “EURALIUS”

Nita Shala – Eksperte vendase

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi është i mjaftueshëm për të vazhduar me pikat që kemi në rendin e ditës.

Sot do të jetë një ditë e gjatë pune dhe Komisioni i Ligjeve do të punojë në dy seanca, sepse do të mbledhemi edhe në orën 16:00 për të vazhduar me disa projektligje të tjera shumë të rëndësishme, të cilat duhet të kalojnë në seancën e ditës së enjte.

Vazhdojmë me shqyrtimin e çështjeve që kemi sot në rendin e ditës.

Në pjesën e parë të mbledhjes së komisionit do të shqyrtojmë projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it”. Relatori i këtij projektligji është kolegu Jurgis Çyrbja. Komisioni ynë për këtë projektligj është komision përgjegjës.

Çështja e dytë që do të shqyrtojmë është shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, të ndryshuar.” Gjithashtu, komisioni ynë edhe për këtë projektligj është komision përgjegjës.

Në pikën e tretë e rendit të ditës kemi vazhdimin e shqyrtimit nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar.” Komisioni ynë është komision përgjegjës.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës, me shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it”.

Nga Ministria e Drejtësisë kanë konfirmuar pjesëmarrjen...

Besmir Beja - Më falni, zoti kryetar!

Ministrja kishte dëshirë që të ishte e pranishme dhe më njofton se do të vonohet vetëm 5 minuta. A është e mundur që ta presim vetëm 5 minuta?

Ulsi Manja – Nëse bëhet fjalë vetëm për 5 minuta, atëherë le ta presim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Besmir Beja - Ministrja ka shprehur dëshirën që të jetë e pranishme si për pikën e parë, ashtu edhe për pikën e dytë të rendit të ditës.

Ulsi Manja – Atëherë, do ta presim vetëm 5 minuta, jo më shumë.

(Rifillon mbledhja e komisionit pas pushimit.)

Atëherë, vazhdojmë mbledhjen e komisionit me shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it”. Ndoshta ministria do të na bashkohet për projektligjin tjetër. Relatori i këtij projektligji është kolegu Jurgis Çyrbja.

Të ftuar nga Ministria e Drejtësisë kemi zotin Besmir Beja, zonjën Aulona Mersini, zonjën Ketrin Treska dhe zonjën Odeta Fengjilli, drejtoreshë. Nga Prokuroria e Përgjithshme kemi të ftuar prokurorët zotin Kujtim Luli dhe zotin Koça. Nga misioni ndërkombëtar “EURALIUS” të ftuar kemi zotin Gianluigi Pratola, ekspert ndërkombëtar, dhe zonjën Nita Shala, eksperte vendase.

Pa humbur kohë do të vazhdojmë me prezantimin e projektligjit.

Zoti Beja keni fjalën.

Besmir Beja – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it. Kjo marrëveshje është nënshkruar në datën 5 tetor të vitit 2018 nga Ministria e Drejtësisë dhe presidenti i Eurojust-it. Kjo marrëveshje ka si qëllim përmirësimin e bashkëpunimit gjyqësor, si dhe lehtësimin e bashkërendimit të hetimeve dhe të ndjekjeve penale, që shtrihen në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe një ose më shumë shteteve anëtare të Bashkimit Europian. Miratimi i projektligjit është në përputhje me politikat e qeverisë shqiptare, për t’u angazhuar intensivisht dhe në mënyrë të qëndrueshme për goditjen e krimit të organizuar dhe trafikut të qenieve njerëzore, si dhe substancave narkotike, në respekt të plotë të ligjeve të vendit dhe të angazhimeve të saj ndërkombëtare.

Eurojust, si një organizëm i BE-së, i themeluar në bazë të nenit 27/1/c të vendimit të Këshillit të Europës, të datës 28 shkurt 2002, synon luftën kundër krimeve të rënda dhe veçanërisht të tij, bashkërendon të gjitha hetimet kundër formave të rënda të krimit të organizuar, që shtihen në disa shtete dhe ofron mundësinë e krijimit të skuadrave të përbashkëta hetimore, shkëmbimit të informacionit, kryerjes së veprimeve të caktuara procedurale, si dhe ofron mundësinë e financimit të ekipeve të përbashkëta hetimore.

Marrëveshja me Eurojust është një marrëveshje, që do të sjellë një shtysë të re cilësore në kryerjen e hetimeve transnacionale edhe me ndihmën e prokurorit të posaçëm ndërlidhës, i cili, sipas kësaj marrëveshjeje, emërohet dhe atashohet pranë Eurojust-it në Hagë.

Lidhja e marrëveshjes me Eurojust-in do të nxisë bashkërendimin real ndërmjet hetimeve ekzistuese në më shumë se një vend anëtar nëpërmjet shkëmbimit të menjëhershëm të akteve, dokumenteve dhe informacioneve.

Hyrja në fuqi e marrëveshjes me Eurojust-in do t'u mundësojë prokurorëve shqiptarë të forcojnë bashkëpunimin me kolegët e tyre nga vende që e aderojnë në këtë strukturë, duke përfshirë bashkëpunimin me vendet partnere të rajonit si Maqedonia dhe Mali i Zi, si dhe do të rrisë shkëmbimin e informacionit gjyqësor edhe nëpërmjet pranisë së përhershme të një prokurori ndërlidhës në zyrat e Eurojust-it në Hagë. Kjo do të kontribuojë drejtpërdrejt në rezultatet e përbashkëta në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, do të rrisë besimin në kapacitetet tona hetimore dhe do ta sjellë Shqipërinë më pranë BE-së.

Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi me Eurojust-in është një shenjë vlerësimi për përpjekjet e bëra deri tani, por, njëkohësisht, është edhe një inkurajim i fortë për të vazhduar në rrugën e reformave dhe në luftën kundër krimit të organizuar.

Kjo marrëveshje e bën Shqipërinë pjesë të strukturave europiane të angazhuar në luftën kundër krimit të organizuar nëpërmjet hetimeve të përbashkëta ndërmjet vendeve anëtare, duke e trajtuar luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit si çështje të të gjitha vendeve anëtare të BE-së. Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje rritet besimi i autoriteteve gjyqësore të shteteve anëtare të BE-së ndaj autoriteteve gjyqësore shqiptare si partnerë efektivë në luftën kundër krimit të organizuar transnacional dhe terrorizmit.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Beja!

A doni të shpreheni për marrëveshjen zoti Koça, si përfaqësues i Prokurorisë së Përgjithshme, apo jeni dakord? Dakord!

Nga misioni EURALIUS kush e do fjalën? Jeni dakord!

Zoti Çyrbja, ju lutem, keni fjalën.

Jurgis Çyrbja – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozim i Këshillit të Ministrave. Kjo marrëveshje ka si qëllim përmirësimin e bashkëpunimit gjyqësor, si dhe lehtësimin e bashkërendimit të hetimeve dhe të ndjekjeve penale, që shtrihen në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe një ose më shumë shteteve anëtare të Bashkimit European.

Objektivat kryesorë të këtij akti janë, si më poshtë:

a) Fuqizimi i bashkëpunimit në luftën kundër krimeve të rënda, veçanërisht krimit të organizuar dhe terrorizmit.

b) Bashkërendimi dhe financimi i veprimeve hetimore të përbashkëta, njëkohësisht me financim të BE-së, nëpërmjet skuadrave hetimore të përbashkëta.

c) Garantimi i një niveli mbrojtjeje për të dhënat personale të ofruara nga pala tjetër, në respektim të Konventës së Këshillit të Europës, të 28 janarit 1981 "Për mbrojtjen e

individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”, dhe të parimeve të përcaktuara në vendimin e Eurojust-it.

Si përfundim, u kërkoj anëtarëve të komisionit ta votojnë këtë projektligj të rëndësishëm.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Çyrbja!

A ka pyetje nga kolegët? Nuk ka. A ka diskutime? Nuk ka.

Atëherë, hedhim në votim në parim projektligjin.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust-it”.

Kalojmë në shqyrtimin dhe votimin nen për nen të projektligjit.

Neni 1. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. **Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim Nuk ka.**

Miratohet neni 2.

Hedhim në votim në tërësi projektligjin. Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST-it”.

Relatori dhe këshilltari duhet të bëjnë raportin gati për seancën plenare të ditës së enjte.

Sekretare

Klotilda Bushka (Ferhati)

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit

Edlira Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.12.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço dhe Silva Caka.

Të ftuar:

Etilda Gjonaj – Ministre e Drejtësisë

Besmir Beja – këshilltar i ministres së Drejtësisë

Aulona Mersini – këshilltare në Ministrinë e Brendshme

Edis Ibrahimimi – këshilltar në Ministrinë e Brendshme

Katrin Treska – Drejtoreshë e Përgjithshme Rregulltarore e Çështjeve të Drejtësisë

Odetta Fengjilli – Drejtoreshë e Marrëdhënieve me Jashtë në Ministrinë e Brendshme

Kujtim Luli – prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.

Gianluigi Pratola – ekspert ndërkombëtar

Nita Shala – eksperte vendase

Ulsi Manja – Vazhdojmë me shqyrtimin nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për një shtesë në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar”.

Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relator i këtij projektligji është kolegu Adnor Shameti.

Nga Ministria e Drejtësisë kemi prezent në shqyrtimin e këtij projektligji ministren e Drejtësisë, zonjën Etilda Gjonaj së bashku me stafin që e shoqëron.

Nga Prokuroria e Përgjithshme kemi të ftuar zotin Kujtim Luli, prokuror.

Nga Misioni EURALIUS kemi të ftuar zotin Gianluigi Pratola, ekspert ndërkombëtar dhe zonjën Nita Shala, eksperte vendase.

Ne e kemi kaluar në parim projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar”. Gjatë kësaj kohe relatori dhe grupi i punës kanë punuar me projektligjin, ku janë implemetuar komente dhe sugjerime të bëra nga aktorë të përfshirë në diskutimin e këtij projektligji, si Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, misioni EURALIUS dhe Avokati i Popullit. Zoti Shameti, besoj se kemi rënë dakord për të vazhduar me shqyrtimin nen për nen të këtij projektligji.

Zonja Ministre, mirëserdhe në komision.

Përpara se të fillojmë shqyrtimin nen për nen, zonja Ministre, a keni ndonjë gjë për të shtuar për projektligjin?

Etilda Gjonaj – Në fakt, janë bërë disa diskutime lidhur me projektligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Por ajo që unë kam theksuar, edhe në momentin kur ky projektligj është miratuar në parim, është shumë e rëndësishme për të kuptuar se përse është i nevojshëm ky regjim për kufizimin e disa të drejtave të personave që kanë lidhje me grupet kriminale, krimin e organizuar dhe organizatat terroriste, për faktin e problematikës që ne kemi pasur dhe kemi hasur në praktikë, jo vetëm nga shërbimet e brendshme të sistemit të burgjeve, por edhe nga shërbimet informative kombëtare dhe nga ato të huajat. Ky ligj ka filluar zbatimin e tij të parë në Itali, kur grupe kriminale të caktuara vinin në rrezikshmëri jo vetëm veprimtarinë apo sigurinë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, por edhe për shkak se vazhdonin lidhjet me organizatat jashtë për të zhvilluar veprimtarinë e tyre të jashtëligjshme.

Ajo për të cilën ne kemi pasur diskutime, unë kam pasur mundësi të lexoj edhe opinionin e EURALIUS-it, ka të bëjë me faktin se cili do të jetë ai që do të japë vendimin për këta elementë kriminalë, të cilët kanë lidhje ose kanë qenë pjesë e organizatave me rrezikshmëri të lartë kriminale: ministri apo gjykata. Në rastin konkret, kur e kemi parë si propozim, kemi thënë që duhet të jetë gjykata, në mënyrë që të mos i lihet një deskrecion shumë i madh ministrit për të vendosur regjimin e kufizuar për elementët kriminalë. Pra, të jetë gjykata, e cila, mbasi shqyrton të gjitha informacionet që vijnë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nga prokurori i SPAK-ut apo nga Ministria e Brendshme së bashku me të gjitha strukturat si Policia e Shtetit apo struktura të tjera informative, të vendosë për këtë regjim të posaçëm dhe nëse subjekti duhet të qëndrojë në këtë regjim me të drejta të kufizuara. Këtë do të doja ta merrnit edhe ju në konsideratë për ta vlerësuar.

Ne e kemi menduar në këtë mënyrë, pavarësisht se modeli Italian e parashikon që të jetë ministri i Drejtësisë. Kjo është bërë që mos i lihet aq deskrecion vendimmarrës ministrit për të vendosur nëse ky element kriminal duhet të vendoset në një regjim specifik ose jo.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Ministre!

Besoj që relatori do të ndjekë dinamikën e shqyrtimit të projektligjit nen për nen dhe aty ku dikush kërkon të bëjë komente, ju lutem mund të ndërhyni.

Po, zoti Shameti!

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Përpara se të kalojmë tek analiza dhe miratimi nen për nen i këtij projektligji të rëndësishëm, dua të bëj një përmbledhje të ndryshimeve që kemi paraqitur me grupin e punës nga varianti origjinal i parashikuar dhe i sjellë në komision nga qeveria.

Që në miratimin në parim të këtij projektligji, ne kemi shprehur rëndësinë dhe mbështetjen për nismën ligjore që është propozuar. Ajo çfarë është e rëndësishme është se të gjithë pjesëtarët në grupin e punës morën kohën e nevojshme për pasqyrimin e ndryshimeve që ishin të domosdoshme dhe për miratimin e këtij ligji. Sikurse e thashë edhe në seancën e parë kur vendosëm miratimin në parim të projektligjit, është një vijë e hollë që ndan antikushtetutshmërinë nga respektimi dhe garantimi i të drejtave kushtetuese të shtetasve. Në këtë kuptim të gjithë duhet të jemi të kujdesshëm në atë variant përfundimtar që kalojmë në prezantimin dhe bërjen efektive të këtij regjimi të posaçëm për një grup të kufizuar subjektësh të posaçme.

Dua të theksoj se në riformulimin që u kemi bërë të gjitha elementeve të projektligjit, i kemi parashikuar këto ndryshime:

Së pari, propozohet që regjimi i posaçëm të vendoset vetëm në rastet e jashtëzakonshme në përputhje me parashikimet e standardeve ndërkombëtare dhe në veçanti me nenin 41 bis të ligjit italian, sipas të cilit është hartuar edhe ky projektligj.

Së dyti, në grupin e neneve të veprave penale, për të cilat parashikohet vendosja e këtij regjimi, sipas propozimeve të ardhura nga Prokuroria e Përgjithshme, propozohet të shtohen disa vepra penale të tjera për grupet me rrezikshmëri shoqërore të lartë, që janë nenet 79, shkronjat “a” “b” “ç”, dhe 284 paragrafi 3 i Kodit Penal.

Përse e them këtë në parantezë? Është shumë e rëndësishme ta them, sepse konteksti në të cilin neni 41 bis i ligjit italian është kaluar, ka në vetvete elemente të këtyre dispozitave që ne kemi shënuar këtu. Për shembull, vrasja e Falkones dhe Borsellinos, për ta bërë më të qartë për publikun dhe anëtarët e komisionit, pra, dispozita, të cilat nuk ishin parashikuar në variantin origjinal të qeverisë.

Nga ana tjetër propozohet që vendosja e regjimit të posaçëm të bëhet me vendim të ministrit të Drejtësisë për kërkesën e arsyetuar të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, pas konsultimit me ministrin e Brendshëm, bazuar në të dhënat dhe informacionet e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Shërbimeve Informative, drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe organeve të specializuara në luftë kundër krimit të organizuar, terrorizmit, sipas fushave të përgjegjësisë.

Me propozim të Avokatit të Popullit është bërë shtesa: “Kufizimi i bisedave telefonike nuk aplikohet në rastin e komunikimeve me institucionin e Avokatit të Popullit”. Kjo është marrë në konsideratë dhe është pasqyruar.

Gjuha origjinale e ligjit italian 41 bis, shqetësim që edhe ministria e shprehu, ngarkon ministrin e Drejtësisë si autoritet vendimmarrës, por varianti përfundimtar i paraqitur përpara komisionit sot është: “Ministri i Drejtësisë është autoriteti vendimmarrës për vendosjen e regjimit të posaçëm ndaj një individi”. Në rastin e caktimit të regjimin e posaçëm ndaj një individi, por edhe kur kërkohet zgjatja e afatit për regjimin e posaçëm, kemi përcaktuar që i dënuari, i paraburgosuri apo mbrojtësi i tij kanë të drejtë ta ankimojnë vendimin në gjykatë brenda një afatit 20-ditor. Prandaj ne nuk cenojmë rregullin e përgjithshëm, përkundrazi kemi vendosur edhe një filtër më përpara rrugës gjyqësore.

Sipas modelit 41bis të ligjit italian, propozohet që koha e qëndrimit në ajrim në mjediset e hapura, por edhe sipas Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe raportet periodike të institucioneve ndërkombëtare, të jetë deri në dy orë, por jo më pak se 1 orë në ditë.

E fundit propozohet që kërkesa ankimore kundër vendimit të ministrit të Drejtësisë për vendosjen apo zgjatjen e regjimit të posaçëm të bëhet në Gjykatën e Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, që është specifike, e cila zgjidh çdo ambiguitet në lidhje me kompetencën për sa më sipër.

Ne kemi ardhur me një variant integral të dakordësuar nga të gjithë pjesëmarrësit e grupit të punës, nga Prokuroria e Përgjithshme, EURALIUS-i, Ministria e Drejtësisë, Avokati i Popullit e të tjerë.

Ulsi Manja – Zoti Shameti, kam një pyetje Komisioni i Sigurisë ka qenë komision për dhënie mendimi, a e ka përpiluar raportin dhe a e ka sjellë pranë komisionit? E keni administruar ju si relator? Çfarë sugjeron Komisioni i Sigurisë për ne?

Adnor Shameti – Zoti kryetar, të gjitha sugjerimet e Komisionit të Sigurisë, si komision për dhënie mendimi, janë reflektuar në variantin përfundimtar integral të miratuar dhe kemi gjetur dakordësinë për këto...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kopjen duhet ta keni aty bashkëngjitur.

Ulsi Manja – Relatori i ka bërë pjesë integrale.

Adnor Shameti – Zoti Hyseni, i kam bërë pjesë integrale, prandaj janë brenda të gjitha.

Ulsi Manja – Fjalën e ka zoti Fino,

Bashkim Fino – Faleminderit, kryetar!

Faleminderit ministrit dhe përfaqësuesve!

Arsyetimi që bëri relatori m'u duk shumë interesant, por kam përshtypjen se nuk e kam kuptuar unë drejt, mbase ai ka të drejtë. Në atë çfarë lexoi relatori, rezulton që është ministri i Drejtësisë është ai që merr vendimin për regjimin e posaçëm, në burgun e sigurisë së lartë, mbi kërkesën e arsyetuar të drejtuesve të Prokurorisë së Posaçme, që do të thotë e lë në dëshirën time si ministër nëse është e arsyetuar apo jo kjo kërkesë, sepse mund të jetë një kërkesë që e gjykoj të paarsyetuar. Pra kush e zgjidh çështjen nëse është e arsyetuar apo jo? E para.

E dyta, ministri e merr këtë vendim dhe më pas mund të ankoresh në gjykatë.

Kam përshtypjen se është një ndërthurje e modelit italian dhe modeleve të tjera, ashtu siç e ka paraqitur relatori, pra nuk ka një ndarje të mirëfilltë. Regjimin e posaçëm të burgut të sigurisë nuk e merr as drejtori i burgjeve dhe as Ministria e Drejtësisë, por e vendos gjykata dhe vazhdon. Në këtë relacion na del që e vendos ministri dhe unë jam dakord që të jetë kështu dhe është shumë mirë, por duhet rregulluar çështja e kërkesës së arsyetuar, sepse

me këtë kërkesë mua më lind dyshimi që në një moment të caktuar një kërkesë që e bën prokuroria, ministri e gjykon ose jo. Prandaj kjo duhet të zgjidhet. Ose të thuhet: “Me kërkesë të prokurorisë” e të tjera, sepse, kur thua: “Të arsyetuar”, eja ta ndash nëse është e arsyetuar, e paarsyetuar apo ka elemente të tjera.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Të nderuar kolegë, me pyetjen e kolegut Fino jemi futur në shqyrtimin e nenit 1, sepse projektligji ka 2 nene. Pra, jemi në shqyrtimin dhe diskutimin e nenit 1.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka problem mund të vazhdoni me pyetje. Për shqetësimin e zotit Fino çfarë mendimi ka relatori?

Adnor Shameti – Faleminderit, zori kryetar!

Gjuha që përmban ky paragraf “për kërkesë të arsyetuar”, nënkupton që dosjen për kërkesën, si për ministrin e Drejtësisë, ashtu edhe për Gjykatën e Krimeve të Rënda, e mbledh dhe e harton prokurori i SPAK-ut. Kjo do të thotë që ministri vetëm vendos mbi bazën e të gjitha të dhënave të dosjes së ardhur nga prokurori. Ky është kuptimi i këtij formulimi. Pra, dosjen dhe materialet provuese për të arsyetuar kërkesën e bën prokurori i SPAK-ut, mbi bazën e të gjitha të dhënave nga personat që parashikohen në këtë dispozitë dhe ministri vepron mbi bazën e këtyre të dhënave. Pra, nuk është një kërkesë e thatë që ne kërkojmë të vihet personi në regjim të posaçëm dhe ministri fillon të bëjë hetimin administrativ e të mbledhë provat, por dosja i shkon e bërë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shameti!

A ka pyetje të tjera? Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë jam i shqetësuar dhe mendoj se duhet të sqarojmë disa terma, sepse edhe vetë relatori, por edhe ministrja e pranuan që ekuilibri është shumë i brishtë në këtë ligj, prandaj duhet të jemi të kujdesshëm.

Meqenëse në ligjin aktual nuk specifikohet dhe nuk gjen rregullim, unë dua të më jepni një përgjigje se çfarë nënkuptojmë me raste të jashtëzakonshme? Është një rregullim që është bërë në draftin që po paraqitet sot, por duhet të kemi parasysh se në praktikën e jurisprudencës këta terma janë shumë delikate dhe kanë shkaktuar probleme. Asnjë ligj nuk është i keq, por e keqe është mënyra se si zbatohen ligjet. Çfarë kuptojmë me raste të jashtëzakonshme, sepse kjo nuk gjen rregullim në këtë ligj dhe unë kërkoj një shpjegim? E para.

E dyta, kam një shqetësim parimor, a mundemi ne me një ligj të thjeshtë, sado të legjitimuar ta kemi nevojën për këtë ligj, të tejkalojmë kërkesa apo kushtëzime të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, apo edhe për parime kushtetuese?

Zoti Shameti, mbaj shënim që të përgatitesh mirë.

Për të parën po të bëj një ilustrim, në germën “b” të pikës 4 ju thoni: “...për persona të paraburgosur autorizohet me vendim të arsyetuar të prokurorit”, pra bëhet fjalë për mbajtjen nën përgjim. Lexoni Kodin e Procedurës sesi është rregulluar në variantin tuaj, atë që keni paraqitur si propozim për riformulim. E para.

E dyta, në fund të pikës 8 te nenit 2 “Për ndryshim”, çfarë nënkuptoni me faktin që, pasi vendos gjykata, ministri vendos bazuar në vendimin e gjykatës dhe në kushtet e kriteret ligjore që parashikon ky nen? A kemi ne tagër të kapërcejmë vendimin e gjykatës? Unë mendoj ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lërimi këto, zoti Shameti.

Ulsi Manja – Të lutem, mund të vazhdoni me pyetjet.

Alket Hyseni – Unë e kuptoj që ka një shqetësim real, jo vetëm nga ministria, por edhe nga opinionimi publik që këta persona duhet të vendosen në regjim të posaçëm, sepse shkaktojnë prishje të rendit dhe sigurisë publike edhe kur janë në regjimin e sigurisë. Por cili është modaliteti? Ejani ta gjejmë bashkë se për këtë punë jemi këtu. Prandaj e bëra pyetjen, a mundemi ne me këtë ligj të bëjmë këtë rregullim? A biem ndesh me parimet, konventat dhe me ligjet e cilësuar që kemi miratuar? Kjo është pyetja.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Ky projektligj ka 2 nene. Neni 2 ka të bëjë me hyrjen në fuqi, prandaj pyetjet janë vetëm për nenin 1, prandaj mendoj t’i adresojmë të gjitha pyetjet, sepse mund të jenë me të njëjtën problematikë dhe pastaj të ketë përgjigje për të gjitha pyetjet.

Zoti Shameti si relator, por edhe përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme, ministrisë dhe EURALIUS-it mund të ndërhyjnë për të dhënë përgjigje të caktuara.

Zonja Hysi e ka kërkuar fjalën.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë dua të di se cila është arsyeja që kohëzgjatja e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave në burgun e sigurisë së lartë nuk ka një afat, por lidhet vetëm me një shprehje, “me arritjen e qëllimeve të percaktuara në këtë pikë”? Ky është një propozim që e ka pasqyruar relatori.

E dyta, një person që qëndron në këtë regjim, a ka të drejtë të komunikojë me Avokatin e Popullit, me SCPT-në dhe me organizatat e të drejtave të njeriut? Nëse po, këto biseda telefonike, kontakte do të jenë pjesë e totalit të bisedave të lejuara, apo do të jenë shtesë? Kam parasysh këtu rregullat europiane të burgjeve të miratuara në vitin 2006, por edhe praktikën e CPT-së, të cilat lejojnë të gjitha institucionet, si CPT-ja, Komisioni European për Parandalimin e Torturës, Avokati i Popullit dhe organizatat e shoqërisë civile, që monitorojnë burgjet, të hyjnë pa asnjë kufizim dhe nuk mund të monitorohet as korrespondenca dhe as komunikimi me ta.

Gjithashtu, në ligj thuhet se kalimi i kohës në vetvete është një element i mjaftueshëm për të përjashtuar afërsinë e të dënuarit me regjim të posaçëm. Çfarë është dashur të thuhet me këtë “kalimi i kohës”? Unë e vlerësoj se ka shumë rëndësi që lidhjet e botës së krimit të personave me rrezikshmëri të lartë kriminale që gjenden sot në paraburgim, ose në burgje, ose që mund të jenë në të ardhmen, me grupet kriminale jashtë duhen prerë, por nga ana tjetër duhet të kemi parasysh Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, rregullat europiane të burgjeve dhe praktikën më të mirë të CPT- së në këtë fushë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – A ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Alket Hyseni – Zoti relator, sapo na u vu në dispozicion rekomandimi i Komisionit për Sigurinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Relatori tha që janë pasqyruar, por nuk përputhen fare me atë që kemi.

Ulsi Manja - Zoti Shameti, ju e keni parë projektligjin edhe nga këndvështrimi i avokatit, edhe profesor i së drejtës procedurale, prandaj unë kam besim në shpjegimet tuaja.

Adnor Shameti - Ajo që duam të realizojmë sot është që të mos kemi raste të suksesshme nga aplikantët në Strasburg, të paktën për pjesën e asaj që shkruajnë ata, sepse pjesa e zbatimit në praktikë mbetet një gjë tjetër, por të paktën për atë që është e shprehur në ligj, sikurse është te neni 41 bis, në variantin italian të ligjit, të mos kemi histori me Strasburgun.

Dua të siguroj të gjithë anëtarët e komisionit dhe mbi të gjitha zotin Hyseni, për shqetësimin e ligjshëm dhe të drejtë që ka, që unë e vlerësoj shumë, se është respektuar kushtetutshmëria dhe harmonia me Kodin e Procedurës Penale.

Nga ana tjetër, në lidhje me elementet, më tepër unë i shikoj si sugjerime të zonjës Hysi, se si pyetje, siç e kuptova, dua t’ju siguroj se varianti i azhornuar, i paraqitur sot për miratim, sjell praktikën më të mirë të organizatave ndërkombëtare, raporteve periodike të tyre

që monitorojnë respektimin e lirive dhe të drejtave të të dënuarve ose të paraburgosurve nga njëra anë, si dhe praktikën më të mirë të Strasburgut nga ana tjetër.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Zonja Ministre, a keni ndonjë gjë për të shtuar në lidhje me shqetësimet e kolegëve?

Etilda Gjonaj – Unë bashkohem me shqetësimin e zotit Hyseni sa i përket shprehjes “në raste të jashtëzakonshme”. Nëse e vendosim “në raste të jashtëzakonshme”, atëherë lihet një diskrecion në zbatim. Cili është rast i jashtëzakonshëm? Pra, togfjalëshi “në raste të jashtëzakonshme” që, në fakt, në propozimin e qeverisë nuk ka lënë vend dhe abuzim për mënyrën e zbatimit, nëse ne themi “në raste të jashtëzakonshme” atëherë do të duhet në çdo rast ose gjykata ose ministri i Drejtësisë të vendosë se cili është rasti i jashtëzakonshëm. Nëse ne parashikojmë grupin e dispozitave ligjore dhe veprave penale për të cilën personat janë dënuar dhe kanë qenë në kuadër të një veprimtarie kriminale ose terroriste, atëherë nuk është e nevojshme që të vendosim “në raste të jashtëzakonshme”. Ta bëjmë më të qartë dispozitën, që të mos lëmë shteg për abuzim në zbatim.

Sa u përket organizatave të të drejtave të njeriut, do të zbatohet regjimi i zakonshëm nëse ata do të duan të komunikojnë me Avokatin e Popullit, korrespondenca e tyre nuk do të përgjohet, pra do të respektohen standardet ndërkombëtare.

Nëse bëhet fjalë që ata duan të bëjnë një telefonatë me Avokatin e Popullit në protokollet e brendshme që ne po punojmë për zbatimin e këtij regjimi të posaçëm, do të jetë pikërisht një dispozitë, ku do të vendoset që përpara se i paraburgosuri, i vendosur në këtë regjim të posaçëm, të bëjë një telefonatë, duhet të deklarojë se kë do të marrë në telefon. Nëse thotë se do të marrë Avokatin e Popullit, ose organizmat ndërkombëtarë, numrat janë të afishuara dhe ai do të lejohet përtej këtij regjimi të kufizuar, të posaçëm. Pra, do të jetë në pjesën e protokolleve zbatuese. Do të ishte e tepërt ta vendosim në këtë dispozitë pasi ne në të gjitha parashikimet ligjore mbajmë në konsideratë standardet ndërkombëtare, të cilat në asnjë rast nuk do të shkelen dhe do të jenë pjesën e protokolleve dhe rregulloreve të këtij regjimi të posaçëm që do të zbatohet.

Ulsi Manja- Përfaqësuesi i misionit EURALIUS, a keni diçka për të shtuar?

(Zoti Patrola flet anglisht)

Gianluigi Pratola (përkthen përkthyesja) - Zoti Pratola, filloi të shpjegonte togfjalëshin “në raste të jashtëzakonshme”. Informoi që e kemi diskutuar edhe në grupin e punës çështjen nëse duhet përdorur ky togfjalësh “në raste të jashtëzakonshme” ose një sinonim i tij i mundshëm “në raste të veçanta” dhe duke marrë parasysh veçantinë e këtij

sistemi dhe faktin që duhet të aplikohet “në raste të jashtëzakonshme” është dakordësuar me grupin e punës që të përdoret kjo fjalë. Duhet marrë parasysh që duhet ndjekur edhe shembulli italian, aplikimi nuk bëhet për të gjithë pjesëtarët e një grupi të organizuar kriminal, por vetëm në raste shumë të jashtëzakonshme me personat që janë vetëm në strukturat më të larta të një grupi kriminal të organizuar.

Sa i takon pikës 8, zoti Pratola sqaron se paragrafi në fjalë është marrë nga praktika italiane dhe ideja e këtij paragrafi është të specifikojë në rast të një subjekti të veçantë për të cilin është dhënë vendimi që të jetë në regjim të posaçëm, vetëm në rast se dalin prova të reja ose fakte të reja që nuk janë vlerësuar nga gjykata, ministri ka diskrecionin. Vendimi i gjykatës është i pakontestueshëm.

Çështja e fundit për të cilën u shpreh zoti Pratola, ka të bëjë me pikën 2 të nenit lidhur me vendimin dhe faktin që është dakordësuar me grupin e punës që të merret nga ministri i Drejtësisë.

Zoti Pratola do të sqarojë dhe të theksojë që ky është një akt administrativ dhe një mënyrë e mirë që të jepet me urdhër ministri.

Një faktor tjetër i rëndësishëm është me vendimdhënie. Brenda në ministri mund të krijohet një komision, që mund të formalizojë këtë proces, por i qëndron besnik mendimit që duhet të vijë nga niveli qendror, nga ministria dhe të jepet në formë urdhri me qëllim unifikimi.

Një pikë e fundit që dua ta theksoj është që aplikimi i këtij regjimi duhet të jetë shumë i limituar, madje duhet të jemi shumë të kujdesshëm në aplikimin e tij, sidomos për shkak të rrezikut që kemi në shkeljen e të drejtave të njeriut dhe vendimeve që do të vinin nga Strasburgu për këto raste. Për këtë arsye është shumë e rëndësishme dhe ne jemi munduar dhe e kemi theksuar, thotë zoti Pratola, në takimet e grupit të punës që në rastet kur do të merret vendimi për dhënien e një urdhri të tillë, duhet bërë një vlerësim shumë i thellë, shumë i detajuar, dhe duhet vlerësuar e gjithë situata dhe individi në fjalë nuk duhet lidhur me kryerjen e një vepre penale të veçantë, por duhen vlerësuar një seri faktorësh për identifikimin e këtyre rasteve vërtet të veçanta për t’iu dhënë kjo masë.

Ulsi Manja- Po, fjalën e ka përfaqësuesi i Avokatit të Popullit.

Ermonela Xhafa - Marr shkas nga çfarë evidentoi përfaqësuesi i EURALIUS-it. Një nga pikat që ne e kemi diskutuar në seancën me relatorin ishte çështja e vendimmarrjes për vendosjen e regjimit të posaçëm, pra nuk është përcaktuar afati i efektshmërisë së këtij vendimi.

Gjej rastin të falënderoj shumë zonjën Hysi, e cila ngriti një pikë të cilën ne jemi munduar me të gjitha mënyrat ta sjellim në vëmendje, madje ta vendosim në këtë ligj komunikimin me Avokatin e Popullit, ose avokatët mbrojtës, përfshirë dhe organizmat e tjerë.

Një nga pikat që ne kemi shqetësim është përcaktimi brenda këtij projektligji, cili do të jetë organi që do të nxjerrë aktet nënligjore. Pra, më saktë nuk është përcaktuar nëse do të nxirren akte nënligjore dhe cili është organi që do të nxjerrë këto akte nënligjore, përfshirë edhe rehabilitimin e këtyre njerëzve. Ne mbështesim fort që mafia të luftohet, por duhet të kemi parasysh që këta janë njerëz dhe duhen nxjerrë akte nënligjore ose akte të tjera protokollare, siç e përmendi edhe zonja ministre, në riintegrimin e tyre, në përfshirjen e tyre në aktivitete sociale.

Një pikë tjetër që desha të evedentoja është se nuk lexohet asgjëkund në relacion nëse ka një kosto financiare ky ligj.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Etilda Gjonaj– Unë e kuptoj shqetësimin e zotit Pratola si përfaqësues i misionit EURALIUS, por në modelin italian nuk janë të përcaktuara dispozitat konkretisht ashtu siç ne i kemi përcaktuar në këtë propozim, me gjithë shtesat që Prokuroria e Përgjithshme ka bërë, që absolutisht i vlerësoj, sepse do të ishte shumë mirë të ishin pjesë e projektligjit në finale. Modeli italian nuk i ka të përcaktuara dispozitat ku të thuhet që këta persona që janë përfshirë në organizata kriminale, por që dënohen në bazë të neneve 79/b, 230, e me radhë do të jenë pjesë e këtij regjimi të posaçëm. Kjo është arsyeja pse në modelin italian është vendosur shprehja në raste të jashtëzakonshme. Ne për të mos lënë shteg abuzimi, vendosëm në mënyrë eksplicite dispozitat kur një subjekt i kryen veprat penale në kuadër të një strukture kriminale të organizuar.

Së dyti, çfarë do të ndodhë nëse ministri i Drejtësisë nuk pranon propozimin e prokurorit të posaçëm për vendosjen në një regjim të posaçëm? Zoti Fino, e ngriti me të drejtë shqetësimin e tij në lidhje me këtë problem, pra çfarë do të bëjë ministri nëse do të vijë një kërkesë e arsyetuar nga drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, por merr vendimin që të mos e vendosë në një regjim të posaçëm? Pra, duhet të ekzistojnë ose të riformulohet çfarë është vendimi i arsyetuar ose t’ia lëmë gjykatës që të vendosë në bazë të të gjitha informacioneve që i vijnë dhe në bazë të kërkesës procedurale, që prokurori i posaçëm do të bëjë në gjykim, lidhur me vendosjen në një regjim të posaçëm të këtyre subjekteve. Pra, ideja është që ministrit të Drejtësisë të mos i lihet një fushë e gjerë diskrecionale për të vendosur. Këtë e them edhe nga eksperiencia. Për shembull, kur ministri i Drejtësisë disponon vendimin për

ekstradime, janë shumë mirë të përcaktuara kriteret edhe në Kodin e Procedurës Penale. Mundësia e gabimeve është shumë e vogël dhe minimale.

Sa i përket komentit të përfaqësuesit të Avokatit të Popullit, unë do të thosha se në propozimin tonë fillestar ka qenë që ky regjim i posaçëm të jetë për një afat kohor 1-vjeçar. Pas një viti me kërkesë të të dënuarit, të rishikohet mundësia nëse vazhdojnë të ekzistojnë elementet e rrezikshmërisë që ky subjekt të qëndrojë përsëri në një regjim të posaçëm, ose duhet të largohet nga aty. Periudha kohore, si edhe në modelin italian, pavarësisht se ndryshon në afate, sepse ata kanë vendosur 2, ne kemi vendosur 1, të jetë përsëri në këtë projekt propozim.

Ulsi Manja- Faleminderit!

A ka propozime konkrete për nenin1?

Kujtim Luli – Ky ligj duhet të kalojë, është shumë i rëndësishëm, mund të bëjmë ndonjë përmirësim, ndonjë saktësim. Unë mendoj që dy janë mekanizmat, ose saktësohet në përkufizim termi raste e jashtëzakonshme, që të ndihmojë dy elemente, të drejtat dhe liritë e njeriut, por edhe ministri t'i ketë të kornizuar gjërat, të mos gjendet në presion ligjor nga njëra anë, por edhe presion personal nga kërkuesi në raste të tjera. Fryma e ligjit është kufizuar në informacione ose prova të arsyeshme, që mendohet se këto kategori personash ose vazhdojnë aktivitetin në kuadër të organizatave kriminale, krimit të organizuar dhe terrorizmit, ose elementi i dytë është cenimi i rendit dhe sigurisë publike. Pra, të kemi një përkufizim. Nuk duhet lënë kështu abuzive. Unë mendoj se jemi larg. Hajdeni të bëjmë një formulim, pa dalë nga qëllimi, edhe ruajmë termin, edhe e formulojmë.

Së dyti, sa u përket afateve, duhet të përcaktojmë një afat , që t'i lëmë të drejtë ministrit që në kalim të këtyre afateve, nëse e gjykon që duhet shtyrë, ta rimarrë vendimin. Nuk e gjen asgjë një ministër që të dalë me një akt të dytë. Pra, ne themi 6 muaj dhe mbas 6 muajsh, nëse gjykohet situata mund të rimarrë vendimin. Këto besoj se janë të domosdoshme për të bërë një ligj, të cilin nuk do të na e kundërshtojnë dhe nuk do e na e hedhin as Gjykata Kushtetuese kur të vijë apo juridiksioni ndërkombëtar i të drejtave të njeriut.

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Hyseni!

Zoti Braho, ka një koment.

Spartak Braho – Ajo që më bën përshtypje nga përvoja ime është se rrallë herë kemi dëgjuar që ministria apo ministrat të jenë kaq të kujdesshëm në këtë çështje. Prandaj para se ta votojmë do t'ju lutesha ta dëgjojmë të formuluar. Nëse këtë gjë do ta bëj Adnori apo ministrja leximin nuk e di, por dua që të na e dëgjoj veshi.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Braho!

Mua më duket që thelbi i këtij ligji është tjetër gjë, jemi duke folur për një projektligj që kërkon të ndryshojë regjimin e trajtimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve të vendosur në një regjim të posaçëm të sigurisë së lartë me vendim gjykate. Pra, alfa dhe omega është vendimi i gjykatës, kemi një vendim gjykate në mes që në krye të herës. Për çfarë e kemi? E kemi për organizatë kriminale, për bandë të armatosur dhe për grup të strukturuar kriminal. Çfarë kërkohet? Kërkohet që individi, duke qenë nën këtë regjim të sigurisë së lartë, po të doni quajeni të posaçëm, kërkon t'i ndryshohen nëpërmjet një akti administrativ kushtet e trajtimit ose më saktë t'i kufizohen disa të drejta që kanë të bëjnë me regjimin e ajrimit, me komunikimin jashtë institucioni, me familjarët, me Avokatin e Popullit e kështu me radhë.

Çfarë propozohet? Në raste të jashtëzakonshme, unë i mirëkuptoj kolegët për shqetësimin se cili do të konsiderohet rast i jashtëzakonshëm. Te pika 2 e nenit 1, këto janë agjencitë e shtetit, drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, ministri i Brendshëm, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Shërbimi Informativ Shtetëror, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe organet e specializuara në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit që bëjnë një vlerësim të situatës. Për ta materializuar kërkesën hyn në lojë drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, i cili me një vendim të arsyetuar, pasi ka mbledhur gjithë informacionin nga agjencitë ligjzbatuese të shtetit, i propozon ministrit të Drejtësisë nxjerrjen e një akti administrativ për vendosjen e iksit në një regjim të posaçëm trajtimi. Ministri i Drejtësisë ka disrecion, e refuzon, por edhe e pranon. Në të dyja rastet ka një ndryshim, kur e refuzon nuk besoj se ka ankim, mbaron, akt administrativ, në momentin që ministri thotë jo, por në momentin që ministri disponon këtë akt administrativ për të kufizuar përkohësisht në raste të jashtëzakonshme, është gjykata, së cilës i garantohet e drejta e ankimit nëpërmjet këtij akti administrativ, subjektit.

Sipas meje është treguar kujdes në hartimin e këtij projektligji, sepse ai tehu është shumë i hollë, këtu bashkohem me shqetësimin e të gjithë kolegëve, të zotit Braho, të zotit Hyseni, të zotit Fino, zonjës Hysi e kështu me radhë. Pra, bëhet fjalë për persona me rrezikshmëri të lartë shoqërore, të cilët edhe pasi kanë marrë një vendim gjykate, qoftë dënimin, qoftë vendosjen në paraburgim, e vazhdojnë aktivitetin kriminal, vazhdojnë të prodhojnë pasoja jashtë atij regjimi burgu. Sigurisht, duke u nisur nga ky shqetësim që ka sot Shqipëria, kemi ardhur në këtë propozim për ndryshimin e këtij projektligji.

Nëse këtu do të bëjmë të gjithë kalorësin e mbrojtjes të të drejtave dhe lirive të njeriut, sigurisht që ky projektligj nuk do të miratohet. Po t'i shkojmë standardit, edhe unë që jam pjesë e kësaj tryeze, patjetër them që sa herë ka kufizime të të drejtave dhe lirive do të

ketë debat, por ama duhet të jemi koshientë për pasojat që prodhohen sot nga këto institucione. Ndoshta është mangësi jona, mangësi e shtetit, sepse në finale është përgjegjësi e shtetit, por edhe ky projektligj vjen në këtë formë që ne po diskutojmë, sigurisht për t'i dhënë zgjidhje shqetësimit që kemi. Për mendimin tim është punuar mirë me projektligjin, nuk e di, pasi këtu u ngrit problemi për ta kufizuar rastin e jashtëzakonshëm. Fjalën “i jashtëzakonshëm” përkufizojeni si të doni, por në rast se ministri i Brendshëm, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, drejtori i Shërbimit Informativ, drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve dhe të gjitha agjencitë e tjera bëjnë një vlerësim të situatës dhe i thonë Prokurorit të Posaçëm: “Zoti prokuror, në vlerësim të situatës, të gjendjes së kriminalitetit në terren ne kemi të dhëna të besueshme se iks subjekt nga institucioni i vuajtjes së dënimit iks vazhdon veprimtarinë kriminale. Ne kërkojmë që nëpërmjet jush t'i drejtoheni ministrit për të nxjerrë një akt administrativ”. Ka hyrë në lojë edhe ministri, sigurisht për shpejtësi dhe për t'i dhënë një zgjidhje të shpejtë problemit, sepse në qoftë do të futej gjykata në mes, patjetër që do të respektoheshin të gjitha standardet që ka Kodi i Procedurës Penale. Ndërkohë këtu, ndaj këtij akti administrativ, ne kemi lejuar të drejtën e ankimit në gjykatë.

Ndaj, të nderuar kolegë, për të gjitha këto që sapo ju thashë, pasi edhe unë kam shqetësimin tim, mendoj ta hedhim në votë nenin 1 dhe më pas t'i japim zgjidhje këtij projektligji shumë të rëndësishëm. Jam i bindur se kur Ministria e Drejtësisë dhe qeveria kanë vendosur ta sjellin në Kuvend, kanë pasur parasysh një situatë konkrete dhe një vlerësim të situatës në mënyrë komplementare.

Zonja Hysi, të lutem, do ta hedhim në votim!

Nuk ka 2 apo 3 pika, por ka vetëm një nen me disa pika. Jemi te neni 1 dhe ka një përkufizim konkret për të përkufizuar rastin e jashtëzakonshëm. Unë jam i detyruar ta hedh në votë. Edhe për pikën 8 të gjitha, ndaj, ju lutem, thirrni kolegët, po ashtu edhe zotin Çuçi, të vijë këtu dhe të fillojmë, pasi në këtë mënyrë nuk ia dal dot.

Neni 1, pika 1, ka një propozim të zotit Hyseni për të përkufizuar fjalën “i jashtëzakonshëm”.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Propozimin e kam këtu, materialin na e kanë lidhur shumë mirë, projekti ka ardhur nga qeveria dhe propozimet i ka bërë relatori, hera e parë që punohet kaq bukur. Propozimet e ardhura nga qeveria për pikën 1 më duken interesante, për të hequr idenë e përkufizimit të rasteve të jashtëzakonshme, pasi ne nuk mund të bëjmë përkufizime për rastet e jashtëzakonshme. Çfarë do të thotë raste të jashtëzakonshme? Sado ta përkufizosh, prapë do të lësh elemente...

Ulsi Manja – Absolutisht!

Bashkim Fino - ...propozimet që ka bërë qeveria në pikën 1 të nenit 13, mua më duket normale dhe korrekte. Ndoshta relatori mund të reagoj dhe kërkon për ta lënë kështu siç është, duke hequr vetëm fjalën “në raste të jashtëzakonshme”, që të mos bëjmë as komente.

Ulsi Manja – Zoti Fino, ka një propozim të hiqet fjala “raste të jashtëzakonshme” dhe të ngelet sipas variantit të qeverisë: “Të dënuarit në burgun e sigurisë së lartë për një vepër penale”.

Tani këtu vijmë në terren ekspertize, pasi kemi të pranishëm këtu në komision edhe përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme, si dhe ekspertët e misionit Euralius. Pra, po të nisemi nga zbatimi konkret nesër i këtij ligji, ka një variant të dakordësuar për t’u futur termi “në raste të jashtëzakonshme”, ndërsa varianti i qeverisë thotë “të dënuarit në burgun e sigurisë së lartë”. Kjo gjë të jep idenë sikur të gjithë janë të dënuar në burgun e sigurisë së lartë dhe mund t’i nënshtrohen këtij regjimi, por jo, edhe brenda një organizate kriminale jo të gjithë anëtarët e organizatës mund të vendosen në një regjim të posaçëm. Pra, mund të jenë 12 persona të dënuar për një organizatë kriminale dhe jo të 12-të mund të referojnë. Pra, ka opinione të ndryshme.

A ka propozim tjetër konkret, sepse jemi midis këtyre dy propozimeve? E para, e grupit të punës së dakordësuar...

Po, zonja Ministre.

Etilda Gjonaj – Me zotin Luli po diskutonim se si mund të kishim një riformulim për rastet e jashtëzakonshme, që të mos marrim në konsideratë të jashtëzakonshmen dhe më pas të kuptojmë se çfarë është e jashtëzakonshme, sepse duket sikur fjala “e jashtëzakonshme” do të përdoret një herë në kaq kohë, por në fakt nuk është ky qëllimi. Qëllimi është që të gjithë ata që paraqesin rrezikshmëri të vendosen brenda këtij regjimi të kufizuar që është prapë i sigurisë së lartë.

Unë mendoj të vendosim një shprehje, pra nëse për ju është e rëndësishme që të mos jenë thjesht automatikisht ata, të cilët qëndrojnë në një regjim të posaçëm të ushtrimit të të drejtave mund të zbatohet për të dënuarit në burgun e sigurisë së lartë, në të cilën të thuhet: “Në raste të veçanta, kur të dënuarit ose të paraburgosurit plotësojnë kriteret e parashikuara në këtë dispozitë (ose të gjejmë ndonjë fjalë tjetër) dhe që janë të dënuar me këto vepra penale (ashtu siç është cituar këtu), do t’i nënshtrohen një regjimi të posaçëm”. Kjo bëhet me qëllim që të gjitha kriteret e zbatimit, siç është informacioni që vjen nga Prokurori i Posaçëm, ministri i Brendshëm, Policia e Shtetit e të tjerë përbëjnë atë, të cilët janë në kushtet për t’u vendosur në një regjim të posaçëm.

Pra, tek i pari vendosim subjektet, tek i dyti vendosim se si do të jetë regjimi i posaçëm, kush e përcakton qëndrimin në këtë regjim të posaçëm në mënyrë që të heqim fjalën “e jashtëzakonshme”, të cilën e kam shumë merak.

Ulsi Manja – Nëse kërkohet zëvendësimi i fjalës “në raste të jashtëzakonshme”, për të mos e konfunduar me gjendjen e jashtëzakonshme...

(Diskutime pa mikrofon)

Jemi në zbatimin praktik të ligjit dhe nesër mund të ketë interpretime që i referohen vetëm gjendjes së jashtëzakonshme. Nëse do ta kemi këtë shqetësim, është e natyrshme që mund të ndodhë edhe ky gabim në praktikë, prandaj të gjendet fjala e duhur. Por, të ketë liri veprimi çdo agjenci për të vlerësuar një situatë specifike dhe t’i propozojë ministrit të Drejtësisë nxjerrjen e një akti administrativ për vendosjen në regjim të posaçëm, jo.

Mendoj të gjendet një fjalë që të mos na konfundojë me situatën e gjendjes së jashtëzakonshme nesër në praktikë. Mund të ketë një drejtor të përgjithshëm burgu apo policie, i cili thotë: “Ky nen mund të aplikohet vetëm kur ka gjendje të jashtëzakonshme në Shqipëri”. Nëse është për këtë, urdhëro, nuk kemi pse të ngelemi peng i fjalës këtu, të gjejmë fjalën e duhur, jemi gjithë këta juristë dhe ekspertë dhe ta gjejmë këtë fjalë.

Po, zoti Luli.

Kujtim Luli – Kisha diçka për pjesën hyrëse të fjalisë së parë. Për mua riformulimi të bëhet: “Në raste të veçanta, sipas kriterëve të këtij neni” dhe të vazhdojë “regjimi i posaçëm i ushtrimit të...”

Pra, sipas kriterëve, sepse ky nen kriter ka.

(Diskutime pa mikrofon)

Adnor Shameti – Kriteret janë shteruese, përcaktimet janë përjashtimore...

Ulsi Manja – Fjalën e ka zonja Hysi, e cila ka një propozim konkret, pasi kanë ardhur rekomandimet e Këshillit të Europës.

Vasilika Hysi – Të nderuar kolegë, Këshilli i Europës e pranon se mund të merren masa të posaçme të sigurisë së lartë në rrethana...

(Diskutime pa mikrofon)

Këto janë masa që nuk mund të përdorin fjalën “të jashtëzakonshme”, por janë të veçanta...

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – A ka mundësi të më gjeni fjalën e duhur, sepse nuk dua shumë teori.

Vasilika Hysi – Pra, qëllimi i ligjit justifikohet te Rregullat Europiane të Burgjeve i 2006-ës. Te paragrafi 53 e në vazhdim thuhet: “Në rrethana të veçanta”, pra është totalisht

përrjashtuese, jo “të jashtëzakonshme”, sepse kur thuhet “raste të jashtëzakonshme”, ka të dhëna për një arratisje, për një revoltë në burg, mund të ketë gjendje tërmeti, mund të ketë punime ku kërkohen të merren masa e të tjera.

E para, pajtohem me propozimin e relatorit dhe të kryetarit të komisionit, pasi shqetësimi që sjell fjala “në raste të jashtëzakonshme” të hiqet.

(Diskutime pa mikrofon)

E dyta, është më afër varianti i qeverisë se sa varianti, jam duke folur për pikën 1, i rregulluar.

Ajo që do të doja të theksoja është, si dhe detyrimi që ne kemi si ligjvënës, të kemi një procedurë të qartë, afat të qartë dhe baza mbi të cilat do të përcaktohen në ligj pikërisht këto përkufizime. Kemi tre elemente që ne duhet detyrimisht t'i...

(Diskutime pa mikrofon)

Pra, në qoftë se do të ketë zgjatje të afatit, detyrimi është të ketë miratim të autoritetit me një...

Ulsi Manja – Zonja Hysi, të lutem!

Duhet ta hedhim në votim dhe të dominojë vota.

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Hyseni, ta mbaroj unë fjalën. Këtu nuk jemi në doktrinë juridike se si do ta bëjmë, ka mbaruar. Projektligji i merr në konsideratë të gjitha këto shqetësime që ngre Këshilli i Europës. Është garantuar e drejta e ankimit në këtë projektligj...

(Diskutime pa mikrofon)

Jemi te fjala, pra ta vendosim “në rrethana të veçanta, “në raste të veçanta” apo ta lëmë “në raste të jashtëzakonshme”. Këtu të gjithë i biem rrotull, por po ju them se nga Prokuroria e Përgjithshme ka një propozim në të cilin thuhet: “Ta vendosim në raste të veçanta sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen”.

Po, zonja Ministre.

Etilda Gjonaj – Kisha diçka shkurt, pra të mos kemi hapësirë zbatimi. Në propozimin që ka ardhur nga qeveria kemi thënë: “Masat e brendshme dhe të jashtme të sigurisë së lartë, që lidhen kryesisht me nevojën për të parandaluar kontaktet me organizatën kriminale, konfliktet e mundshme me elemente të organizatës kriminale, ndërveprimi me të burgosurit, komunikimin apo shkëmbimin e sendeve e të tjera”. Kjo do të thotë se këto të katërta do të na për diçka, si dhe do të ndihmojnë edhe prokurorin e posaçëm kur t'i propozojë ministrit kërkesën për vendosjen në regjim të posaçëm.

Ulsi Manja – Zonja Ministre, edhe unë kam qenë që ato të hiqen. Pse kam qenë që ato të hiqen? Sepse mund të kenë rrethana të tjera tej këtyre katër rasteve që ju keni përmendur, që mund të na çojnë në një vlerësim të situatës për grupin, të cilit i është lënë e drejta për të sugjeruar kërkesën.

Ju kërkoni që të jenë vetëm këto 4 raste, ndërkohë kam një pyetje, pse të jenë 4 dhe jo 5 raste?

Alket Hyseni – Janë orientime dhe jo raste, të mos i ngatërrojmë.

Ulsi Manja – Pse të jenë këto të katërta dhe jo gjashtë?

Etilda Gjonaj – Ka diçka, sepse në momentin që ne themi se këto masa janë për të parandaluar, këtu rendisim katër objektivat kryesorë, të cilat, në fakt janë pjesë e këtij propozimi, kjo do të thotë që nesër, kur prokurori i posaçëm do t'i drejtohet ministrit me kërkesë të arsyetuar, në arsyetimin e tij do të jetë i orientuar nga këto katër qëllime, sepse në fund të fundit regjimi i posaçëm për këto do të shërbejë. Si kritere, arsye përkufizimi mund të jenë të ndryshme, por orientimi të jetë mbi bazën e këtyre katër objektivave.

Vasilika Hysi – Unë jam dakord me ministren...

(Diskutime pa mikrofon)

Kështu e kërkon ligji dhe standardi.

Ulsi Manja – Po, zoti Shameti.

Adnor Shameti – Më duket sikur po e fillojmë diskutimin nga e para, por kjo nuk është mënyra e adresimit të gjësë.

E para, duhet të kuptojmë diçka, pasi perceptimi që i krijohet komisionit dhe publikut është që me fjalën që thotë zonja ministre, unë druaj shumë se do të masivizohet dhe ka mundësi abuzimi. Unë insisto, sikurse edhe përfaqësuesi i Euralius-it, të jetë “raste të jashtëzakonshme”, sepse është një herë në Hënë. Ishte Provenzano, por nuk është diçka masive, zotëri...

(Diskutime pa mikrofon)

Kjo është fryma e ligjit...

Ulsi Manja – Të gjithë u kthyet te varianti i qeverisë?

Adnor Shameri – Ta diskutojmë...

Ulsi Manja - Zoti Shameti, a ka ndonjë mendim lidhur me pikën e dytë, sepse pikën e parë e kemi, këtë që kërkon ministrja tani? Pra, për germën “a”.

Adnor Shameti – Kështu siç është formuluar me dispozitat është perfekt.

Ulsi Manja – Lidhur me fjalën “e jashtëzakonshme” propozimi është për t’u vendosur termi, zoti Luli, edhe një herë.

Kujtim Luli – Riformulimi është: “Në raste të veçanta, sipas përcaktimeve në këtë nen, një regjim i posaçëm i ushtrimit të të drejtave mund të zbatohet për të dënuarit me burgim të sigurisë së lartë edhe në vijim”.

Ulsi Manja – Pra, në raste të veçanta, sipas përcaktimeve në këtë nen...

(Diskutime pa mikrofon)

Alket Hyseni – Zoti kryetar, a mund t’i marrim një nga një paragrafët për diskutim për të ndarë edhe debatin, sepse janë tre elemente të rëndësishme: termi, çështja e afatit dhe në fund është çështja e diskrecionit të ministrit mbi vendimin e gjykatës.

Ulsi Manja – Unë kam 1 orë që ju them t’i marrim germat një nga një, ndërsa ju diskutoni në parim.

Neni 1, pika 1, propozohet në vend të fjalës “në raste të jashtëzakonshme” të bëhet “në raste të veçanta, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen” dhe të vazhdojë dispozita.

(Diskutime pa mikrofon)

Të pyes përfaqësuesit e Euralius-it se çfarë mendojnë?

(Diskutime pa mikrofon)

Për pikën 1, a keni propozim tjetër?

Vasilika Hysi – Në variantin e qeverisë...

(Diskutime pa mikrofon)

Të kemi respekt për njëri-tjetrin, se nuk po bëjmë ligjet e familjes!

Në variantin e qeverisë është përcaktuar baza mbi të cilën mund të zbatohen këto masa të jashtëzakonshme të sigurisë. Ashtu siç e kërkojnë rregullat europiane të burgjeve, 4 shtylla...

Ulsi Manja – Po nuk kam ardhur te masat, zonjë...

Relatori i ka riformuluar me pika.

Vasilika Hysi - Qëllimet, po flas.

Ulsi Manja – Zysh, më fal! A e lexon propozimin e kolegut në krah?

Vasilika Hysi - Para se ta ngre dorën për propozimin e kolegut, po i kthehem variantit të qeverisë. Te ky variant jepet qëllimi pse merren këto masa të brendshme dhe të jashtme të sigurisë së lartë dhe janë 4, që me të drejtë ministrja i ritheksoi, pra nuk mund të lihet në dëshirën e një drejtuesi apo një tjetri propozimi për marrjen e kësaj mase, por do të jetë në mënyrë eksplicite, nëse ka kontakte me organizatat, konflikte të mundshme me elemente të organizatave kundërshtarë, ndërveprime me të burgosurit e tjerë dhe komunikim... pra është e përcaktuar. Do të mbajnë një qëndrim për këto, që me të drejtë i tha ministrja?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, këto janë qëllimi, baza mbi të cilën do të gjykohet, nuk janë rastet. Rastet janë shumë dhe mund të kanalizohen në një nga këto 4 arsye. Në këtë kuadër besoj se do të jetë e qartë që të mos jetë abuzive.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja –Nuk ka propozim, këtu ka doktrinë tani.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju kujtoni se unë kam ndonjë merak të madh? Po e hedh në votim variantin e qeverisë dhe çojeni.

Kolegu relator Adnor Shameti duhet të ketë të drejtën për ta udhëhequr këtë proces. Edhe ai vjen nga fusha e së drejtës penale, nuk besoj se ka dyshime për këtë gjë.

Varianti i qeverisë ka propozuar riformulimin e nenit dhe e ka ndarë me pika. Ju mund të thoni veç pikës 1 që ka bërë zoti Shameti, germa e pikës 1, të kalojë si pikë më vete dhe të ngelet në ligj.

Alket Hyseni – Të inkorporohet te përkufizimi që thamë. Më lejoni ta sqaroj, kryetar, se e shoh që të gjithë jemi në të njëjtin qëllim, thjesht duhet të gjejmë formulimin. Ideja është kjo: do të duhet në raste të veçanta, kur synohet të parandalohet, e mbani mend, “i”, “ii”, “iii”, “iv”, që janë katër pika, po flasim për qëllimet, mendoj të shtojmë “edhe për qëllime terroriste”, pra për parandalimin e veprimtarisë terroriste, se nuk është e cituar në 4 pika.

(Diskutim pa mikrofon)

Po flas te qëllimi, dhe më pas vazhdojmë siç është dispozita e relatorit. Relatori ka një shqetësim legjitim, dhe thotë: “nuk dua të bëhet rregull ky, dua të jetë përjashtim”, pra të jenë raste shumë të veçanta dhe jo të jenë rregull që çdo administratë t’i marrë në rresht, siç e ka listën e të burgosurve.

Pra, ne do të themi: “Në raste të veçanta kur synohet të parandalohen 1,2,3,4 raste”, po të doni shtojmë edhe një tjetër, dhe pastaj vazhdojmë siç është dispozita e relatorit për pikën 1. Mendoj se pika 2 është në rregull, vazhdojmë me pikën 3.

Adnor Shameti – I qëndroj variantit përfundimtar të dakordësuar, draftit integral dhe ta votojmë kështu.

Ulsi Manja –Zoti Shameti, ekziston mundësia që neni 1, pika 1, të vijë në një format të përmirësuar, mes formulimit që ka sjellë qeveria dhe propozimeve që bëjnë kolegët. Ekziston mundësia të gjendet një formulim sipas asaj që thotë kolegu Hyseni, por edhe përfaqësuesi i Prokurorisë së Përgjithshme?

Adnor Shameti – Riformulimin e shikoj vetëm te sugjerimi i përfaqësuesit të Prokurorisë së Përgjithshme për rastet e veçanta, sipas asaj që parashikon ligji. Që ta sqaroj edhe një herë, frika ime më e madhe në këtë projektligj është abuzimi i pushtetit ekzekutiv me individin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndaj insistoј te ky variant.

Ulsi Manja –Kam një pyetje: ku e keni shkrirë germën “a” të nenit 1?

(Diskutim pa mikrofon)

Zoti Shameti, të lutem, ku e keni shkrirë këtë germë?

Unë mendoј se germa “a” mund të shkrihet te pika 3, siç është dhe mbyllet diskutimi.

(Diskutim pa mikrofon)

O zotëri, germën “a” mund ta shkriini te pika 3 e relatorit, tërësisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çështjen e afatit mund ta kalojmë në pikë më vete dhe zgjidhet problemi.

(Diskutim pa mikrofon)

Mund të ketë një formulim të saktë të saj, por unë kam këtë propozim: ta hedhim në votë propozimin e zotit Luli, si përfaqësues i Prokurorisë së Përgjithshme, për riformulimin e pikës 1 të nenit 1, ndërsa masat e brendshme dhe të jashtme të germës “a” të shkrihen te pika 3 e nenit 1. Jeni dakord me këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo mekanikisht, por të riformulohen. Thelbi është të ngelen këto dhe afati të kaloјë si pikë më vete.

Kush është dakord sipas këtyre që sapo thashë? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te pika 2. Ka propozime lidhur me vendimin?

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te pika 3. Këtu dua që germa “a”, e nenit 1, të inkuadrohet për sa është e mundur te pika 3 dhe afati të kaloјë si pikë më vete. Kohëzgjatja e regjimit të kaloјë pikë më vete.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Afati do të kalojë si pikë më vete.

Kujtim Luli – Nëse do të më lejohet, germa “a” ka nënpikën “ii” dhe 4 ku thuhet: “Konfliktet e mundshme me elemente të organizatave kundërshtarë...”...

Ulsi Manja - Zoti Luli, kemi vendosur që germën “a” ta shkrijmë te pika 3 dhe të ketë formulim të saktë të rasteve që parashikon germa “a”.

Zoti Hyseni ka një propozim për pikën 4.

Alket Hyseni – Meqë kohëzgjatjen e afatit do ta kalojmë si pikë më vete, ikën nga pika 3 dhe shkon te pika 5, pasi kjo pikë flet për afatet, te pika 4 kam një propozim: në fjalinë e tretë të saj, ka nevojë për një saktësim. Së pari, termi “rastet e jashtëzakonshme” hiqet “ndodh në raste të veçanta” “takimi me persona të ndryshëm nga familjarët për personat e dënuar”, unë propozoj: të mos jetë “kryhet me propozimin e drejtorit të institucionit”, por “lejohet me miratim të ministrit pas propozimit të drejtorit të institucionit”.

Ulsi Manja - Janë çështje të teknikës legislative.

Pra, të reflektohet heqja e termit “gjendje e jashtëzakonshme” dhe fjala “kryhet” të bëhet “lejohet”.

Zonja Hysi, ka diçka për të diskutuar te germa “b”.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Lidhur me lejimin e të dënuarit ose të paraburgosurit, thuhet që nuk kryhen takime. Në qoftë se e kam kuptuar qartë, zonja Ministre, i burgosuri në këto raste përjashtimore ka të drejtën o të një takimi me familjarët, ose të një bisede prej 10 minutash, por të dyja bashkë nuk i ka të mundura, në qoftë se mund ta kuptojmë kështu. Këtu thuhet: “Lejimin e të dënuarit ose të paraburgosurit, i cili nuk kryen takime familjare për të kryer bisedën telefonike 10 minuta”. Pyetjen e kam në parim: një i dënuar në këto rrethana tej mase përjashtuese, do të ketë o njërën, o tjetrën? Ky ka qenë qëllimi, apo mund të ketë edhe një takim me familjarët, edhe një bisedë telefonike? Këtu është përjashtuese, o njërën, o tjetrën.

Së pari, marrim rastin kur ai ka familjarë, do t’i themi që ke vetëm takime dhe nuk do të kesh telefonata, dhe në rastin kur nuk do të ketë familjarë, do të ketë biseda.

Së dyti, këtu thuhet: “Parashikimet e këtij paragrafi nuk zbatohen për bisedat telefonike me institucionin e Avokatit të Popullit”. Po bisedat telefonike që do të marrë Komisionin European për parandalimin e torturës, komisionerin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, e ke me konventë.

Ulsi Manja - S’po flasim ne që jemi të lirë me komisionerin në Bruksel!

Vasilika Hysi –Ju lutem!

Ne kemi ratifikuar Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe komunikimet e çdo qytetari me institucionet ndërkombëtare janë të drejtpërdrejta, nuk të ndalon njeri, qoftë bisedat telefonike, qoftë dërgimin e letrave. Në këtë kuadër, e kam këtë pyetje dhe shqetësim dhe do të vlerësoja edhe opinionin e ekspertit të EURALIUS-it.

Së treti, a do të lejohet kjo kategori të telefonojë organizatat e të drejtave të njeriut për të thënë që kam këtë shqetësim, jam rrahur, keqtrajtuar, abuzuar, s'jam ushqyer etj.? Nëse ky ligj do të cenojë këto të drejta, do të ketë probleme më pas. Kjo lidhet me germën “b”.

Lidhur me shkronjat e tjera, jam e mendimit t'i kalojmë me radhë.

Kjo çështje është e thjeshtë, sepse, nëse do ta zgjerojmë objektin e bisedave telefonike përtej Avokatit të Popullit, mund të shtohet edhe një fjali “dhe me organizatat e tjera të shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare dhe vendase që monitorojnë të drejta dhe liritë e njeriut”.

Këtë merak që ka kolegia Hysi, që ai të mos kufizohet te organizatat ndërkombëtare dhe vendase të shoqërisë civile që mbrojnë të drejtat e njeriut, t'u bëj telefon...

Zonja Ministre, po, urdhëroni!

Etilda Gjonaj – Unë e thashë, pavarësisht se ne e kemi vendosur, ose më saktë, në rishikimin e dispozitës nga relatori dhe grupi i punës është vendosur Avokati i Popullit në mënyrë telegrafike, do të ishte e pamundur që ne ta shtonim pafundësisht duke vendosur të gjitha organizatat. Nëse mendoni që është me vlerë, me qëllim që të mos rrezikojmë me asnjë lloj cenimi të standardeve ndërkombëtare dhe rregullave europiane, e lëmë, por ju thashë, në pjesën e protokolleve të brendshme, të cilat do të dalin me urdhër ministri, në mënyrën e zbatimit të këtij regjimi të posaçëm do të jenë shumë të detajuara të gjitha këto elemente.

Ndërsa për pikën e parë, që e ngriti edhe zonja Hysi si shqetësim, kështu është edhe modeli italian, pra ka o një telefonatë, o një takim me familjarë. Nëse ju keni propozim tjetër...

Ulsi Manja - Atëherë kush është dakord? Misioni EURALIUS ka ndonjë merak për këtë pikë?

Gianluigi Pratola (përkthen përkthyesja) – Siç u përmend, ky ishte model italian.

Ulsi Manja - Po, faleminderit!

Kush është dakord me pikën 4 të nenit 1 me sugjerimin e bërë për germën “b” nga zonja Hysi? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te pika 5. Këtu do të përfshihet paragrafi që hoqëm te pika 3, që ka të bëjë me kohëzgjatjen.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti kryetar!

Në këto masa përjashtuese ekstraordinere që do të themi, kohëzgjatja duhet të jetë e përcaktuar në ligj, del në tekstin e qeverisë që është një vit me të drejtë ripërsëritjeje, por ne do ta themi në mënyrë taksative: “Kohëzgjatja e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave në këtë regjim nuk mund të jetë më shumë se një vit”. Pra, në paragrafin 5 ne duhet të themi...

Ulsi Manja - Më falni, zonja Hysi!

Ne duhet të biem dakord që kohëzgjatja duhet të jetë një vit. Ju formulojeni te pika 5.

Kush është dakord me sugjerimin që të përcaktohet kohëzgjatja? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Pika 6 nuk ka sugjerim. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Pika 7. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Pika 8.

(Diskutim pa mikrofon)

Të lutem, ka një sugjerim nga zoti Luli.

Kujtim Luli – Në grupin e punës është diskutuar, është lënë kjo shtesë, por siç e argumentoi edhe zoti Pratola, unë mendoj që dështohet “dhe kur ka rrethana të reja”...

Ju lutem, po dolën rrethana të reja, nise kërkesën nga e para. Zoti Luli, a ta mbyllim, se do ta hedh në votim?

“Në rastet kur kërkesa kundër vendimit të ministrit të Drejtësisë pranohet nga gjykata, ministri vendos bazuar në vendimin e gjykatës”. Po pati kushte dhe rrethana të reja, nise me kërkesë të re.

Kush është dakord për pikën 8, sipas propozimit tim? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Hedhim në votim nenin 1 me të gjitha riformulimet e bëra sipas pikave. Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet në tërësi projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 8328, datë 16. 04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar” .

Projektligji dhe raporti përkatës do të kalojnë ditën e enjte në seancën plenare.

Shumë faleminderit, zonja Ministre, për prezencën në komision!

Faleminderit, zotit Luli, përfaqësuesve të EURALIUS-it, posaçërisht zotit Pratola dhe zonjës Shala.

E ndërpresim mbledhjen e komisionit për 5 minuta, pasi, së bashku me zotin Çuçi, jemi në konferencën e kryetarëve.

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretare

Klotilda Bushka (Ferhati)

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit

Edlira Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.12.2018, 16:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Vazhdimi i shqyrtimit nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar.”

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço dhe Silva Caka.

Të ftuar:

Besmir Beja – Këshilltar në Ministrinë e Drejtësisë

Aulona Mersini - Këshilltare në Ministrinë e Drejtësisë

Ketrin Treska - Drejtoreshë e Përgjithshme në Ministrinë e Drejtësisë

Odetta Fengjilli - Drejtoreshë në Ministrinë e Drejtësisë

Kujtim Luli - Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.

Gianluigi Pratola – Ekspert ndërkombëtar i misionit ndërkombëtar “EURALIUS”

Nita Shala – Eksperte vendase

Ulsi Manja – Rifillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve.

Kemi pikën e fundit në rendin e ditës, vazhdimi i shqyrtimit nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7829, datë 01.04. 1994 “Për noterinë”, të ndryshuar””.

Komisioni ynë është komision përgjegjës.

Relatore e këtij projektligji është kolegja Vasilika Hysi.

Nga Ministria e Drejtësisë kemi zonjën Ketrin Treska, drejtore e Përgjithshme.

Nga Dhoma Kombëtare e Noterisë kemi zonjën Mimoza Sadushi, kryetare e kësaj dhome së bashku me stafin.

Nga misioni EURALIUS kemi zonjën Agnes Bernhard, shefe misioni, së bashku me zotin Dobi që është ekspert vendas.

Dje kemi kaluar nen për nen, 20 nene të këtij projektligji. Kemi lënë 3 nene të hapura, deri këtu ku kemi arritur, përfshi edhe nenin 21, për të cilin patëm debat dje.

Shpresoj që grupi i punës, që ka punuar deri në orët e vona pas mesnate të ketë dakordësuar të gjithë ligjin, në mënyrë që sot të kemi mundësinë t’i kalojmë shpejt nenet që na kanë mbetur.

Dua të falënderoj grupin e punës, të gjithë pa dallim.

Falënderoj zonjën Hysi, zonjën Bushka, zonjën Bernhard, zonjën Sadushi, zonjën Treska dhe të gjithë ata që kanë punuar mbrëmë në orët e vona të natës.

Vazhdojmë me nenin 21.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj shumë grupin e punës!

Të diskutojmë tre nenet e hapura që kanë mbetur që dje.

Është rënë dakord. Faleminderit ekspertëve të EURALIUS-it për riformulimin që i bën ndërlidhjes së nenit 10, të nenit 11, të nenit 12 dhe nenit 13. Në këtë kuadër kemi një riformulim në nenin 13, është shtuar një paragraf, paragrafi 8.

Ulsi Manja – Nenet që lamë të hapura do t’i votojmë në fund.

Vazhdojmë me nenin 21.

Vasilika Hysi – Lidhur me nenin 21, që bën fjalë për heqjen e licencës, ka një riformulim të shkronjës “d”, e cila do të lexohet: “Vërtetohet se në momentin e marrjes së licencës, e ka marrë atë në kundërshtim me kushtet ligjore të parashkrua në legjislacionin në fuqi”.

Në këtë mënyrë adresohet shqetësimi i zonjës Bushka dhe shqetësimi im si relatore.

Ndërkohë, do t’ju bëja me dije, se në këtë nen adresohet edhe një nga rekomandimet e raportit të Manivali-t, lidhur me heqjen e licencave në rast se një noter ose një zyrë noteriale

kryen veprime ose vepra penale, të cilat kanë të bëjnë me pastrimin e parave ose me financimin e terrorizmit.

Gjithashtu, ndryshimet e tjera janë thjesht të teknikës legjislative.

E dyta, lidhur me moshën, për të cilën ne diskutuam shumë, unë mendoj dhe ftoj edhe kolegët të bien dakord, që mosha të lihet 70 vjeç.

Në përgjigje të kolegut të nderuar Fino, një të drejtë që e kanë të fituar noterët, ne nuk mund ta heqim. Aktualisht, mosha e tyre e pensionit është mosha 65 vjeç, por duke pasur parasysh profesionin që kanë dhe një rast të tillë ne e kemi lënë edhe në rastin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese...

Ulsi Manja – Është shkatërrues si argument. Cenohet parimi i sigurisë juridike, prandaj është shkatërrues. Pra, këta e kanë fituar për 65 vjeç dhe ideja është ta çojmë në 70.

Urdhëroni, zoti Çuçi!

Bledar Çuçi – Jam shumë dakord me argumentin e relatores, por unë doja të dëgjoja edhe opinionin e përfaqësuesve të EURALIUS-it, sepse ka një specifikë profesioni i noterit, nuk është si të gjithë punët e tjera.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Bernhard!

Agnes Bernhard – Duke pasur parasysh se çfarë ndodh në Europë, është prirja që edhe noterët, për shkak të profesionit të tyre, të kenë një moshë pensioni 70 vjeç. Gjithashtu, në përgjithësi, duke pasur parasysh jetëgjatësinë në rritje, tendenca është që të rritet hap pas hapi mosha e pensionit.

Bashkim Fino – Zonja e ka fjalën për noterët, po hajde thuaju shqiptarëve se do t'ua rrisim moshën e pensionit në tërësi. A do ta pranojnë një gjë të tillë? Ata duan ta ulin. Pra, ka një kontradiktë për këtë. Mos bie ndesh me ligjin e sigurimeve shoqërore që kemi ne? Ne jemi parlamentarë shqiptarë, ne ju falënderojmë për sugjerimet që jepni, po edhe ju duhet të jeni pak koherentë me ligjet e tjera shqiptare, se s'mund të përplasen dy ligje shqiptare.

Ky është një ligj për noterët, po ligji tjetër i sigurimeve shoqërore, që përmbledh moshën e pensionit për të gjithë profesionet e tjera?

Kush është dakord me nenin 21?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 22.

Vasilika Hysi – Te neni 22 ka thjesht një formulim të teknikës legjislative.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 22?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 23.

Vasilika Hysi – Te neni 23 nuk ka ndryshime, është sipas draftit të paraqitur.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 23?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet sipas variantit të relatores.

Neni 24.

Vasilika Hysi – Lidhur me nenin 24 kemi pasur diskutime. Më së fundi është lënë në variantin e përmirësuar që ne kemi depozituar, si dhe ka një redaktim të anës së teknikës legjislative te paragrafi i tretë.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 24, sipas variantit të dakordësuar?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 25.

Vasilika Hysi – Te neni 25 nuk kemi bërë ndryshime, por është sipas variantit që kemi depozituar dje.

Kush është dakord me nenin 25?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 26.

Kush është dakord me nenin 26?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 27.

Kush është dakord me nenin 27?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 28.

Vasilika Hysi – Te neni 28 ka thjesht një riformulim të teknikës legjislative në paragrafin e parë.

Kemi sugjeruar që në pikën 2 “afati i zgjatjes së hetimit të bëhet sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Administrative”, pra, aty ku thuhet “zgjatja për një periudhë prej 12 muaj” të hiqet dhe të themi “sipas afateve në Kodin e Procedurës Administrative”.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 28, sipas formulimit që bëri zonja Hysi?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 29.

Vasilika Hysi – Te neni 29 kemi bërë një riformulim të pikës 1, 2 dhe është fshirë pika 8. Këto ndryshime janë bërë duke pasur parasysh edhe raportin, e bërë dje publik, të Manivalit.

E para, i japim të drejtë çdo personi fizik dhe juridik ose Dhomës që t'i drejtohet drejtpërdrejtë ministrit të Drejtësisë për të bërë një ankesë.

E dyta, kemi bërë një rishikim të pikës 2 dhe një riformulim të saj, ku thuhet se, kur ka të dhëna të besueshme që noteri është zëvendësnoteri mund të kenë kryer shkelje disiplinore. Çdo funksionar publik që ka dijeni duhet të informojë ministrin e Drejtësisë. Me këtë rast adresojmë atë shqetësim, që ju dhe unë e dëgjuam edhe sot, që në rast se ka të dhëna se ka abuzime me ligjin (mund të jetë një gjyqtar, një prokuror, një avokat apo një institucion), konstatohet se mund të ketë veprime me pastrimin e parave, me financimin e terrorizmit dhe shumë shkelje të tjera.

E fundit, kemi fshirë nenin 8, sepse Kodi i Procedurave Administrative i parashikon rregullat se si mund të bëhet shqyrtimi i ankesave dhe ankimimi.

Ulsi Manja – Urdhëroni, zonja Treska!

Ketrinë Treska – Dakord me riformulimet, se i kemi diskutuar dje, por meqë i fshi neni 8, te neni 4 duhet hequr fjalë e fundit, sepse është referenca e Kodin e Procedurave Administrative.

Ulsi Manja – Dakord me sugjerimin.

Bashkimi Fino – Vasilika, ç' i keni këto “në rast se ka shkelje të besueshme”? Është e mjaftueshme “në rast se ka shkelje”. Ç' i keni këto fjaël të kota?

(Diskutime pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Shqetësimi i zotit Fino ia vlen të diskutohet. Unë do të thoja, zoti kryetar, se ky nen ka lidhje edhe me nenin 30, meqenëse se ju përmendët fjalën “indicie”. Në këtë nen ka një fjali, te paragrafi i tretë, ku thuhet: “Ministri i Drejtësisë ka detyrim të shqyrtojë ankesat, përveç atyre anonime”. Më poshtë, te neni 30, thuhet: “informacionet që përfitohen nga media ose ankues anonim, mund të shërbejnë si indicie për të filluar një hetim”.

Pra, nga një anë ne e pranojmë që indiciet mund të shërbejnë që organet të fillojnë një hetim ose ta verifikojnë atë, nga ana tjetër, ne themi se...

Ulsi Manja – Më falni, po pse nuk e themi te pika 2, që në rastet kur ka indicie, sepse indicia është një kompleks të dhënash. Te 29/2 pse ke përdorur termin “të dhëna të besueshme” dhe nuk ke thënë “indicie”, se indicia është kategori juridike?

Vasilika Hysi – Ju e zgjeroni më shumë. Në rastin konkret kemi thënë “të dhëna të besueshme”, megjithatë unë do të doja edhe opinionin e Ministrisë së Drejtësisë.

Ulsi Manja – Meqenëse ju e keni dakordësuar, ne nuk po marrin opinion fare, por po e hedhim në votim. Mua më duket se është në rregull.

(Diskutime pa mikrofon)

Kush është dakord me nenin 29, sipas variantit të dakordësuar me grupin?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 30.

Kush është dakord me nenin 30?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 31.

Kush është dakord me nenin 31?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 32.

Kush është dakord me nenin 32?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 33.

Kush është dakord me nenin 33?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 34.

Kush është dakord me nenin 34?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 35.

Kush është dakord me nenin 35?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 36.

Kush është dakord me nenin 36?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 37.

Kush është dakord me nenin 37?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 38.

Kush është dakord me nenin 38?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 39.

Kush është dakord me nenin 39?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 40.

Kush është dakord me nenin 40?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 41.

Kush është dakord me nenin 41?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 42.

Kush është dakord me nenin 42?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 43.

Kush është dakord me nenin 43?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 44.

Vasilika Hysi – Te neni 44, te drafti që kishin dje në diskutim, kishim një pikë të dytë ku thuhej “heqja dorë nga ushtrimi i profesionit nga noteri ose zëvendësnoteri nuk ndalon fillimin ose vazhdimin e procesit disiplinor”. Gjatë debateve pati një propozim për ta hequr, por unë sugjeroj dhe misioni EURALIUS e kërkon që të jetë. Kjo për shkak se mund të jetë një noter ose një zëvendësnoter sapo fillon procedimi disiplinor, thotë që do të heq dorë, dhe më vonë kërkon ta rimarrë përsëri licencën dhe mund të jetë një abuzim. Në këtë kuadër, mendoj të rifutet pika 2, “Heqja dorë nga ushtrimi i profesionit nta noteri osë zëvendësnoteri nuk ndalon fillimin ose vazhdimin e procedimit disiplinor ndaj tij”.

Ulsi Manja – Ju keni marrë modelin e ligjit të Vetingut, që, kur heq dorë, pushohet procedura?

Po filloi procedura, hiq dorë sa të duash, procedura s’ka pse ndalon.

Kush është dakord me nenin 44, sipas propozimit?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 45.

Kush është dakord me nenin 45?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 46.

Kush është dakord me nenin 46?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 47.

Kush është dakord me nenin 47?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 48.

Kush është dakord me nenin 48?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 49.

Kush është dakord me nenin 49?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 50.

Kush është dakord me nenin 50?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 51.

Kush është dakord me nenin 51?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 52.

Kush është dakord me nenin 52?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 53.

Kush është dakord me nenin 53?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 54.

Kush është dakord me nenin 54?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 55.

Kush është dakord me nenin 55?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu i katër.

Neni 56.

Kush është dakord me nenin 56?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 57.

Kush është dakord me nenin 57?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 58.

Kush është dakord me nenin 58?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 59.

Kush është dakord me nenin 59?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 60.

Kush është dakord me nenin 60?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 61.

Kush është dakord me nenin 61?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu i gjashtë, “Kompetencat, të drejtët, përgjithësitë dhe detyrat”

Neni 62.

Kush është dakord me nenin 62?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 63, “Detyrat e noterit”.

Kush është dakord me nenin 63?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 64.

Kush është dakord me nenin 64?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 65, “Sigurimi i noterit”.

Kush është dakord me nenin 65?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 66, “Të drejtat dhe detyrimet e zëvendësnoterit”.

Kush është dakord me nenin 66?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 67, “Arkiva e noterisë”.

Kush është dakord me nenin 67?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 68, “Llogaria rrjedhëse e noterit”.

Kush është dakord me nenin 68?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 69, “Vulat e noterisë”.

Kush është dakord me nenin 69?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 70.

Kush është dakord me nenin 70?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 71, “Listat e subjekteve të veçanta”.

Kush është dakord me nenin 71?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 72, “Dorëzimi i regjistrave dhe vulave të noterit”.

Kush është dakord me nenin 72?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 73, “Ruajtja e sekretit profesional”.

Kush është dakord me nenin 73?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu i gjashtë, “Financimi i veprimtarisë noteriale”.

Neni 74, “Tarifat për aktet dhe veprimet noteriale”.

Kush është dakord me nenin 74?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 75, “Kontrata e punës dhe të ardhurat e zëvendësnoterit”.

Kush është dakord me nenin 75?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 76.

Kush është dakord me nenin 76?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu i tetë, “Organizimi dhe funksionimi i Dhomës Kombëtare të Noterisë”.

Neni 77, “Dhoma Kombëtare e Noterisë”.

Kush është dakord me nenin 77?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 78, “Kodi i etikës profesionale”.

Kush është dakord me nenin 78?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 79, “Degët vendore”.

Kush është dakord me nenin 79?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 80, “organet e Dhomës Kombëtare të Noterisë”.

Kush është dakord me nenin 80?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 81, “Veprimtaria e Dhomës Kombëtare të Noterisë”.

Kush është dakord me nenin 81?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 82, “Funksionet dhe veprimtaria e degëve vendore të DHKN-së”. Kush është dakord me nenin 82?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 83, “Asambleja e përgjithshme”.

Kush është dakord me nenin 83?

Vasilika Hysi – Te neni 83, pika 6 ka një sugjerim lidhur me miratimin dhe ndryshimet e statutit. Këtu kuorumi është vëmë me 2/3, por do të themi ka riformulim. Do të themi se vendimet e asamblesë merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në takimin e Asamblesë së Përgjithshme. Padyshim që mbledhja do të jetë kur merr pjesë gjysma plus një, gjë që duhet theksuar. Për miratimin dhe ndryshimin e statutit të dhomës, mendoj se dy të tretat është shumë e lartë.

Ulsi Manja – Po sa, tre të pestat?

Vasilika Hysi – Ne do të themi me shumicën e anëtarëve...

Ulsi Manja – Me shumicën e të gjithë anëtarëve të asamblesë.

Vasilika Hysi – Po, e të gjithë anëtarëve të asamblesë, pesëdhjetë plus një.

Ulsi Manja – Në rregull!

Vasilika Hysi – Përndryshe do të bllokohen dhe nuk do të marrin kurrë vendime.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 83, me sugjerimin e bërë për pikën 6 nga kolegja Hysi?

Pro? Kundër s’ka! Abstenim s’ka!

Miratohet!

Neni 84: “Këshilli i dhomës”. Pro? Kundër s’ka! Abstenim s’ka!

Miratohet!

Neni 85: “Shpërndarja e këshillit”. Pro? Kundër s’ka! Abstenim s’ka!

Miratohet!

Neni 86: “Kryetari i dhomës kombëtare të noterisë”. Pro? Kundër s’ka! Abstenim s’ka!

Miratohet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Më fal! Dje patëm një diskutim lidhur me shpërndarjen e këshillit. Unë u konsultova edhe me ministren e Drejtësisë, edhe me misionin EURALIUS. Në lidhje me shpërndarjen e këshillit, ky model është marrë sipas legjislacionit italian. Kjo shpërndarje nuk bëhet nga ministri i Drejtësisë, por bëhet pasi Gjykata Administrative e Apelit ka dhënë një vendim miratues në lidhje me shpërndarjen e këshillit. Kjo është.

Ulsi Manja – Dakord! E kaluam nenin 85 me këtë argument.

Vasilika Hysi – Pra, me vendim të Gjykatës Administrative të Apelit.

Ulsi Manja – Atëherë kalojmë te neni 87: “Bordi i auditimit”.

Pro? Kundër s’ka! Abstenim s’ka!

Miratohet!

Kalojmë te neni 88: “Qendra shqiptare e trajnimit të noterëve”.

Pro? Kundër s’ka! Abstenim s’ka!

Miratohet!

Neni 89: “Komisioni i kualifikimit”.

Pro? Kundër s’ka! Abstenim s’ka!

Miratohet!

Neni 80: “Formimi fillestar dhe provimet e kualifikimit”.

Pro? Kundër s’ka! Abstenim s’ka!

Miratohet!

Neni 91: “Provimi i kualifikimit për noterët”.

Pro? Kundër s’ka! Abstenim s’ka!

Miratohet!

Neni 92: “Programi i detyrueshëm i formimit vazhdues”.

Pro? Kundër s’ka! Abstenim s’ka!

Miratohet!

Kalojmë te pjesa e dytë: “Veprimtaria noteriale”, kreu I “Dispozita të përgjithshme”.

Vazhdojmë me nenin 93.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Kisha unë një koment. Mundem?

Ulsi Manja – Po.

Alket Hyseni – Meqë është një nen, i cili indirekt ka lidhje me funksionin e noterit dhe janë bërë komente të shumta, doja të bëja me dije një qëndrim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Mund të vazhdoni!

Alket Hyseni – Më lejoni të lexoj një vendim të Gjykatës Kushtetuese franceze, të datës 21 nëntor 2014, vendimi 419. Gjykata Kushtetuese franceze, në fakt këshilli kushtetues, por që është i barazvlefshëm me Gjykatën Kushtetuese, nisur nga ankesa e një të riu të sapodiplomuar, i cili kërkonte të bëhej noter, por e kishte të pamundur, sepse siç e dini, në Francë noteria trashëgohet, gjykata definoi: “Zyrat noteriale janë biznese private si të tjerat. Asgjë nuk i ndalon që të vendosin mbi të ardhmen e tyre”.

Po e them ngadalë, që edhe të mund të përkthehet për EURALIUS-in.

“Ata kryejnë një mision publik kur bëjnë një kontratë apo kur ushtrojnë të drejtën e tyre publike, por nuk janë funksionarë publikë, pasi nuk janë të paguar nga shteti, por nga klientët e tyre, të cilët janë të lirë të zgjedhin noterin e tyre, dhe noterët janë vetë përgjegjës për mirëfunksionimin e zyrës së tyre. Noterët ushtrojnë një profesion të lirë, të rregulluar me ligje të veçanta, për funksionimin dhe tarifën. Rrjedhimisht, e drejta e trashëgimisë nuk është antikushtetuese dhe nuk është në kundërshtim me Deklaratën e të Drejtave të Njeriut, të vitit 1789.”

Këtë e kisha për ta lidhur edhe me zyrën noteriale si koncept, por edhe për të sqaruar qëndrimin tim personal, në mbështetje të parimeve të mia kushtetuese.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Kush është pro nenit 93: “Zyra noteriale”?

Pro? Kundër s’ka! Abstenim s’ka!

Miratohet!

Neni 94: “Aktet noteriale dhe kontrolli i tyre”.

Pro? Kundër s’ka! Abstenim s’ka!

Miratohet!

Neni 95 “Dokumentet elektronike”.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, te nenet 95 dhe 96 ka një riformulim...

Ulsi Manja – Sipas variantit që kemi.

Vasilika Hysi – Jo, nuk është varianti i shpërndarë sot, por lexohet në këtë mënyrë: “Dokumentet elektronike”. “Noteri lëshon një dokument të vërtetuar në formë elektronike. Dokumenti elektronik përmban nënshkrimin elektronik të kualifikuar bazuar në certifikatën e kualifikuar që është e vlefshme që nga çasti i nënshkrimit. Nënshkrimi elektronik krijohet nga noteri me të gjitha të dhënat e lidhura me krijimin e nënshkrimit elektronik të kualifikuar. Administrohet personalisht nga noteri. sipas legjislacionit në fuqi për nënshkrimin elektronik”. Besoj se Dhoma është dakord.

Paragrafi i dytë: “Nënshkrimi elektronik krijohet nga noteri dhe përmban emër, mbiemër, firmë, si dhe kohën e krijimit të tij”.

Paragrafi i tretë: “Ministri i Drejtësisë me propozim të Dhomës Kombëtare të Noterisë miraton rregulla të mëtejshme në lidhje me kërkesat për krijimin dhe përdorimin e dokumenteve elektronike noteriale”.

A jeni dakord, të nderuar kolegë?

Është riformulim i...

Kush është dakord me nenin 95 “Dokumentet elektronike”, me riformulimin e koleges Hysi? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 96.

Vasilika Hysi – Për nenin 96 ka një propozim nga ana e Dhomës, prandaj do të ishte mirë ta prezantonin noterët që ishin pjesë e grupit të punës.

Ulsi Manja – Neni 96 “Qasja dhe aplikimi nëpërmjet sistemit elektronik në regjistrat elektronikë publikë”. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet, sipas variantit që ka riformuluar kolegia Hysi.

Neni 97 “Refuzimi i hartimit të aktit dhe kryerjes së veprimit noterial”. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 98 “Konflikti i interesit”. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu II “Hartimi i akteve noteriale”.

Neni 99 “Mënyra e hartimit të taksave noteriale”. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 100 “Gjuha e hartimit të akteve noteriale”. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 101 “Identifikimi i subjekteve pjesëmarrëse në aktin ose veprimin noterial”. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 102 “Nënshkrimi i aktit noterial nga palët”. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 103 “Personi i tretë i interesuar”. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 104 “Shpenzimet noteriale”. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 105 “Përmbajtja e aktit noterial”. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 106 “Regjistrimi i akteve dhe veprimeve noteriale”.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 107 “Ndreqja e gabimeve në aktet dhe veprimet noteriale”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 108 “Lëshimi i kopjeve dhe të akteve noteriale”.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu i tretë i pjesës së dytë “Aktet dhe veprimet noteriale”, neni 109 “Testamenti me akt noterial”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 110 “Testamenti ollograf”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 11 “Kërkesa për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 112 “Përmbajtja e dëshmisë së trashëgimisë”. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 113 “Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 114 “Ndreqja e gabimeve në dëshminë e trashëgimisë”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 114 “Ndryshimi dëshmisë së trashëgimisë”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 116 “Pavlefshmëria e dëshmisë së trashëgimisë”.

Neni 117 “Veprimet e noterit në rastin e heqjes dorë nga trashëgimia”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 118 “Procesverbali i çeljes së testamentit”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 119 “Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë për testamentet e hershme me akt noterial ose të posaçme”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 120 “Procedura e lëshimit të trashëgimisë ku ka më shumë se një testament”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 121 “ Personat e interesuar”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 122 “Lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë për çdo trashëgimlënës”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 123 “ Mungesa e certifikatës së vdekjes dhe të akteve të tjera”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 124 “ Testamenti në favor të një shtetasi të huaj”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 125 “ Tërheqja e akteve të gjendjes civile pranë zyrave të gjendjes civile dhe aplikimi nga noteri nëpërmjet sistemit”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 126 “Procedura për kalimin e pasurisë së paluajtshme”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 127 “Procedurat për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme në regjistrin pasuror martesor nën regjimin pasuror martesor”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 128 “Vërtetimi i nënshkrimeve”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 120 “Vërtetimi i njësisë me origjinalin”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 130 “Vërtetimi i datës së paraqitjes së dokumentit”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 131 “Vërtetimi i qenies së një personi gjallë ose i vendqëndrimit të tij”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 132 “Pranimi për ruajtjen e dokumenteve”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 133 “Ruajtja e titujve me vlerë ose vlerave monetare”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 134 “Njoftimet e akteve jashtëgjyqësore”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 135 “Vërtetimi i përkthimeve”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 136 “Kryerja e inventarëve”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu i katërt i pjesës së dytë “Pavlefshmëria e akteve dhe veprimeve noteriale, dhe regjistrat e noterisë”.

Neni 137 “Aktet dhe veprimet noteriale të pavlefshme”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 138 “Ankimimi për pavlefshmërinë e akteve ose veprimeve noteriale”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 139 “Regjistrat noterialë”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 140 “Regjistri Kombëtar i Testamenteve dhe Regjistri Kombëtar i Dëshmime të Trashëgimisë”. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 141 “Mënyra e mbajtjes së regjistrave dhe arkivës së noterëve”.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu i pestë “Dispozitat kalimtare dhe të fundit”.

Neni 142 “Dispozita kalimtare”.

Fjalën e ka zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Neni i dispozitave kalimtare ka rëndësi, sepse ka të bëjë qoftë me sigurinë juridike, qoftë me adresimin e një sërë problemesh. Varianti që ishte depozituar është riparë dhe është konsultuar me grupin e punës, por ndërkohë i është lënë detyrë Ministrisë së Drejtësisë të bëjë një shtesë lidhur me vetëdeklarimin, të cilin do të doja ta dëgjoja sot.

(Diskutime në sallë)

Ulsi Manja – Ju lutem, kolegë!

Po, zonja Treska.

Ketrin Treska – Te paragrafi i njëmbëdhjetë, nëse nuk gabohem...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, kolegë, se janë katër nenet e fundit!

Kur e patët durimin deri tani, ju lutem, pak qetësi që të merremi vesh!

Zonja Treska, urdhëroni!

Ketrin Treska – Atëherë, te paragrafi i parafundit i nenit 142 propozojmë këtë formulim: “Brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji çdo noter dhe asistent/noter dorëzon dosjen e plotë personale të rifreskuar pranë Ministrisë së Drejtësisë. Lista e dokumenteve që dorëzohen dhe formati i vetëdeklarimit të të dhënave të kërkuara përcaktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë pas konsultimit me dhomën kombëtare”.

Ulsi Manja – Pra, ju propozoni të shtohet vetëm fjala “formati”?

(Deputetja Hysi ndërhyr pa mikrofon.)

Ketrin Treska – “Formati i vetëdeklarimit”.

Ulsi Manja – Dakord.

Vasilika Hysi – Gjithashtu, zoti kryetar, meqenëse Dhoma duhet të ngrejë edhe qendrën e trajnimeve, unë do të sugjeroja që në këtë dispozitë duhet të jetë edhe një paragraf, ku të përcaktohet se brenda sa kohësh do të ngrihet Qendra e Formimit Fillestar.

Ulsi Manja – Sugjeroje, të lutem!

Vasilika Hysi – Unë, duke pasur parasysh kapacitetet që ka Dhoma për kohën që i duhet, do të doja një mendim nga Dhoma dhe nga Ministria e Drejtësisë, se është kjo e fundit që do të përgatisë një sërë aktesh, programesh etj. A është e mundur ta ngrini brenda 1 viti nga miratimi i këtij ligji, apo ju duhet më shumë kohë?

Të mos harrojmë se që nga momenti i miratimit të ligjit, çdo 3 vjet në këtë periudhë tranzitore, derisa të arrihet numri 1 noter për 15 mijë banorë rezidentë, do të duhet të hapet

një konkurs, një thirrje për 10 pozicionet. Pra, duhet të jeni të gatshëm, që të mos llogarisim...

Ulsi Manja – Të lutem!

Vasilika Hysi – Unë do ta vlerësoja 1 vit.

Ulsi Manja – Të marrim mendimin e përfaqësuesve të Dhomës, se sa kohë u duhet!

Vasilika Hysi – Të jemi realistë.

Ulsi Manja – Jo 1,5 vjet, se ashtu i bie që ligji të jetë i pazbatueshëm.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, zonja Sadushi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të kemi një afat optimal, sepse po e kaloj mbi 1 vit nuk ka më rëndësi zbatimi i ligjit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Sa e propozoni afatin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

1 vit, sepse është një transformim tërësor i një shërbimi publik.

Atëherë, kush është dakord me nenin 142 me formulimin e propozuar nga MD-ja për pikën 11 dhe me afatin 1-vjeçar për ngritjen e Qendrës së Formimit Fillestar të propozuar nga zonja Hysi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse e ngrini brenda një viti, ju lumtë. Problemi është të ngrihet brenda një viti.

Atëherë, kush është dakord me nenin 142?

Kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Në pikën 11 të këtij neni të shtohet fraza: "... dhe formati i vetëdeklarimit përcaktohet me...".

Po ashtu, të vendoset afati 1-vjeçar i propozuar nga zonja Hysi për ngritjen e Qendrës së Formimit Fillestar.

Neni 143, "Aktet nënligjore"

Ka diçka për të thënë përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë.

Ketrin Treska – Unë mendoj që paragrafi i dytë duhet të hiqet, pasi është përsëritje e nenit 20.

Ulsi Manja – Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Keni të drejtë.

Për t’iu përgjigjur kolegut Fino, sepse është pyetje e drejtë.

Zoti Fino, ne e diskutuam këtë gjerësisht në të gjitha takimet që kemi bërë në grupin e punës, por ka shumë ndryshime. Noteria pothuajse ndryshon tërësinë e vet. Ka shumë akte, do të ndryshojë statuti, do të krijohet një qendër, do të ketë akte dhe udhëzime të reja, riorganizohet Dhoma vetë dhe degët vendore të saj.

Unë kam një pyetje për 143-shin.

Përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë tha se paragrafi i dytë i 143-shit është përsëritje. Po në paragrafin e dytë kemi edhe një fjali “Të gjithë zyrat e noterisë në vend duhet të marrin masa që të respektojnë kërkesën brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji”. Kjo nuk mund të fshihet, sepse në pikën 2 thuhet: “Ministri i Drejtësisë pas konsultimeve me Dhomën, brenda 9 muajve përcakton kërkesa të detajuara për hapësirën e zyrës së noterit”, që është në nenin 20, por këtu ka detyrime për Dhomat Vendore, pra nuk është për aktet nënligjore.

Ulsi Manja – Të jap një propozim. Ta shkrijmë pikën 1 me pikën 2. Këtë fjalinë “Të gjithë zyrat e noterisë në vend duhet të marrin masa që të respektojnë kërkesën brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji” ta vëmë te paragrafi i parë.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, paragrafi i parë ka të bëjë me nxjerrjen e akteve, udhëzimeve, akteve nënligjore.

Paragrafi i dytë nuk ka të bëjë me akte, por ka të bëjë me krijimin e hapësirave, riorganizimin dhe noterëve do t’u lëmë kohë për të bërë rregullat.

Jam dakord me pjesën e parë të fjalisë së paragrafit të dytë, që thotë përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë për aktet nënligjore, që përfshihen në paragrafin e parë, por degëve vendore do t’u lësh kohë.

Ulsi Manja – Urdhëroni, zonja Treska!

Katrinë Treska – Shqetësimi për riorganizimin e degëve vendore rregullohet një nen më sipër, ndërkohë që qëllimi i kësaj dispozite ka qenë nëse dalin rregulla të reja për hapësirat e zyrave të një noteri. Ky të ketë kohën e nevojshme, por jo për degët vendore, se degët vendore rregullohen te neni më sipër.

(Diskutime pa mikrofon)

... është te neni 142, pika 5. Pra, dhomat vendore janë të detyruara të përshtatin organizimin dhe funksionimin e tyre sipas ripërcaktimit të numrit minimal të noterëve dhe në çdo rast, jo më vonë se 6 muaj pas hyrjes në fuqi të tij.

Vasilika Hysi – Atëherë, nëse ju kuptova korrekt, ju thoni që te neni 4 “Dhomat vendore të riorganizohen brenda 6 muajve dhe jo brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Dakord.

Ulsi Manja – Atëherë, kush është dakord me nenin 143, me propozimin që të hiqet pika 2, sepse ka gjetur zgjidhje në nenin 142? Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet

Neni 144 “ Shfuqizime”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 145 “ Hyrja në fuqi”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vasilika Hysi - Te neni 144: “ Aktet nënligjore të nxjerra në bazë të një ligji që do të shfuqizohet, mbeten në fuqi për aq kohë sa nuk bien ndesh me ligjin...”

Ulsi Manja- Nuk ka problem. Ky është një redaktim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përpara se të kalojmë te votimi në tërësi kemi lënë dy nene të hapura, nenin 15 dhe nenin 18. Të dy këto nene janë dakordësuar.

Neni 15 “Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së zëvendësnoterëve” është dakordësuar nga grupi i punës, mbrëmë.

E hedhim në votim. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18 “Pezullimi i përkohshëm i licencës së noterit me kërkesën e tij”.

Vasilika Hysi - Është riformuluar nga misioni EURALIUS. Kemi respektuar ato shqetësime që diskutuam.

Ulsi Manja- Po, faleminderit!

Kush është dakord me nenin 18? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për noterinë”.

Ju lutem!

Raporti për projektligjin së bashku me ligjin e plotë të zbardhur sipas të gjitha formulimeve që u bënë këtu, do të bëhet gati për t'i kaluar për votim seancës plenare ditën e enjte.

Faleminderit për durimin!

Shumë faleminderit të gjithë grupit të punës për punën që keni kryer!

Falënderoj në veçanti misionin EURALIUS, zonjën Bernhard për punën këmbëngulëse të saj për përmirësimin e ligjit!

Falënderoj zotin Dobi, zonjën Treska, zonjën Sadushi së bashku me kolegët!

Falënderoj zonjën Hysi në veçanti, si edhe të gjithë kolegët e komisionit!

Falënderoj këshilltarët për punën e mrekullueshme që kanë bërë!

Mbylлим pjesën e parë të mbledhjes së Komisionit të Ligjeve për ta vazhduar mbledhjen e këtij komisioni në pjesën e dytë, pasdite, në orën 17:00.

Faleminderit!

Ditë të mbarë!

Mbyllet mbledhja.

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.12.2018, ora 16:00

Drejtton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”
(Komision përgjegjës)

Projektligji “Për kadastrën në Republikën e Shqipërisë” (Komision përgjegjës)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Xhemal Qefalia dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço dhe Silva Caka.

Të ftuar:

Teuta Vodo – Zëvendësministre e Drejtësisë

Edvin Kukunja - këshilltar i Ministres së Drejtësisë

Besnik Maho - këshilltar i Ministres së Drejtësisë

Katrin Treska - Drejtoreshë e Përgjithshme Rregulltarore e Çështjeve të Drejtësisë;

Artan Lame - Drejtor i Përgjithshëm i ALUIZNI-t

Valdrin Pjetri - Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme:

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja- Përsëritje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e dytë të Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Në rendin e ditës kemi dy çështje shumë të rëndësishme: shqyrtimin nen për nen dhe miratimin e projektligjit “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” dhe projektligjit “Për kadastrën në Republikën e Shqipërisë”.

Në të dyja këto projektligje komisioni ynë është përgjegjës.

Relatorë në të dy projektligjeve janë kolegët Bashkim Fino dhe Klotilda Bushka.

Komisioni i Ligjeve ka administruar për të dy këto projektligje raportin e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, që ka qenë komision për dhënie mendimi. Gjithashtu, grupi i punës së bashku me relatorët dhe këshilltarët e komisionit kanë punuar gjatë gjithë javës që kaloi, por edhe dje, edhe sot me të dy draftet për të ardhur në variantet e integruara, të cilat do t'i diskutojmë sot në mbledhjen e Komisionit të Ligjeve.

Në fakt, këto dy projektligje janë shumë të rëndësishme. Në miratimin në parim ka pasur goxha diskutime nga kolegët e Komisionit të Ligjeve, por edhe nga përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, ALUIZNI-t, dhe të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Po ashtu në këtë diskutim kanë qenë të përfshirë intensivisht Ministria e Bujqësisë, por edhe aktorë dhe faktorë të tjerë që kanë punuar në grupin e punës ndërminstrior të ngritur për hartimin e këtyre dy projektligjeve.

Vazhdojmë me projektligjin e parë “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Nga Ministria e Drejtësisë kemi prezent zonjën Etilda Gjonaj, ministre e Drejtësisë, nga ALUIZNI, zotin Artan Lame, Drejtor i Përgjithshëm, dhe nga Drejtoria e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme zoti Aldrin Pjetri, Drejtor i Përgjithshëm.

U kërkoj relatorëve të fillojnë me diskutimin për projektligjin. Kërkoj vëmendjen e të gjithëve që, aty ku ka nene për të bërë sugjerime, të kërkojnë fjalën. Secili nga kolegët ka mbi tryezën e punës draftin e integruar të ligjit. Do të ecim me tabelën që ju keni para.

Zoti Fino, zonja Bushka, si do të procedojmë?

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ju bëtë një kërkesë për të qenë prezent në diskutimin, shqyrtimin dhe miratimin nen për nen të këtyre dy projektligjeve dhe unë jo vetëm shoqatën tuaj, por edhe të gjithë ata që kanë kërkuar të jenë dëgjues në diskutimin e këtyre dy projektligjeve i kam ftuar. Sot jemi në fazën

e diskutimit, shqyrtimit e miratimit nen për nen. Diskutimi në parim është bërë në një mbledhje tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jemi në fazën përfundimtare të diskutimit të këtyre projektligjeve. Grupi ndërmintor që ka punuar me këto dy projektligje, por edhe Komisioni i Veprimtarive Prodhuese ka një javë që po i diskuton këto projektligje. Gjithashtu, projektligji “Për kadastrën” do të jetë pas këtij ligji.

Shumë mirë, ju paskeni qenë iniciator, ja ku i kemi dy projektligje ku ju mund të merrni pjesë dhe të thoni mendimin tuaj. Shumë mirë, uluni. Nëse do të keni ndonjë sugjerim, nëse i keni me shkrim, dorëzoni në sekretari, me qëllim që t’ua shpërndajnë kolegëve. Pretendimet që i keni të shkruara, jua fotokopjon sekretaria e komisionit dhe ua shpërndan kolegëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju keni shumë gjëra për të thënë, por uluni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Sula, ju lutem mos e ngatërmoni shqyrtimin në parim të projektligjit me atë nen për nen. Në fakt, për të gjitha objeksionet që ju keni në lidhje me këto dy projektligje, ka qenë një seancë tjetër ajo e miratimit në parim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, në atë moment kur keni bërë kërkesën ju kam sjellë ftesën për të qenë prezent.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, nuk mund ta pengojmë punën e Komisioni të Ligjeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në bazë të Rregullores së Kuvendit, në momentin që unë e hedh projektligjin në faqen zyrtare të Kuvendit çdo faktor dhe aktor i interesuar kërkon të jetë prezent në diskutimin në parim. Në momentin që bëhet publik ligji, në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë, nuk është në detyrën e komisionit të bëjë njoftime për secilin nga grupet e interesit të interesuar për këtë gjë. Jeni ju që duhet të kërkonit të vini në Kuvend. Nuk e kam pasur kërkesën në fazën e diskutimit në parim, dhe kam pasur një komunikim me zotin Vorpsi, i kam thënë që do t’ua sjellim njoftimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, a mund të vazhdojmë me shqyrtimin dhe miratimin nen për nen të projektligjit?

Depozitoni me shkrim pa humbur kohë çfarë keni! Ju kërkonit të flisni, unë po ju them, nëse keni ardhur për të dhënë kontribut në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen të këtyre

projektligjeve, jeni të lutur që të gjitha materialet që keni me shkrim t'i depozitoni në sekretarinë e komisionit. Mund të bëjmë 5 minuta pushim që të fotokopjohen dokumentet dhe t'iu vihen kolegëve mbi tavolinë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, unë kam një Rregullore të Kuvendit për të zbatuar.

E shoh që nuk keni ardhur për të zgjidhur problemin. Nuk dua të bëj debat se në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen nuk është e njëjta gjë.

Ju lutem, kolegë relatorë, si do të procedojmë?

Klotilda Bushka - Unë gjykoj të fillojmë nga shqyrtimi dhe miratimi nen për nen i projektligjit për procesin e regjistrimit të titujve dhe më pas projektligjit për kadastrën.

Ulsi Manja- Zonja Ministre, a dëshironi të shpreheni shkurtimisht para se të kalojmë në shqyrtimin nen për nen.

Etilda Gjonaj- Faleminderit, zoti kryetar!

Këto dy projektligje i përkasin një procesi shumë intensiv për një periudhë të gjatë kohore, e cila ka filluar që në mandatin e parë të qeverisë “Rama”. Ajo që është bërë deri tani është se këto dy projektligje, si rezultat i adresimit të rekomandimeve të partnerëve ndërkombëtarë, duke përfshirë këtu Bankën Botërore, e cila ka kryer një analizë shumë të detajuar para disa vitesh dhe më pas ka përfshirë në një proces konsultimi një sërë aktorësh, është kryer një udhërrëfyes ku janë identifikuar jo vetëm problematika, janë adresuar problemet që kanë dalë nga ky udhërrëfyes i Bankës Botërore.

Pikërisht kjo gjendet e mishëruar në një plan veprimi, që përmban 7 objektiva, të cilat me menaxhimin e tokës duke e parë në plan kombëtar. Në këtë periudhë tremujore është punuar pikërisht mbi disa drafte të përgatitura më parë në një kohë shumë të shkurtër, por ka qenë shumë intensive. Nëpërmjet Komitetit për Menaxhimin e Tokës, të ngritur me urdhër të Kryeministrit, kemi finalizuar pikërisht këto dy projektligje, të cilat janë miratuar më pas edhe në qeveri.

I vetmi element që unë do të doja të shtoja është se janë kryer një sërë procesesh konsultimi, pikërisht jo vetëm për ta bërë një proces konsultimi formal, por për të pasur *feedback* dhe sugjerime konkrete nga të gjithë ata që preken ose janë marrë deri diku me çështjet e pronësisë. Këto të dy projektligje kanë ndjekur rrugën ligjore të hedhjes në Regjistrin e Konsultimit Publik, të cilat kanë qëndruar atje me afatin e parashikuar ligjor, ku çdo subjekt ka të drejtën dhe aksesin për të dhënë komentet dhe sugjerimet e tij.

Nga ana tjetër, na janë dhënë një sërë komentesh me shkrim edhe nga shoqatat e topografëve, të cilat sekretariati teknik, që është ngritur për të ndihmuar dhe për të asistuar komitetin për

menaxhimin e tokës, i ka reflektuar duke përmirësuar kështu të dy projektligjet që kanë ardhur sot për diskutim.

Gjithashtu është kryer një proces konsultimi në disa nga qytete, si Tiranë, Fier, Shkodër, Korçë, që të përmirësonim sa më shumë këto projektligje dhe të adresojmë të gjitha problematikat evidentuara deri tani, jo vetëm nga copëzimi ose legjislacioni i copëzuar në disa ligje dhe në disa vendime të Këshillit të Ministrave, por edhe për shkak të problematikës që gjenin këto ligje në zbatim. Gjithashtu, është bërë një konsultim ku pjesë të sekretariatit teknik kanë qenë përfaqësues nga të gjitha institucionet shtetërore, nga të gjitha ministratë e linjës që prekin pak ose shumë çështjen e titujve të pronësisë dhe menaxhimin e tokës, por kanë marrë pjesë në procese konsultimi dhe përfaqësues të pushtetit vendor, ku dihet që një pjesë e procesit kryhet nga bashkitë ose nga prefekturat.

Dy qëllimet kryesore që ne kemi me këto dy projektligje është pikërisht integrimi i proceseve transitorë në një të vetëm dhe shkurtimi i procedurave ose dokumentacionit duke zbatuar pikë për pikë ato të cilat, në fakt, e gjejnë burimin që nga Kushtetuta për të drejtën e pronës. Të gjitha këto janë të mishëruara në këto dy projektligje. Pa diskutim mund të ketë sugjerime nga vetë anëtarët e komisionit që ta përmirësojnë edhe procedurën, edhe të arrijnë në atë qëllim që ka reforma, por i gjithë procesi i konsultimit është kryer më së miri dhe në një periudhë e cila i është lënë afati i duhur me qëllim që secili të japë sugjerimet e tij.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Vazhdojmë me projektligjin “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”

Vazhdojmë me nenin 1.

Klotilda Bushka – Neni 1, sipas projeksionit të projektligjit të depozituar nga Këshilli i Ministrave nuk ka ndryshime.

Ulsi Manja - Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2.

Klotilda Bushka - Neni 2 “Qëllimi dhe fusha e zbatimit të ligjit” Kemi vetëm një ndryshim, në shkronjën “dh”, të pikës 1.

Nëse doni të lexoj përmbajtjen mendoj se është e qartë. Në qoftë se keni ndonjë çështje për të cilën kërkon sqarim...

Ulsi Manja – Mendoj se nuk është nevoja të lexohen...

Klotilda Bushka – Pra, bëhet vetëm një shtesë në germën “dh” të pikës 1, neni 2.

Ulsi Manja – Neni 2 “Qëllimi dhe fusha e zbatimit”.

Kush është dakord me nenin 2 së bashku me shtesën që është bërë? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 3 “Parimet e procesit”.

Klotilda Bushka – Neni 3 është sipas versionit të depozituar nga Këshilli i Ministrave, nuk ka ndryshime.

Ulsi Manja – Kush është pro nenit 3? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 3.

Kalojmë te neni 4 “Përkufizime”.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Është...

Kur të shkojmë te përkufizimet.

Për nenin 4 e ka kërkuar fjalën zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Kam një propozim për nenin 4. Duke qenë se një nga rubrikat, ku më në fund ky ligj rregullon pas një kalvari prej vitesh të tëra të një numri të madh qytetarësh, të cilët kanë qenë qytetarët më të ndershëm të kësaj Republike, janë pajisur ndër vite me tituj nga organet e pushtetit lokal, por padrejtësisht këta tituj zyrtarë, ligjorë në përputhje me gjithë paraqitjen e legjislacionit nuk janë regjistruar në regjistrat e hipotekës, pavarësisht se këta qytetarë ndryshe nga gjithë pjesa tjetër që ne kemi trajtuar, edhe paligjshmërinë, siç ka qenë rasti i legalizimeve, janë trajtuar ndryshe dhe për faktin se kanë qenë të ndershëm dhe për këtë arsye nuk u është bërë e mundur regjistrimi i pronës së tyre. Për herë të parë ky ligj rivendos të drejtën e tyre, duke u dhënë mundësinë për pronën që e gëzojnë prej vitesh, të cilën edhe me parashkrim fitues, në fakt, e kanë fituar tashmë prej mbi 10 vjetësh në kushtet më të pakta, por ka njerëz edhe me 20 vjet.

Pra, unë do të doja, pavarësisht parashikimeve të mëvonshme, që në nenin 4 të shtohet pika 17, që përkufizon trojet e dhëna për qëllime ndërtimi nga organet e qeverisjes vendore. Përkufizimi të jetë i tillë për pikën 17: “Trojet e dhëna për qëllime ndërtimi nga organet e qeverisjes vendore, trojet e dhëna me vendime të Këshillit të Komunës, të Këshillit të Bashkisë apo të Këshillit të Qarkut për qëllime strehimi apo ndërtime sociale-ekonomike para hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hysni!

Lidhur me propozimin e zotit Hyseni, relatorja e ka fjalën.

Klotilda Bushka – Jam dakord, sepse si problematikë ka gjetur zgjidhje në tekstin e projektligjit në një nen të cilin do ta kalojmë më pas. Pra, jam dakord që të përfshihet si amendim në tekstin e këtij neni, por përveç kësaj i gjithë neni 4 do të jetë me një përmbajtje totalisht të ndryshuar, i cili ka të bëjë me përkufizimet e të gjitha termave që përdoren në këtë ligj, ato që ishin ekzistuese, të cilat erdhën me draftin nga Këshilli i Ministrave, por edhe të tjera që ne i shtruum gjatë grupit të punës për të bërë të qartë zbatimin e ligjit në praktikë nesër.

Unë propozoj të miratohet ky nen me ndryshimet e bëra nga grupi i punës në tabelën që keni përpara të sqaruara, duke shtuar edhe ndryshimin e propozuar nga kolegu Hyseni, si dhe të renditen sipas rendit alfabetik.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 4, me riformulimin e bërë nga grupi i punës sipas tekstit integral, duke shtuar edhe pikën 17 sipas propozimit të kolegut Hyseni? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 4.

Para se të kaloj te neni 5, meqë janë të pranishëm në sallë zoti Vorpsi dhe zoti Sula, përpara miratimit në tërësi të ligjit për të dy projektligjet në fund fare do të keni mundësinë për 3 deri në 5 minuta të shpreheni, gjithmonë kur të kalojnë të dyja projektligjet para votimit në tërësi. Kalojmë te neni 5 “Autoriteti përgjegjës për realizimin e proceseve kalimtare”.

Klotilda Bushka – Neni 5 është sipas versionit të draftit të depozituar nga Këshilli i Ministrave.

Ulsi Manja – Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu 2 “Titujt mbi tokën bujqësore”. Seksioni I, neni 6 “Konsolidimi i marrëdhënies juridike të pronësisë mbi tokën bujqësore”.

Klotilda Bushka – Te neni 6, pika 1, germa “b” kemi një ndryshim të përmbajtjes, sepse është e nevojshme të qartësohet shtyrja e afatit 3-mujor, duke përkuar edhe me nevojën që paraqiti këtu deputeti Braçe me nismat e depozituara. Në fakt kishte shumë të drejtë me problematikat e hasura që shumë familje bujqësore, të cilat për shkak emigracioni ose padijenie nuk kanë mundur dot të aplikojnë për regjistrimin e titujve të tyre në përdorim dhe për të marrë titullin në pronësi. Në këtë nen është parashikuar të përfshihet kjo kategori, duke u dhënë një afat 3-mujor pas hyrjes në fuqi të ligjit për të aplikuar në mënyrë që të përfitojnë të drejtën e regjistrimit të titullit të pronësisë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Kush është dakord me nenin 6 me sugjerimin e bërë? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 7 “Kushtet për ligjësimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi”.

Klotilda Bushka – Në neni 7 kemi disa ndryshime. Në pikën 1 pas shkronjës c” shtohet shkronja “ç”. Në fillim të pikës 2 togfjalëshi “llojet” zëvendësohet me togfjalëshin “kriteret e përcaktimit”. Pika 3 hiqet. Në pikën 4 fjala “përditësimi” hiqet.

Teksti i secilës nga pikat që përmenda është në materialin që kanë përpara gjithë deputetët.

Ulsi Manja - Po, zoti Çuçi.

Bledar Çuçi – Faleminderit, kryetar!

Unë kisha një pyetje për draftuesit, kushdo që është marrë me këtë gjë edhe në mënyrë specifike. Kemi një kategori pronash, për të cilat në marrëdhënien e shitblerjes kanë hyrë ish-këshillat e rretheve, bashkitë, ish-komunat kryesisht me seksionet e financave që kanë qenë në kundërshtim me ligjin nr. 7980, ajo që ju thatë më parë. Kjo është çështje parimore. Si do t’i japë zgjidhje ligjvënësi, a do t’i trajtojnë këto apo jo? Ndoshta mund të jetë vendi ta përforcojmë këtu meqë ky është neni, i cili në një farë mënyre bën “amnistinë” për të gjitha parregullsitë që kanë ndodhur deri tani? Kjo gjë është mjaft e rëndësishme, sepse ka një numër të madh konfliktesh në gjithë Shqipërinë me këto prona, sidomos...

(Diskutime pa mikrofon)

Artan Lame – Zoti Çuçi, aty jemi te toka bujqësore, në një kohë që këto troje që ju po thoni, siç e tha edhe zoti Hyseni, janë sipërfaqe truall të dhëna për ndërtim...

Bledar Çuçi – Pyetja është edhe për tokat bujqësore.

Tom Doshi – Këtu bëhet fjalë për objekte që kanë qenë të ndërtuara para ’90-ës, objekti është privatizuar, kurse toka nuk është privatizuar ende, pavarësisht se ka edhe objekte, të cilat ndodhen në zonat që janë tokë bujqësore...

Ulsi Manja – Po, zoti Lame.

Artan Lame - Deri më sot kjo kategori ka qenë te Ministria e Ekonomisë, në Drejtorinë e Privatizimeve, **ndërsa sot** kjo kompetencë, pra shitja e truallit për objektet e privatizuara i kalon Agjencisë dhe është e rregulluar këtu. Shpresojmë se do ta mbyllim me aksion...

(Diskutime pa mikrofon)

Unë flas për institucionin.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Lame!

Zonja Bushka, fjala për ju, para se ta hedhim në votim nenin 7.

Klotilda Bushka – Shqetësimi që ngre deputeti Çuçi është i drejtë, është adresuar në ligj, jo në këtë nen, por në nenet e mëposhtme dhe i jep pikërisht zgjidhje çështjes së rregullimit të pronësisë së truallit kur është dhënë leje ndërtimi nga ish-autoritetet vendore për qëllime

banimi banorëve të një territori të caktuar. Ideja është, sepse në pjesën më të madhe të rasteve, për të mos thënë në të gjitha rastet, nuk bëhet fjalë për leje të dhëna për banim në tokë bujqësore, por në troje. Kjo çështje rregullohet në kapitullin e mëposhtëm, ku sqarohet situata e gjithçkaje që ka ndodhur me privatizimin, që sot ka qenë në kompetencën e Ministrisë së Ekonomisë dhe që kalon si kompetencë për mbikëqyrje tek Agjencia e Kadastrës.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Po, zoti Doshi.

Tom Doshi – Kush i përcakton sot çmimet për këtë truall?

Ulsi Manja – Zoti Lame.

Artan Lame – Është VKM-ja për përcaktimin e vlerës së trojeve. Pra, sa i takon kësaj pune ka një VKM, e cila duhet të dalë çdo vit, por nuk respektohet dalja çdo vit. Kjo VKM përdoret për të përcaktuar edhe shpronësimet, edhe blerjet, edhe legalizimet, pra të gjithë këto lloj procesesh. Pra, është e unifikuar në rang republike.

Ulsi Manja – Zoti Doshi, e ka fjalën.

Tom Doshi – Zoti Lame, sot këto troje nuk mund të privatizohen me çmimet e tregut. Objektet i ka privatizuar para një viti...

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, mbani qetësi!

Artan Lame – Flasim për banesat e vjetra të rindërtuara, të cilat nuk kanë marrë truallin apo për objektet? Sa u takon objekteve privatizimi i truallit bëhet me vlerën e truallit...

Tom Doshi – Në ditët e sotme apo para 20 vjetësh?

Artan Lame – Me VKM-në e vlerës së truallit, kjo që është sot. Sa u takon banesave është VKM nr. 442 që doli para 2 muajsh, e cila jep falas truallin deri në 300 metra ku janë ndërtuar shtëpitë para '90-ës.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Lame!

Hedhim në votim nenin 7. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 7.

Neni 8 “Trajtimi i titujve që nuk përmbushin kushtet për ligjësim”. Neni 8, sipas sugjerimeve të bëra nga relatorët ndryshohet tërësisht. Ju e keni mbi tryezë tabelën.

Zonja Bushka, ju lutem, shkurt!

Klotilda Bushka – Neni 8 është ndryshuar tërësisht. Në fakt, është diskutuar mes përfaqësuesve të Ministrisë së Bujqësisë dhe përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë që të qartësojnë qartë se cili është rrethi i subjekteve që përfitojnë nga çështja e ligjësimit të titujve

të pronësisë mbi tokën bujqësore, duke përfshirë ato kategori që nga studimet dhe nga problematikat e përditshme të dy institucioneve rezultojnë pa zgjidhje, sepse nuk ka mekanizma ligjorë.

Neni 8 zgjidh përfundimisht çështjen e atyre që kanë një titull përdorimi të saktë, të pasaktë dhe që kthehen përfundimisht në pronarë me një titull pronësie.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Kush është dakord me nenin 8, sipas propozimit të bërë nga relatorët? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 9 “Mospërputhjet ndërmjet titullit të pronësisë dhe gjendjes së posedimit të faktit”.

Klotilda Bushka – Në pikën 1 të nenit 9 hiqet fjala “përditësim”. Në pikën 2, në germën “a” të pikës 1 shtohet pas shprehjes “me qira”, “dhe sipas legjislacionit në fuqi”. Kjo është më shumë për të harmonizuar procedurat që ndiqen sot me ligjet e tjera në fuqi.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 9...

Klotilda Bushka – Më falni, zoti kryetar, kam edhe diçka tjetër!

Në germën “b” të pikës 1 në fund shtohen fjalët: “Sipas përcaktimeve të pikës 5, të nenit 30, të ligjit për kadastrën”. Në pikën 2 togfjalëshi “Në nenin 37 të ligjit për kadastrën” zëvendësohet me togfjalëshin “Në nenin 64 të këtij ligji”. Në pikën 3 në fund shtohen fjalët: “Sipas legjislacionit në fuqi për qiradhënien e tokës bujqësore në pronësi të shtetit”. Në pikat 2 dhe 3 fjala “fshati” zëvendësohet me “kooperativa dhe/ose ndërmarrjet”.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Hedhim në votim nenin 9, sipas propozimit të bërë nga relatorët dhe që është përfshirë në tekstin integral të projektligjit. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 9.

Zonja Bushka, do t’ju kërkoja vetëm të përmendni pikat se ku është bërë ndryshimi dhe jo se si është bërë, sepse kolegët e kanë përpara materialin, në mënyrë që të fitojmë kohë. Kush kërkon të ndërhyjë dhe të bëjë pyetje për nene të caktuara, ju lutem, kërkon fjalën, por relatorët të lexojnë në material për efekt të regjistrimit audio vetëm nenet ku është ndërhyrë.

Kalojmë te neni 10. Neni 10 i përket Seksionit III “Përfundimi i pajisjes me tituj pronësie, kushtet për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”.

Klotilda Bushka – Në këtë nen, në pikën 1 ndryshohen vetëm shkronjat “a” dhe “c”.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 10, sipas relatorëve? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 11 “Sipërfaqe që kalon pronësi pa shpërblim”.

Klotilda Bushka – Në këtë nen riformulohet germa “b” e pikës 1, gjithashtu riformulohet në paragrafin 2, pika 4.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 11, sipas variantit që është në tekstin integral? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 11.

Kalojmë te neni 12 “Procedura e kalimit në pronësi pa shpërblim”.

Klotilda Bushka – Neni 12 ndryshohet tërësisht. Më thatë, të mos i lexoj, kështu që tekstin e keni përpara.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 12, i cili është ndryshuar tërësisht sipas përmbajtjes që ju keni në draftin...?

(Diskutime pa mikrofon)

Neni 12 “Procedura e kalimit në pronësi pa shpërblim”, sipas relatorëve është ndryshuar tërësisht. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 12.

Kalojmë te neni 13 “Dhënia me qira e tokës jobujqësore”.

Klotilda Bushka – Në nenin 13 pas paragrafit 1 shtohet një fjali dhe në paragrafin e fundit hiqet një togfjalësh me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet e bujqësisë.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 13, sipas propozimeve të bëra nga relatorët bashkëngjitur tekstit integral? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu 3 “Ligjësimi dhe regjistrimi i ndërtimeve pa leje, objekteve pa tituj pronësie dhe oborreve në përdorim”. Seksioni I “Ndërtimet pa leje”. Ky seksion fillon me nenin 14.

Neni 14 “Evidentimi i ndërtimeve pa leje”.

Klotilda Bushka – Në nenin 14 shtohen pikat 1 dhe 4. Në këtë kuptim, ndryshon emërtimi i pikave të tjera. Në pikën 1, që tashmë do të bëhet pika 2, fjala “përdorim” zëvendësohet me fjalën “ndërtimit”.

Ulsi Manja - E hedhim në votim nenin 14. Kush është pro?

Po, zoti Çuçi.

Bledar Çuçi – Po shoh që në ligj është cilësuar emri i projektit. Kjo gjë nuk shkon, mendoj unë, si teknikë legjislativë të thuash: “Projekti “Krijimi i sistemit të të dhënave gjeohapësinore”, domethënë mund të gjendet një formulim tjetër ligjor...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame – Më lejoni ta shpjegoj!

Prej disa kohësh, ASIG-u në *site*-n e vetë, përveç funksioneve të tjera, ka marrë edhe një funksion që realisht është gjë e mirë, që publikon hartat e VKM-ve ose të ligjeve, të cilat kanë harta, por që në letër është praktikisht e pamundur të lexohen si harta. Atje publikohen me një cilësi të lartë. Që nga momenti që miratohet VKM-ja thuhet: “Harta shoqëruese është sipas asaj të publikuar tek ASIG-u”. Në rastin konkret, ASIG-u ka një ortofoto në cilësi shumë më të lartë, që është shumë më e mirë se *Google Earth*-i, e cila është siguruar mbi bazën e një projekti që ka atë emër zyrtar dhe është miratuar me një VKM që mbart po atë emër. Pra, ne mbartëm tërësisht emrin e projektit siç është. Pra, nuk mund të ketë një projekt tjetër me po atë emër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja - Ju lutem!

Gjeni një fjalë që i përshtatet, të zëvendësojmë fjalën “projekt” me një...

Zoti Hyseni ka një propozim.

Alket Hyseni – “Ortofoton e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave”. Kaq!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja - Mund të citoni VKM-në me të cilën është miratuar dhe e mbyllim.

Kush është pro me ndryshimet që do të bëhen te pika 1 për të gjetur fjalën e duhur në vend të fjalës “projekt” të nenit 14? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 15 “Kriteret për legazim”.

Klotilda Bushka - Neni 15 sipas versionit të depozituar nga qeveria.

Ulsi Manja - Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 16 “Përgjegjësia në raste fatkeqësisht”.

Klotilda Bushka - Neni 16 është ndryshuar tërësisht, sipas versionit të materialit që keni para.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja - Kur të ketë sugjerime, zonja Xhina, mund të shtypë mikrofonin, të bëjë pyetje e të marrë fjalën!

Elena Xhina – Sugjerimi i vlen projektligjit, mos u shqetësoni kaq shumë!

Isha duke e diskutuar me Alketin nëse ia vlente për ta thënë...

Ulsi Manja - Çdo sugjerim që bëhet nga kolegët është vlerë për projektligjin.

Elena Xhina – Do të ishte mirë që tek titulli të shtonim fjalët “fatkeqësi natyrore”. Kjo ishte ideja. Është thjesht teknike.

Ulsi Manja - Ka propozim? Jemi dakord me sugjerimin?

Kush është dakord me nenin 16, sipas propozimit të bërë nga relatorët dhe me sugjerimin për titullin e nenit nga zonja Xhina? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 17. Ky nen është njësoj sipas variantit të propozuar.

Artan Lame - Ju kërkoj ndjesë! Ka mundësi ta marr fjalën?

Ndoshta po flas pa u konsultuar, por kam frikë se nuk bëhet fjalë vetëm për fatkeqësitë natyrore. Në qoftë se objekti bie për shkak të problemeve të brendshme të vetë objektit, nuk është fatkeqësi natyrore. Pra, fatkeqësi quhen të dyja rastet, kur bie se e mori lumi, dhe rasti tjetër kur bie se nuk i ka hedhur çimento. Në të dyja rastet është fatkeqësi, por nuk janë natyrore. Kështu që kam frikë se duhet lënë vetëm fjala “fatkeqësi”.

Klotilda Bushka – Jam dakord me atë që parashtroi zoti Lame. Praktikisht, ky nen është vënë pikërisht për të evituar përgjegjësinë e organeve të shtetit sa i takon sigurisë së ndërtimeve të bëra pa leje nga poseduesit informalë, sepse nëse nesër do të ligjësohen këto ndërtime dhe do të marrin titullin e poseduesit, nëse do të ndodhë një cen në këtë pasuri, përgjegjës do të jetë shteti, sipas dispozitave të Kodit Civil. Pra, nuk bëhet fjalë vetëm për fatkeqësi natyrore, por edhe për ato që vijnë nga të metat e veprës, për të cilat shteti nuk mund të jetë përgjegjës, sepse ka dhënë lejen e ndërtimit dhe nuk e ka kontrolluar zhvillimin e asaj prone.

Ndaj, meqenëse ne e miratuam, sepse kam përshtypjen që kaloi si moment, mendoj ta lëmë të hapur dhe në miratimin në tërësi do të bëj sugjerimin që ta heqim fjalën “natyrore”.

(Diskutim pa mikrofon)

Ulsi Manja - Ju lutem, po të shikoni përmbajtjen e nenit, në pjesën e dytë flet për shkaqet natyrore dhe/ose nga përdorimi i banesës. Këta dy paragrafë mund të merren dhe të vendosen si tituj: “Përgjegjësia në raste fatkeqësish natyrore dhe/ose nga përdorimi i banesës”, sepse përmbajtja përfshin jo vetëm rastet e fatkeqësive natyrore, por edhe rastet e amortizimit të banesës. Është çështje teknike. Duhet të përshtatim titullin e dispozitës me përmbajtjen. Përmbajtja është shumë e saktë, në fakt, kështu që ...

(Diskutim pa mikrofon)

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Po lexoj projektligjin e depozituar nga qeveria dhe ndryshimin që është bërë. Më rezulton se në variantin e qeverisë është e qartë se nuk ka kompensim apo dëmshpërblim

në rast fatkeqësish si pasojë e faktorëve që ndikojnë në qëndrueshmërinë e ndërtimit pa leje. Pra, kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë, ka ndërtuar jashtë kritereve e standardeve, cilësia, pra ka themelet për 3 kate dhe ka ndërtuar 15 kate.

Te varianti i rregulluar ka humbur fjala që ndikon në qëndrueshmërinë e ndërtimit si pasojë e faktorëve që ndikojnë në qëndrueshmërinë e ndërtimit pa leje. Unë pajtohem me relatoren që ta lejë për në fund dhe ta shikojë me qetësi, sepse fakti që godina mund të bjerë, mund të ndodhë për shkaqe natyrore, qëndrueshmëria mund të jetë shumë e mirë dhe në këtë rast besoj se është tjetër problem, ose për shkak të përdorimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Megjithatë, te varianti i qeverisë thuhet: “Si pasojë e faktorëve që ndikojnë në qëndrueshmërinë e ndërtimit pa leje”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bledar Çuçi - Ne biem dakord që do ta trajtojmë në parim, që për çfarëdolloj shkak bie ndërtesa, përgjegjësia është e atij. Pra, edhe kur kushtet teknike janë të dobëta, materialet jocilësore, projekti nuk ka qenë i saktë, pra për të gjitha këto, do të biem dakord në parim që përgjegjësinë do ta mbajë ai. Mendoj të gjejme një formulim që t’i përmbledhim të gjitha dhe nuk kemi pse të zgjatemi.

Ulsi Manja – Po, zoti Lame.

Artan Lame - Pikërisht për shkak të kësaj ndjeshmërie, ne veprojmë në këtë mënyrë: për objektet deri në 4 kate, përgjegjësinë e ka tërësisht qytetari. Për objektet mbi 4 kate i kërkojmë qytetarit të marrë një konstruktor të licencuar, sepse ky lloj objekti do të thotë që do të shitet dhe shteti në këtë moment ka një lloj përgjegjësie duke kërkuar firmën e një konstruktori, i cili firmos dhe jep garancinë që ky objekt është i qëndrueshëm. Pra, këtu bëhet fjalë për objektet deri në 3 kate, për të cilat përgjegjësinë e mban vet qytetari dhe për ato mbi 4 kate është konstruktori që firmos dhe, po ndodhi gjë, mban përgjegjësi.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Lame!

Fjala për zonjën Bushka.

Klotilda Bushka – E thashë edhe më sipër që, kur të bëjmë shqyrtimin në tërësi, do të bëj një kërkesë për ta ndryshuar termin “fatkeqësi”, sepse riformulimi i nenit 16, siç sillet nga grupi i punës, përbëhet nga dy paragrafë: paragrafi i parë thotë “E mban përgjegjës poseduesin e paligjshëm për çdo të metë që ka vepra, të çfarëdolloj pasojë që vjen nga çfarëdolloj fatkeqësie”.

Paragrafi i dytë, ku në gjykimin tim gabimisht shtuam fjalën “natyrore”, ka të bëjë me detyrimin që ka poseduesi dhe përgjegjësinë për të shpërblyer të tretët nëse vijnë rreziqe nga vepra.

Kështu që mendoj ta mbyllim diskutimin për këtë nen. Në shqyrtimin në tërësi unë do të bëj propozimin që ta heqim fjalën “natyrore”.

Ulsi Manja – Mendoj të gjejmë një riformulim për titullin e dispozitës para miratimit në tërësi dhe të mos mbetemi peng i një neni.

Kalojmë te neni 17.

Zoti Fino si relator thotë se nuk ka ndryshim nga varianti i sjellë nga qeveria.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 18 “Legalizimi i ndërtimit”.

Klotilda Bushka – Sugjeroj të shtohet pika 4 në fund të nenit, e cila ka të bëjë me faktin kur heq dorë poseduesi i ndërtimit nga e drejta për të përfituar legalizimin.

Ulsi Manja – Po, faleminderit!

Kush është dakord me nenin 18 sipas propozimit të bërë nga relatorët? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 19.

Sipas relatorëve, ndryshon përmbajtja e germës “b” të pikës 3, ndryshohet pika 5 dhe përmbajtja e pikës 8. Kush është dakord me nenin 19 sipas propozimit të bërë nga relatorët? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 20. Rastet kur subjekti posedon më shumë se një ndërtim pa leje.

Klotilda Bushka – Neni 20 ka një saktësim, është vendosur tashmë që duhet të zgjidhet situata kur subjekti ka më shumë se një ndërtim pa leje. Na duhet ta rregullojmë këtë situatë në mënyrë që të mos aplikojmë çmimet favorizuese që aplikohen sot për poseduesit e ndërtimeve pa leje, sepse janë përfitime të padrejta dhe krijohet një pabarazi midis subjekteve të së drejtës në Shqipëri.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Kush është dakord me nenin 20, sipas riformulimit të pikës 3? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 21 “Kompensimi i pronarëve joposedues”.

Edhe te ky nen, në fjalinë e fundit të pikës 4 ka një sugjerim nga relatorët.

Klotilda Bushka – Në fjalinë e fundit, shprehja “sipas nenit 37 të ligjit “Për kadastrën” hiqet dhe saktësohet fakti i të drejtave të pronarëve real, të cilët nuk janë posedues për efekt të ndërtimeve pa leje që të kompensohen realisht sa i takon realisht zënies së pronës së tyre të ligjshme nga ndërtimet pa leje.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 21 sipas riformulimit të pikës 3? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 22 “Rregullim i veçantë për ata që disponojnë parcelën sipas një akti të ligjshëm të paregjistruar. Ky nen është sipas variantit të propozuar nga qeveria. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 23 “Mosmarrëveshjet për të drejtat mbi ndërtimin që legalizohet”. Edhe ky nen është sipas variantit të qeverisë. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 24 “Konfliktet gjyqësore për të drejtat mbi truallin”.

Ka një riformulim të pikës 2 për efekt qartësimi.

Kush është dakord me nenin 24, për riformulimin e pikës 2? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 25 “Paditë e kthimit të sendit”, sipas variantit të qeverisë.

Fjala për zotin Çyrbja.

Jurgis Çyrbja – Propozoj që të hiqet neni 25, pasi bie në kundërshtim me nenin 197 të Kodit Civil, sepse padia ka efekt informues dhe jo bllokues.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Kjo është një çështje, e cila ka të bëjë me faktin kur ka një konflikt gjyqësor midis pronarit të truallit dhe ndërtuesit informal, i cili ka aplikuar në zyrën përkatëse për legalizimin e ndërtimit dhe objekti i gjykimit është lirim dhe dorëzim trualli . Në këto procese, edhe në ligjin aktual për legalizimet e ndërtimeve pa leje, parashikohet që nisja e një procesi të tillë, me objekt lirim dhe dorëzimin e truallit, e pezullon procedurën e legalizimit. Është për efekt të garancisë juridike dhe për siguri ligjore të pronarit të truallit, i cili ndoshta nuk ka dëshirë të përfitojë kompensimin, ndërkohë që ndërtuesi informal legalizohet në ndërtimin e tij, por kërkon t’i lirohet objekti i vet, pra trualli i lirë, për ta përdorur për qëllime të interesit të vetë.

Në këto raste, pezullimi i parashikuar në ligj, pra, pezullimi i procedurës së legalizimit është i nevojshëm, sepse, nëse nuk pezullohet procedura e legalizimit, në rastin e një vendimi për lirim, dorëzim sendi, nuk ka më efekt zbatimi i atij vendimi, sepse nuk ka çfarë të lirohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është tashmë një koncept që parashikohet në ligjin aktual dhe sigurisht ka një interes publik për të mbrojtur të drejtat e pronarëve të ligjshëm, është një standard tashmë i vendosur për pronarët e truallit dhe sipas Kodit Civil, regjistrimi i padive pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nuk e pezullon apriori një proces, por në rastin konkret, kjo gjë mund të vendoset me ligj dhe deri tani ka qenë një standard i pranuar. Unë jam që të jetë kështu. Nëse jemi të gjithë dakord që të vendoset në bazë të një vendimi “masë sigurie për pezullimin e procedurës së legalizimit”, jam e hapur ta vendosim të gjithë.

Ulsi Manja – Po, zoti Çyrbja.

Jurgis Çyrbja – Kam përshtypjen që ta vendosë gjykata me siguri padije në rast se duhet të bllokohet ose jo. Pra, ka siguri padije dhe nuk kemi pse ta rregullojmë me ligj këtë pjesë. Unë i qëndroj propozimit tim për shfuqizimin e këtij neni.

Faleminderit!

Alket Hyseni –Në mbështetje të logjikës së zotit Çyrbja, sapo rregulluam pikën 2 të nenit 24 duke e specifikuar këtë pikë vetëm me shprehjen taksative të gjykatës që të mos u lëmë vend organeve administrative të marrin rolin e gjykatës. Jo më dot Kodi Civil, ka parashikuar që depozitimi i padisë ka efekt njohës. Po të ishte Kodi Civil do të kishte thënë: “Depozitimi i padisë ka efekt pezullues”. Efektin pezullues e ka vetëm vendimi i gjykatës dhe me të drejtë çdo pronar joposëdës që ka nisur padinë, do t’i kërkojë gjykatës edhe pezullimin. Është gjykata që do të çmojë rast pas rasti nëse jemi në kushtet kur kërkohet pezullimi i objektit të padisë apo jo. Sjellim kundërshti me nenin 24 nëse e miratojmë kështu siç është.

Prandaj, meqë edhe relatorja nuk ka ndonjë problem për këtë, gjykoj të pranohet propozimi i zotit Çyrbja.

Ulsi Manja - Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, jam dakord me atë që thotë relatorja për përmbajtjen e këtij neni. Ndoshta titulli na krijon probleme, sepse në këtë nen thuhet se çfarë bën agjencia shtetërore, kadastra. Pra, rregullon veprimtarinë e kësaj agjencie, në një kohë kur ka një proces gjyqësor për lirim midis pronarit joposëdës dhe atij që e ka zënë. Çfarë thuhet këtu? Këtu nuk thuhet se gjykata bën këtë, por thuhet se agjencia, me vënien në dijeni nga pala apo nga gjykata (se është ngritur padia), pezullon procesin e legalizimit, pra standardizon, rregullon atë çfarë realisht

ka ndodhur shpesh në praktikë, por pa e pasur në ligj atë që do të bëjë agjencia e re, e cila do të krijohet me ligjin që do të diskutojmë.

Titulli “Padia e kthimit të sendit” më duket sikur nuk përputhet me veprimet, sepse titulli duket sikur është në Kodin Civil, ndërsa ligji ka të bëjë me veprimtarinë që do të bëjë agjencia. Ndoshta mund të bëhet një rregullim i titullit.

Bledar Çuçi – Hidheni në votim.

Ulsi Manja – Nuk është problemi për ta hedhur në votë, sepse në votë e hedhim kollaj. Problemi është se si do të zbatohet vendimi i gjykatës në rast se ka vazhduar procedura e legalizimit.

Alket Hyseni – Atë e ka gjykata në dorë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Lame...

Artan Lame – E kemi diskutuar këtë. Kjo është një praktikë që kështu ndiqet edhe sot. Ne i qëndrojmë...

Ulsi Manja – Si ndiqet praktika sot?

Artan Lame - Ne sot pezullojmë në mënyrë absolute çdo lloj procedure legalizimi kur ndërhyt procesi gjyqësor në mes.

Ulsi Manja – Edhe pa vendim për siguri padie? Mjafton të vihen në dijeni që ka proces gjyqësor?

Artan Lame – Nëse procesi gjyqësor është i hapur për ndërtimin, pra nëse lidhet direkt me të, edhe pa siguri padie.

Ulsi Manja - Qenka e zgjidhur gjëja!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

(Diskutime pa mikrofon)

Unë jam i mendimit që edhe pa vendim gjykate të pezullohet procedura e legalizimit. Në momentin kur ka gjyq mes...

(Diskutime pa mikrofon)

Ne nuk jemi këtu vetëm për ata që kanë ndërtuar pa leje, por që të mbrojmë edhe interesat e ish-pronarëve. Këto janë dy anët e një medaljeje.

(Diskutime pa mikrofon)

Drejtori i ALUIZNI-t po thotë se praktikisht e kemi pezulluar praktikën e legalizimit.

Alket Hyseni – Prandaj po e bëjmë këtë ligj ne, se deri sot nuk po ecin gjërat. Nuk po e bëjmë ligjin që të jemi siç ishim.

Ulsi Manja – E hedhim në votim, se nuk ka asnjë problem.

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Fino, ju lutem! Zonja Hysi...

Ka një propozim të kolegut Çyrbja, për ta hedhur me votë që neni 25 të hiqet nga teksti i projektligjit.

Sipas Rregullores unë do të hedh propozimin e fundit në votim për të vajtur më pas te propozimi i relatorëve.

Kush është pro propozimit të kolegut Çyrbja, që të hiqet nga teksti?

Janë 4 vota pro.

Kush është kundër?

Nuk miratohet.

Neni 25 mbetet sipas variantit të propozuar nga qeveria.

Kush është dakord me nenin 25, sipas variantit të propozuar nga qeveria?

4 vota janë kundër. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 25.

Kalojmë te neni 26, “Trajtimi i veçantë”.

Klotilda Bushka – Te neni 26, duke qenë se bëhet fjalë për trajtimin e veçantë të atyre personave që, nëse nuk përfitojnë, duhet të trajtohen me strehim social sipas normave të strehimit dhe duke qenë se në ligjin aktual, në propozimin e sjellë, bëhej fjalë për 80 metra katrorë sipërfaqe, për ne kjo është në papërpunueshmëri me ligjin e strehimit social, sepse i kemi vënë atje normat. Vendorsëm ta heqim, sepse referenca për zgjidhjen e të drejtave të atyre që preken do të jetë te ligji për strehimin social.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 26, sipas riformulimit të propozuar nga relatorët? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 27, “Ndërtimet e ngritura nga personat juridikë në proces falimentimi”.

Pika 1 ndryshon përmbajtjen, thonë relatorët.

Jeni dakord me nenin 27, sipas propozimit të bërë nga relatorët?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 28.

Nuk ka ndryshim nga varianti i qeverisë.

Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 29.

Sipas propozimit të relatorëve, neni 29 ndryshon tërësisht përmbajtjen e nenit. Besoj se neni 29 është dakordësuar edhe me grupin e punës.

Kush pro nenit 29, “Ndërtimet e përjashtuara nga legalizimi”, sipas varianti të propozuar nga relatorët? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te seksioni i dytë. Ky seksion vazhdon me nenin 30, “Objektet pa titull pronësie dhe oborret në përdorim”.

Kush është dakord me nenin 30? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 31.

Ky nen i përket kreut IV, “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike shtetërore.”

Neni 31, “Dispozitë e përgjithshme për procesin”.

Kush është dakord?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 32, “Parimet e përditësimit të pronës shtetërore.”

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 33, “Përditësimi nga institucioni administrues, njësia e vetëqeverisjes vendore”.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 34, “Miratimi i listës përfundimtare dhe regjistrimi”.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 35, “Përditësimi i pjesshëm i listës së pronave shtetërore”.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 36, “Dispozita autorizuese”.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 37.

Këtu ka një ndryshim.

Kush është dakord me nenin 37, me ndryshimet e propozuara nga relatorët, sipas tekstit integral që keni mbi tavolinë? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 38.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 39, “Pezullimi i procedurave”.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 40, “Tarifat e regjistrimit për institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 41, “Dispozitë detyruese”.

Alket Hyseni – Për titullin kam një rezervë. Nuk shkon “Dispozitë detyruese”.

Usli Manja – Ju lutem, një propozim!

(Diskutime pa mikrofon)

E miratojmë nenin 41, me variantin që, deri në miratimin në tërësi, zoti Hyseni të gjejë një propozim konkret për titullin.

Kush është dakord me nenin 41? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 42, “Digjitalizimi i të dhënave”.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 43, “Përditësimi i të dhënave për pasuritë e sindikatave”.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu V “Rregullimi i pronësisë në zonat e stimuluar”.

Neni 44, “Dispozitë e përgjithshme për procesin”.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 45, “Evidentimi dhe plani i rilëvrimit”.

Kush është pro?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 46, “Kalimi i pronësisë mbi truallin e njësive ndërtimore”.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 47, “Dispozitë ndaluese”.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 48.

Ka një propozim nga relatorët, që fjalë e fundit e pikës 1 të hiqet.

Kush është dakord?

Klotilda Bushka – Dakord.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 48, me formulimin e bërë nga relatorët?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 49, “Ligjësimi i njësive ndërtimore”.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 50, “Prioriteti dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve”.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 51, “Rregullim i posaçëm”.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 52, “Ruajtja e statusit të zonës”.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu VI, “Koordinimi me procesin e trajtimit të pronës së subjekteve të shpronësuar”.

Kreu VI fillon me nenin 53, që është dispozitë referuese.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 54, “Bashkërendimi me proceset kalimtare”.

Ka një propozim nga relatorët.

Klotilda Bushka – Shtohet një paragraf 2/1, pas pikës 2. Kjo ka të bëjë me sigurinë juridike për kompensimin fizik të subjekteve të ligjit nr.133/205, ish-pronarët.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 54, sipas sugjerimit të bërë nga relatorët?

(Diskutime pa mikrofon)

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 55, “Pasuritë e zhvilluara dhe mbrojtja e të tretëve”

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Vasilika Hysi – Është fondi i tokës 55-a.

Ulsi Manja – Dakord.

Nuk ka ndryshime neni 55.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 55, i cili bën fjalë për fondin e tokës.

Kalojmë te kreu VII, “Trajtimi i problemeve të keqzbatimit të ligjit”.

Ky kre fillon me nenin 56. Te neni 56 relatorët sugjerojnë ndryshimin e përmbajtjes sipas variantit që është në tekstin integral.

Kush është dakord me nenin 56, sipas sugjerimit të relatorëve?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 57, “Pasaktësitë hartografike dhe gabimet e tjera materiale”.

Nuk ka ndryshime.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 58, “Trojet e dhëna për ndërtim, organet vendore dhe rregullime të tjera”.

Ka një ndryshim tërësor të nenit nga relatorët dhe grupi i punës, sipas përmbajtjes që keni në variantin e ligjit bashkëngjitur.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 60, “Nisja e procedurës së kalimit të pronësisë”.

Relatorët propozojnë që në pikën 3 të hiqet fjala “përditësimi”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Neni 59 nuk ka ndryshim. Është në rregull.

Ulsi Manja - Kreu VIII, “Privatizimi i truallit shtetëror në përdorim”.

Neni 59, “Kalimi i pronësisë mbi truallin shtetëror në përdorim”. Nuk ka ndryshime.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 60. Nga relatorët propozohet që në pikën 3 të hiqet fjala “përditësimit”. “Nisja e procedurës për kalimin e pronësisë”.

Kush është dakord me nenin 60 sipas propozimeve të bëra nga relatorët?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka...

Miratohet.

Neni 61, “Mënyra e kalimit të pronësisë dhe regjimet e pagesës”.

Relatorët sugjerojnë në germën “a” dhe “b” të pikës 1 që fjala “objekt” të zëvendësohet me fjalën “ndërtesë”. Ka edhe një ndryshim në pikën 3.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu IX, “Mbivendosjet”.

Neni 62.

Klotilda Bushka – Këtu do të shtojmë kreun IX me nenet 62 dhe 63, si dhe ndryshojmë numërtimin e krerëve dhe të neneve vijues.

Ulsi Manja – Dakord.

Jeni dakord me nenin e ri 62, me propozimet e bëra nga relatorët?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 63, “Mbivendosjet fiktive”.

(Diskutime pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Referojuni kolonës së tretë të tabelës! Ju thashë, do të do të shtojmë kreun IX me nenet 62 dhe 63, si dhe ndryshojmë numërtimin e krerëve dhe të neneve vijues.

(Diskutime pa mikrofon)

Nenet 62 dhe 63 janë pjesë e një kreu të ri të shtuar.

(Diskutime pa mikrofon)

Neni 64, sipas versionit ekzistues që ka ardhur nga Këshilli i Ministrave hiqet.

Neni 63, “Mbivendosjet fiktive”.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Titulli i dispozitës. Çdo miratim dhe votim nën për nen me titull dispozite.

Neni 64, hiqet.

Vasilika Hysi – Është një problem i teknikës legislative, sepse janë shtuar dy nene të reja dhe kanë marrë numërtimin 62 dhe 63, ndërkohë që ato janë nene të reja, të cilat duhet të numërtohen, aktualisht, në draftin e depozituar nga qeveria.

Neni 62 që quhet “Ankimimi administrativ” është rregulluar dhe në tabelën që ka bërë relatorja, përsëri është “Ankimimi administrativ”, por e ka rregulluar përmbajtjen dhe kanë shtuar një paragraf të dytë dhe të tretë.

Ulsi Manja – Numërtimi i neneve bëhet në fund.

Neni 64, që hiqet.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu X, “Ankimimi”.

Neni 65, “Ankimimi administrativ”.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 66, “Ankimimi gjyqësor”. Hiqet ky nen.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 67, “Shqyrtimi i padive të ngjashme”. Hiqet edhe ky nen.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu XI, “Të ardhurat nga proceset transitorë”.

Neni 68, “Ndarja e të ardhurave të arkëtuara nga proceset kalimtare të pronësisë”.

Këtu ka një sugjerim nga relatorët. Neni 65 bëhet neni 68 për shkak të shtimit të neneve të reja të paraqitura më sipër, si dhe ka një riformulim të fjalës hyrëse e pikës 1. Shtohen dy germa të pikës 1 dhe riformulohet pika 2 sipas variantit që ju keni në tekstin e projektligjit.

Neni 68.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu XII, “Dispozitat kalimtare dhe të fundit”

Fillon me nenin 69, “Dispozita për aktet e marrjes së tokës në pronësi dhe verifikimin e titujve”.

Klotilda Bushka – Ky ishte ish-neni 66, i cili tani bëhet 69 për shkak të shtimit të neneve të reja. Kemi ndryshime në pikën 2 dhe 3 në termin “komisione vendore” që zëvendësohen me

“prefekt”. Ndryshon pika 4. Ndryshon pika 5. Në pikën 8 zëvendësohet “q” me togfjalëshin “të cilat” për shkak të përsëritjes shumë herë të fjalëve brenda së njëjtës fjali.

Ulsi Manja - Neni 69, sipas propozimeve të bëra nga relatorët.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 70, “Dispozitat për procedurat e legalizimit”, sipas ndryshimeve të bëra nga relatorët në tekstin integral.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 71, “Dispozita për objektet pa titull pronësie dhe oborret në përdorim”, sipas tekstit.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 72, “Dispozita për rregullimin e pronësisë në zonat e stimuluar”.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 73, “Detyrimi për taksën e përdorimit të truallit shtetëror”.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 74, “Trajtimi i kërkesave të bashkësive fetare”, sipas propozimeve të relatorëve.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 75, “Baza e të dhënave për proceset kalimtare”.

Klotilda Bushka – Shtohet neni 75, i cili ka të bëjë me rregullat që ne aplikojmë sot për procesin e të dhënave.

Ulsi Manja - Neni 75, sipas propozimit të relatorëve.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 76, “Kontrolli administrativ”.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 77, “Nxjerrja e akteve nënligjore”.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 78, “Shfuqizime dhe ndryshime”.

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 79, "Modelet e akteve administrative", me propozimet e relatorëve.

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

Neni 80, "Hyrja në fuqi".

Klotilda Bushka – Kërkohet që hyrja në fuqi të jetë data 1 shkurt, 2019.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 80?

Pro? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka.

Miratohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Pra, këtu mbarojmë me shqyrtimin dhe votimin nën për nen të projektligjit "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë".

Kalojmë te projektligji tjetër "Për kadastrën"

Burrë – Së pari, desha të gjykoja në lidhje me një veprim të komisionit, të cilin e konsideroj të diskutueshëm si përfaqësues i demokracisë përfaqësuese, sepse kur relatori kishte relatuar në çështje një nen, ju e lexonit dhe të gjithë ngrinin dorën menjëherë pa u bindur dhe pa u arsyetuar...

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja - Ju lutem, ju nuk jeni këtë për të gjykuar deputetët dhe as Rregulloren e Kuvendit! Mos spekuloni me mundësinë që ju dhashë për tëshprehur qëndrimin tuaj në emër të shoqatës që përfaqësoni lidhur me projektligjin që sapo votuam!

Keni në dispozicion 3 minuta kohë.

Burrë – Prona e paluajtshme e shtetit nuk ka asnjë regjistër publik, asnjë vendim, asnjë ligj ku të përcaktohet se si është fituar prona e paluajtshme e shtetit.

Pra, nuk ka asnjë dokument shtetëror të përcaktojë pronën e paluajtshme të shtetit, mënyrën si e ka fituar dhe si e mbron atë.

Neni 3 ka lidhje me veprimtarinë administrative për përfundimin e proceseve transitorë të pronësisë dhe për sigurinë juridike. Ky ligj vë në diskutim pronat e ndara nga komisionet e kthimit të pronave, nga ATP-ja dhe Agjencia Kombëtare e Kthimit të Pronave për disa çështje, të cilat i konsideron se regjistrimi fillestar i një prone është fitues në lidhje me pronësinë mbi sipërfaqen, por, në kohën kur ligji nr.7501 ka vepruar, nuk kishte një ligj për kthimin e pronës dhe Kushtetuta e vitit 1998 për herë të parë pati efekt prapaveprues, duke vendosur që të shfuqizonte të gjithë ato ligje që ishin në kundërshtim me këtë Kushtetutë.

Nuk u shfuqizua ligji nr.7501, sepse e gjithë Gjykata Kushtetuese sot është në veting dhe ne nuk kemi Gjykatë Kushtetuese.

“Prona shërbyese” është një koncept, i cili është vendosur dhe sjell një konflikt me nenin 7. Germa “c” e nenit 7 sjell një konflikt, ju zoti kryetar nuk e diskutuat. Toka e ndarë me AMTP nuk ka qenë e llojit të zënë kadastral “truall”, “rërë “bregdetare” ose “plazhe”. Ju këtu nënkuptoni se do t’i njihni të gjitha pushtimet që kanë bërë fshatarët në pyje, në kullota dhe në livadhe. Këto do t’i konsideroni tani tokë bujqësore.

Neni 9 “Kur sipërfaqja që posedohet është më e madhe se ajo e përcaktuar”. Ju i jepni edhe 20% të sipërfaqes, kur në një vend tjetër thuhet: “Kjo sipërfaqe e tepërt i jepet një fshatari kur ajo është e pamenaxhueshme në njësinë vendore”. Pra, njësia nuk e ka të menaxhueshme për t’ia dhënë dikujt tjetër. Ajo i jepet 20%, 20% është 2, 3, 5 mijë metra, është një sipërfaqe e menaxhueshme dhe ky është një konflikt.

Neni 52 “Bashkërendim në proceset kalimtare”. “Agjencia e Trajtimit të Pronës ka detyrim që të trajtojë prioritetet, kërkesat për njohje dhe kompensim fizik të subjekteve të ligjit nr.133/2015 në territoret ku ASHK-ja zbaton proceset kalimtare sipas kriterëve të këtij ligji”. Cilat do të jenë VKM-të që do ta detyrojnë një njësi vendore të mos u japë këtyre personave certifikatën e pronësisë? Këto të fundit po jepen në mitingjet që bën Kryeministri nëpër fshatra. Ata turren dhe marrin certifikatën e pronësisë. Po ata që janë në konflikt me të kush do t’i pengojë tani? Nuk pengohen, sepse ata vazhdojnë t’i japim politikisht këta tituj.

Neni 57 “Pasaktësitë hartografike dhe gabimet e tjera materiale”. Ky nen i ka dhënë prioritet këtij ligji duke shkelur vendimet e mëparshme të organeve shtetërore, siç mund të jetë një vendim i Agjencisë së Kthimit të Pronave dhe ky ligj e zgjidh *apriori* me 2 teknikë, me dy topografë apo edhe me një vendim të komunës. Ky është ligj prioritar për Kushtetutën. Kundrejt ligjit që ia ka kthyer pronarit, në vend që ta zgjidhë gjykata këtë, ju ia keni lejuar ligjit. Ky është një prioritet që nuk i takon këtij ligji dhe duhet të rishikohet.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Sula!

Kur ta merrni tekstin e zbardhur të projektligjit që sapo u votua dhe që kolegët e kishin në tavolinë në draftin integral, shumë nga këto probleme që ju ngritët janë adresuar. Kur ta merrni draftin integral do ta shikoni që disa nga shqetësimet që ju ngitet janë reflektuar në projektligj.

Po, zoti Lame.

Artan Lame - Faleminderit!

Me përgjegjësinë e një funksionari shtetëror garantoj se ky projektligj nuk ka asnjë pikë ku direkt apo indirekt cenon problematikat e kthimit, kompensimit të pronave dhe të ish-pronarëve, përkundrazi përmirëson minimalisht dy elemente.

E para, situatën e regjistrimit të pronave të tyre.

E dyta, shton fondin e kompensimit të ish- pronarëve, pasi copat e tokës midis parcelave të ndara me ligjin nr.7501 që shiten kalojnë si para në fondin e kompensimit të ish- pronarëve.

Shqetësimi që ka qenë në projektligjin origjinal ishte përfshirja e AMTP-së në atë agjenci, u hoq dorë, pikërisht për të mos krijuar stres edhe ide të gabuar se po prekej problematika e ish-pronarëve.

Ulsi Manja – Ju lutem, kolegëve në sallë, pasi do ta votojmë në tërësi projektligjin!

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Raporti që do të shoqërojë projektligjin të jetë gati për seancën e ditës së enjte.

Faleminderit relatorëve dhe kolegëve për përfshirjen në diskutimin e këtij projektligji!

Ulsi Manja - Kalojmë te projektligji “Për kadastrën në Republikën e Shqipërisë”.

Do të ndiqet e njëjta praktikë edhe për votimin e ligjit “Për kadastrën”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në tavolinë kanë qenë, por ia kanë marrë njëri-tjetrit, sepse ky është drafti i depozituar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, mos mbani nga 2-3 drafte mbi tavolinë!

Zoti Fino, zonja Bushka besoj se do të punojmë me tabelën që kemi në tekstin integral.

Klotilda Bushka – Të punojmë me tekstin integral, por ka ardhur edhe raporti nga Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese. Unë do t’ju sugjeroja të veprojmë me tabelën për rekomandimet tona, por do të citojmë edhe ato që do t’i shikojmë të arsyeshme për t’i futur. Tashmë i kemi të qarta, por për efekt procedure do të duhet t’i themi.

Ulsi Manja - Dakord.

Neni 1 “Objekti” i projektligjit.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino - Pse e quajnë ligjin “Për kadastrën”, kur kadastra është thjesht matje tokë në gjuhën e mëparshme, kur mund të bëhej fare kollaj ligji “Për pasuritë e paluajtshme”?

Ulsi Manja – Zoti Lame, mund të bëni një historik për titullin e projektligjit.

Artan Lame – Faleminderit!

Nuk do të mbështetesh vetëm tek argumenti i zotit Fino, te përkthimi *adlitteram* i termit, sepse po të niseshim nga kjo gjë, edhe termi “deputet” në raport me funksionin e sotëm dhe me origjinën nuk ka fare lidhje. Por nuk nisemi thjesht nga kjo, por nga origjina e përdorimit në Shqipëri në tendencën e përgjithshme të krijimit të sa më shumë elementeve që ingranojnë historinë e shtetit të sotëm shqiptar me historinë e përgjithshme, të 100 - vjetorit të shtetit shqiptar, ku ne u munduam të ringjallim edhe një term të përdorur tradicionalisht, të heqim dorë nga termi “ZRPP”, që nuk ngjit te njerëzit dhe nuk e njohin atë. Askush nuk e di nga ata që e përdorin se çfarë është ZRPP-ja. Termi “kadastër” është një term që edhe fshatari më i humbur i këtij vendi e ka dëgjuar dhe e di se çfarë përmbledh. Kjo ishte arsyeja kryesore që na nxiti drejt saj dhe në vijim në sensin e unifikimit të terminologjisë, flasim për kadastër fiskale, pyjore e kështu e mardhë. Pra, përdorim të njëjtin term që përdoret edhe në institucionet e tjera për të njëjtën tipologji problematikash.

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Lame!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kreu I “Dispozita të përgjithshme”.

Ndiqui edhe tabelën që keni përpara.

Neni 1.

Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka - Ka një ndryshim termi: fjala “funksion” zëvendësohet me fjalën “shërbim”.

Ulsi Manja - Dakord. Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Neni 2 nuk ka ndryshim. Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3 “Përkufizimet”. Ka ndryshim përmbajtja.

Klotilda Bushka – Është ndryshuar pothuajse e gjithë përmbajtja, sepse përkufizimet janë rregulluar për t’iu përshtatur përmbajtjes së neneve në vijim dhe është vendosur rendi alfabetik.

Ulsi Manja Kush është dakord me nenin 3 sipas propozimeve të bëra nga relatorët? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4 “Parimet e përgjithshme për shërbimin kadastral”.

Neni 4 ndërron vend me nenin 5, ky është sugjerimi i relatorëve pa ndryshim përmbajtjeje. Kush është dakord me nenin 4? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 5 ndërron vendet me nenin 4. Te ky nen ndryshon formulimi i pikës 1. Po ashtu ndryshon edhe formulimi i pikës 3 sipas tabelës, variantit që keni në tekstin e integruar të projektligjit. Kush është dakord me nenin 5? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kreu II “Agjencia Shtetërore e Kadastrës”.

Neni 6 “Statusi dhe financimi i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”

Për pikën 1 relatorët sugjerojnë që pas fjalës “Kryeministrit” të shtohet togfjalëshi “që krijohet me këtë ligj”. Ndryshon përmbajtja e germës “a”. Kush është dakord me nenin 6?

Klotilda Bushka – Meqenëse thamë se do t’u referohemi edhe sugjerimeve të Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese duam të heqim shprehjen: “Në mbështetje të politikave të Këshillit të Ministrave”. Është një sugjerim i këtij komisioni. Jeni dakord që ta heqim? Sipas formulimit tonë dhe të hiqet kjo sipas sugjerimit të Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 6 me sugjerimet e bëra nga relatorët dhe me sugjerimin që sapo bëri tani kolegja Bushka? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7 nuk ka ndryshime nga varianti i qeverisë. Titulli “Organizimi dhe drejtimi i agjencisë”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8 “Këshilli drejtues”

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino - Kam 2 sugjerime. Jam dakord me zonjën Bushka, është në rregull. Të hiqen fjalët “kabineti i Kryeministrit”, sepse më duken jo korrekte. Të themi: “Këshilli drejtues përbëhet nga 7 anëtarë. Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave. Ministria përgjegjëse për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe përfaqësuesi i Kryeministrit”. Kryeministri mund të vendosë cilin të dojë atje.

Kam një pyetje tjetër për zotin Lama, nëse ma mbush mendjen jam dakord: pse kohëzgjatja e kryetarit të këshillit është 2 vjet? Cila është arsyeja? Është fjala për kryetarin e bordit. Jeni 7 vetë, ku atje bën pjesë edhe drejtori i i përgjithshëm, që do të zgjidhet dhe kryetari i bordit do të ketë një mandat dyvjeçar. Cila është arsyeja që i keni vënë një mandat kaq të shkurtër

dyvjeçar, kur ai thjesht do të mbledhë bordin, do të bëjë disa mbledhje me propozimet e drejtorit, të administratës?

Ulsi Manja - Po, zoti Lame.

Artan Lame - Kam përshtypjen se duhet të jetë siç është te ligji aktual i ZRPP-së, atje është 2 vjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, se nuk mbarova!

Po të shkojmë te ligji i vitit 2012, që pse e kanë vënë atje, por pa dashur të hyjmë aty, në momentin e parë nuk më duket se ka ndonjë problem. Nëse e gjykoni të zgjaten, nuk kam ndonjë vërejtje, ndoshta thjesht kanë pjesëtuar një mandat qeverisjeje, duke u dhënë dy herë mundësinë.

Alket Hyseni – Ka një kohezion me parimin e shoqërive tregtare, ku ka një organizim të këtyre këshillave. Kryetarët e këshillave mbikëqyrës kanë një mandat në ligj 3 vjet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka lidhje me mandatin qeverisës.

Ulsi Manja – A ka ndonjë propozim konkret?

Bashkim Fino – Propozimi ynë konkret është që të vihet fjala “Përfaqësuesi i Kryeministrit” dhe të hiqet fjala “Kabineti” dhe te pika 3 e nenit 8 mjafton fjalia “Kryetari i këshillit drejtues nuk mund të jetë njëkohësisht drejtor i përgjithshëm”. Kjo nuk ka nevojë për zgjatje, sepse një kryetar këshilli mund ta heqësh edhe për 6 muaj dhe mund ta shkarkosh fare. Cila është arsyeja që ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave u duhet kohë të heq mandatin? Unë jam për heqjen e kësaj fjalie.

Ulsi Manja – Në pikën 3 ju keni cituar ligjin për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike. A janë përcaktuar në këtë ligj mandatet me kohëzgjatje apo jo? Nëse ka referenca mandatesh...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Ja çfarë thotë pika 3: “Mënyra e zgjedhjes së kryetarit, si dhe mbledhja dhe marrja e vendimeve, e rregulluar sipas ligjit nr. 8480 për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, këtu mund të vëmë edhe fjalinë “Kryetari i këshillit nuk mund të jetë drejtor i përgjithshëm” dhe mbaron. Ndërkohë që shohim edhe ligjin e viti 1999, atje e ka kohëzgjatjen...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame - Është hequr referimi te ligji i vitit 1999.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Për nenin 8 relatorët kanë bërë një sugjerim, ku në fund të pikës 1 thuhet të shtohet paragrafi: “Këshilli i Ministrave shkarkon dhe emëron anëtarët dhe kryetarin e këshilli drejtues”. Nëse ju do t’ia lini 2 vjet mandatin, a ndodh që Kryeministri ose Këshilli i Ministrave ta shkarkojnë para afatit dy vjet?

Po, zoti Hyseni

Alket Hyseni – Meqë jemi këtu, shoh një formulim të tillë ku thuhet: “Anëtarët duhet të kenë formim profesional në fushat e inxhinierisë, gjeodezisë e me radhë”.

Së pari, gjeodezia është inxhinieri, mbaron inxhinieri me profil gjeodet dhe nuk mund ta lëmë vetëm inxhinier, sepse ka inxhinieri ushqimore, inxhinier mjedisi, që nuk kanë lidhje me pronësinë, dhe ka disa lloje inxhinierish. Pra, do të themi: “Në fushat e inxhinierisë së ndërtimit të gjeodezisë”. Nëse ke thënë inxhinier, ke thënë edhe gjeodez. Prandaj, është më mirë të themi :”Inxhinieri ndërtimi...

Artan Lame- Sepse përjashtohet fakulteti që prodhon specialistë të dytë...

Alket Hyseni – Gjeologji minierash nuk ka lidhje me pronat e paluajtshme.

Ulsi Manja –Kemi një përfaqësues të shoqatës së gjeodetëve të Shqipërisë.

Përfaqësues nga Shoqata e Gjeodezisë – I nderuar kryetar,

Të nderuar anëtarë, shoqata e gjeodetëve të Shqipërisë është e vetmja shoqatë në territorin e Shqipërisë e regjistruar pranë organeve tatimore....

Ulsi Manja – Unë po ju pyes si ekspert, jo statutin e shoqatës. Ka edhe 7 shoqata të tjera, që duan të flasin. Të lutem , më jepni një përgjigje si ekspert!

Përfaqësues nga Shoqata e Gjeodezisë – Pranë fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit është dega inxhinieria gjeodet, e cila merret me kadastrën, ndërsa inxhinierët e tjerë si: inxhinieri gjeoteknik, i mjedisit, i ndërtimit, i urbanizimit e të tjerë nuk merren me kadastrën. Këtë fakt e vërteton dhe libri i gjeografisë së klasës së 7, i cili thotë: “Duke ditur masat e sakta të këndeve, gjeodetët mund të hartojnë harta dhe plane me një saktësi të madhe”. Ky fakultet 50 vjet më parë ka pasur inxhinierë topografë, që sot nuk ekziston ai term. Për shkak të emërtimeve të ndryshme ka pasur inxhinierë topogarfë, inxhinierë topogjeodetë dhe inxhinierë gjeodetë, që në vende të ndryshme quhen gjeometër, të cilët merren vetë me matjen. Gjeodezia është shkencë që merret me matjen e tokës në, nën dhe sipërfaqen e saj.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Artan Lame – Sqarimi që bën shoqata është në nivel teknik të punonjësve, ndërsa këtu po flasim për bordin drejtues të agjencisë, që është e domosdoshme që të ketë edhe ekonomistë. Kështu që nuk mund ta kufizojmë vetëm te topografët, mjafton të themi në fushën e inxhinierisë.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 8?

Bledar Çuçi – Më duket sikur kjo pikë[, ku flitet për drejtorin e përgjithshëm dhe kryetarin e këshillit, duhet të jetë e kundërta, sepse këshilli drejtues zgjedh drejtuesin e vet, pra kryetari i këshillit drejtues duhet të zgjidhet nga këshilli, pasi kryetari është i barabartë aty, ndërsa drejtori i përgjithshëm duhet të zgjidhet nga Këshilli i Ministrave, por Këshilli i Ministrave duhet të zgjedhë drejtorin e përgjithshëm, ndërsa kryetari i këshillit drejtues është i barabartë me një organ kolegjal dhe e zgjedh vetë këshilli drejtues. Kryetarin e këshillit drejtues e zgjedh Këshilli i Ministrave, pa lidhje fare, sepse nuk ka asnjë kompetencë. Pse duhet të zgjedhësh me akt normativ një njeri pa asnjë kompetencë, por që është i palës së barabartë me një organ kolegjal dhe drejtorin e përgjithshëm e zgjedh këshilli drejtues?! Pra është anapulla dhe duhet të jetë e kundërta: “Këshilli drejtues zgjedh kryetarin e vet”, sepse ai është organ kolegjal dhe zgjedhin kryesuesit, ndërsa drejtorin e përgjithshëm e emëron Këshilli i Ministrave nga këshilli drejtues.

Ulsi Manja Po, zoti Lame.

Artan Lame – Ju faleminderit!

Ka një lapsus këtu. Drejtorin e përgjithshëm e emëron kryeministri ose Këshilli i Ministrave, ndërsa anëtarët e bordit i emëron Këshilli i ministrave, të cilët mbledhen dhe zgjedhin kryetarin e këshillit.

Person – Zoti kryetar, kam diçka për të shtuar te pika kur flitet për inxhinierinë gjeodetë. Në qoftë se do të fusim në kadastër inxhinierë të fushave të tjera[, do të krijohet një situatë....

Ulsi Manja – Po flasim për anëtarë në këshillin drejtues.

Person – Inxhinieri i minierave do ta drejtojë politikën në këshillin drejtues për hartat?

Ulsi Manja – Nuk ka për të shkuar inxhinier minierash në këshill drejtues, sepse nuk të lë zoti Lame.

Ulsi Manja – A jeni dakord me sugjerimet e bëra për nenin 8, me formulimet e bëra nga kolegët? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 9, “Drejtori i përgjithshëm”. Nuk ka asnjë ndryshim nga varianti i qeverisë.

Zoti Fino fjala për ju.

Bashkim Fino – Unë kam një sugjerim. Në pikën 3 të nenit 9 unë nuk jam dakord që të vihet në ligj sesi do të jetë një zëvendës. Unë jam dakord me pikën ku thuhet: “Drejtori i përgjithshëm mbështetet nga zëvendës drejtorët e përgjithshëm” dhe të hiqet fjalia “Një prej të cilëve është drejtues i strukturës përgjegjëse për ankim”. Pra, unë them që aty të thuhet: “Zëvendës drejtorët e përgjithshëm emërohen nga këshilli drejtues me porosi të drejtorit të

përgjithshëm”, pastaj sesi do të ndahet puna e dy drejtorëve e vendos këshilli drejtues, sepse nuk mund t’i lësh vetëm njërit përgjegjësinë në ligj. Unë jam dakord me këtë sugjerim: “Drejtori i përgjithshëm mbështetet në veprimtarinë e tij nga zëvendësdrejtorët e përgjithshëm. Zëvendësdrejtorët e përgjithshëm emërohen nga këshilli drejtues me propozim të drejtorit të përgjithshëm”.

Ulsi Manja – Relatorja e ka fjalën.

Klotilda Bushka – Në fakt, është diskutuar që kjo është pjesë e strukturës, e cila miratohet me vendim të Kryeministrit, por, duke pasur parasysh që në kuadër të procesit të ankimimeve dhe në kuadër të një procedure të re që të fusim në ligj të drejtën e subjekteve të ankimojnë vendimet e zyrove vendore, duhet që një nga funksionet e larta drejtuese të zyrës së kadastrës, që do të jetë zëvendësdrejtori i përgjithshëm, të jetë titullari i degës së ankimimeve. Kjo është një pjesë e garancisë juridike për ankimet administrative dhe për këtë arsye është kërkuar që në ligj të jetë si pjesë e organizimit strukturor, sepse duhet të kemi patjetër dy zëvendësdrejtorë të përgjithshëm. Kjo është një kërkesë, e cila vjen nga drafti i qeverisë është sqaruar në relacion, prandaj e kemi lënë të tillë.

Alket Hyseni – Së pari, për sa i takon ankimit administrativ, është shumë e rëndësishme që ky proces është delikat dhe nuk mund t’ia japim edhe drejtorit tagrin e vendimmarrjes dhe nëndrejtorit tagrin e pranimit të ankimit administrativ.

Klotilda Bushka – Jo, e ka vetëm drejtori, i cili e drejton...

Alket Hyseni – Klodi, ti po thua që nëndrejtori do të drejtojë drejtorinë e ankimimit, por ai nuk mund të ankimojë kur është në një shkallë inferiore. Prandaj unë mendoj që drejtori i ankimimit, nëse doni t’i japim pavarësi, duhet të emërohet nga këshilli, jo nën varësinë drejtorit.

Ulsi Manja – Këto janë çështje strukturash dhe, kur të mbledhet këshilli drejtues, le ta miratojë strukturën si të dojë.

Bashkim Fino – Më nxirrni një ligj që është miratuar, që e kemi cilësuar dhe kemi thënë që zëvendësdrejtori duhet filan. Asnjë ligj nuk e ka kështu. Ne kemi thënë drejtori i përgjithshëm, nëndrejtorët e të tjerë dhe ua kemi lënë në dorë atyre që ta zgjedhin, por që ta cilësosh se duhet nëndrejtori me patjetër është totalisht gabim.

Artan Lame - Zoti Fino, skema e zgjedhur është skema e ligjit turk dhe ligji turk...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja- Turqia ka arkivat më të vjetra në botë.

Artan Lame – Nëse flasim për kadastrë, duhet t'i heqim kapelën Turqisë. Skema turke ka gati paralele me kadastrën një bord ankimimi, i cili është pjesë e institucionit, por është gati e pavarur, sepse i jepen funksione...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse ia lemë drejtorit të përgjithshëm, ai do të vërë një zar të vetin atje dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Për nenin 9, “Drejtori i përgjithshëm” kush është dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino nuk bëri propozim.

Bashkim Fino – Unë thashë të hiqet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord me nenin 9, sipas variantit të paraqitur nga qeveria. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Neni 10 “Strukturat e vartësisë”, sipas variantit të qeverisë. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Zoti Fino.

Bashkim Fino – Zyrat vendore janë struktura në varësi të drejtorëve vendorë dhe ngrihen pranë njësisë administrative-territoriale. Kjo presupozon ndarjen e re territoriale të 61 bashkive, sepse kam lexuar që në disa nene të tjera ka një formulim tjetër. Pra, ndarja e njësisë administrative-territoriale, pra zyrat vendore do të ngrihen në 61 bashki?

Ulsi Manja – Po, zoti Lame.

Artan Lame – Është një nga pikat që ka të bëjë direkt me shërbimin ndaj qytetarëve. Sot kemi 21 drejtori të ALUIZNI-t dhe 35 të ZRPP-së. Meqenëse boshti i institucionit të ardhshëm është ZRPP-ja e sotme dhe meqenëse ka shtrirje territoriale më të gjerë, është ALUIZNI që do të shkojë si fillim te zyrat e ZRPP-së, me tendencën që sa më shpjet të shkojmë në 61 bashki, pra në çdo bashki duhet të ketë sportel shërbimi.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Lame!

Po, zoti Çuçi.

Bledar Çuçi – Pra, zyrat vendore do të administrojnë edhe dokumentacionin për procedurat administrative për ligjin që sapo kaluam, pra për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë. Ku janë limitet e këtyre, se aty te ligji sikur s’kishim?

Artan Lame – Nuk ju kuptova.

Bledar Çuçi – Drejtoritë vendore do të lëshojnë certifikata, domethënë kanë tagrin e një zyre vendore. Ne sot miratuam një ligj të tërë për procesin se si do të trajtohen të gjitha këto për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë. Ku janë limitet dhe deri ku janë të drejtat e këtyre zyrave vendore në lidhje me legjislacionin e ri? Për legjislacionin normal ata kanë ligjin e regjistrimeve. Tani ka dalë një ligj i ri... Po e ngre si problem, sepse do t'ju lindë juve nesër, pra do të shkojë drejtori i zyrës dhe do të thotë se nuk e ka kompetencë direkte, siç e ka për regjistrimin e pasurive....

Artan Lame – Për të dyja ligjet e ka tërësisht kompetencën drejtori vendor në të gjithë sektorët e veprimit.

Bledar Çuçi – Problemi është se sot për regjistrimin e pasurive të paluajtshme është e qartë fare se çfarë bën drejtuesi i zyrës. Te ligji i ri që miratuam unë nuk pashë të kishim përcaktime strikte për zyrën vendore, pra çfarë bën njëra apo tjetra. Këtu ne ngremë zyrat vendore. Te ligji, i cili i referohet organizimit të vjetër të zyrave të hipotekës është e thënë, pra tani bie ajo pjesa e marrëdhënies deri ku shkon e drejta e drejtorit të zyrës vendore në lidhje me administrimin e zonave. Pra, them se ka nevojë për një saktësim këtu.

Ulsi Manja – Konkretisht, zoti Çuçi, çfarë do të sugjeronit?

Bledar Çuçi – Edhe këtu duhet importuar, siç është te ligji për regjistrimin e pasurive, se çfarë bën drejtuesi i zyrës vendore.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, t'i marrim me radhë, se jemi te strukturat e vartësisë.

Po, zoti Pjetri.

Valdrin Pjetri – Zoti Çuçi, lidhur me ato që ju propozoni, në nenet e mëposhtme janë të sanksionuara se cilat janë detyrat e zyrave vendore. Në fakt, disa detyra do t'ua shtojmë, të cilat nuk janë parashikuar.

Bledar Çuçi – Këtu lind problemi juridik.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Kolegë, sa herë të merrni fjalën për nene të caktuara, ju lutem të bëni një propozim konkret, sepse kështu do të mbetemi, duke qenë se ligji ka 70 e ca nene dhe shqetësime mund të ketë secili prej kolegëve.

Ne e votuam nenin 10.

Neni 11 “Marrëdhëniet e punës, kriteret, statusi dhe rekrutimi i punonjësve”. Nuk ka vërejtje. Kush është dakord me nenin 11 sipas variantit të qeverisë? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 12 “Hierarkia administrative e akteve kadastrale”. Nuk ka propozime. Kush është dakord me nenin 11 sipas variantit të qeverisë? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet neni 12 sipas variantit të qeverisë.

Kalojmë te kreu III “Sistemi kadastral”.

Neni 13 “Të dhënat kadastrale”.

Klotilda Bushka – Kemi një përmbajtje të re. Ndërkohë, edhe nga Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese kemi disa ndryshime të teknikës legislative, për shembull, të hiqet fjala “shkresor; fjala “letër” të hiqet nga kllapat; pas fjalës “kullotë” të shtohet fjala “pyjet” dhe në pikën 7 fjala “strikt” të hiqet. Në fakt, komisioni i është referuar tekstit të projektligjit që ka sjellë qeveria. Duke qenë se ne e kemi ndryshuar, ne pranojmë të heqim fjalën “strikt” dhe të heqim nga kllapa fjalën “letër”, por pjesën tjetër mendoj se e kemi referuar.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Kush është dakord me nenin 13, me përmbajtjen e sugjeruar nga relatorët dhe me një pjesë të sugjerimeve të Komisionit të Veprimtarive Prodhuese? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet neni 13.

Neni 14 “Zonat e regjistrimit dhe zona kadastrale”.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Pika 3 e nenit 14 mos bie ndesh me pikën 2 të nenit 10? Në pikën 3 të nenit 14 thuhet: “Për çdo zonë apo grup zonash regjistrimi ngrihet një drejtori vendore kadastrale”. Ndërkohë që te neni 10 thamë se do të ngremë zyra kadastrale, pra zyra vendore sipas njësive administrative territoriale. Kjo do thotë se për çdo grup zonash regjistrimi ngrihet një drejtori vendore?

Ulsi Manja – Po, zoti Lame.

Artan Lame – Atëherë, Shqipëria ka 61 bashki dhe 3057 zona kadastrale. Kjo do të thotë që çdo bashki ka një numër të caktuar zonash kadastrale, diku 200, diku 300, diku 700 e kështu me radhë. Natyrisht që çdo bashki ka një numër të plotë zonash. Logjika e kësaj është se grupit të zonave kadastrale, që përmban një bashki, do t’i përgjigjet edhe një drejtori e caktuar.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ta mbarojë Lamja, pastaj ta marrë fjalën kush ta kërkojë.

Artan Lame – Ky ishte shpjegimi.

Ulsi Manja – Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Nuk ka nevojë për shpjegim. Tendenca është që do të shkojë një drejtori për çdo bashki, por në parim çdo bashki mund të jetë 1 ose disa zona kadastrale. Ky termi i tretë

na ndihmon për fazën fillestare që nuk do të jemi te bashkitë, por diku një drejtori do të ketë 100 grupe zonash, diku tjetër mund të ketë 400 grupe zonash, por nuk ka lidhje kjo dhe kundërshti me termin e bashkive. Sot nuk kemi një drejtori -një bashki, por sot do të jemi një drejtori- një grup zonash që varion si numër, derisa të vijë një ditë që të jemi një drejtori-një grup zonash, por që përputhen edhe me bashkitë.

(Diskutime pa mikrofon)

Bashkim Fino – Janë 3057 zona në të gjithë Shqipërinë, të ndara për 61 bashki. 1 bashki e vogël mund të ketë 7 zona, 1 bashki e madhe mund të ketë 250 zona. Jam dakord me konceptin që një grup zonash do të kenë drejtorinë përkatëse, por thelbi do të jetë pika 2 e nenit 10.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, sapo e miratuam. Thelbi është që në çdo bashki (do të shkojmë drejt asaj, sepse nuk jemi tani) do të ngrihet një drejtori kadastrale. Në momentin kur i vë pikën 2 të nenit 10 dhe thua “Në çdo njësi administrative-territoriale që kemi bërë ne me reformën”, nuk mund të thuash që në çdo zonë ose grup zonash ngrihet të paktën një drejtori vendore. Jo, more zotëri, konceptoje ndryshe, pra që një zonë apo një grup zonash janë brenda një bashkie, por jo ashtu, se bie ndesh. Në qoftë se më thua që të dyja janë konvergjente, janë të njëjta, jam dakord.

Alket Hyseni – Janë komplementare.

Bashkim Fino – Nëse janë komplementare, në rregull.

Artan Lame – Vërejtja e zotit Fino na tërhoqi brenda një fjalie në një gabim tjetër, pra që nuk ka sens të themi për çdo zonë, se nuk ka një zonë, një bashki. Pra, duhet hequr termi “për çdo zonë”, por “për çdo grup zonash regjistrimi”.

Klotilda Bushka – Duke qenë dakord me logjikën e përdorur deri tani, unë sugjeroj: “Drejtoria vendore përfshin një grup zonash regjistrimi.”

Ulsi Manja – Kush është dakord me sugjerimin e bërë për nenin 14?

Klotilda Bushka – Komisioni i Veprimtarive Prodhuese pika 2 e nenit 14, ku thuhet “Bashkësia e një sërë zonash kadastrale me vijimësi territoriale përbën zonën e regjistrimit” sugjeron të kalojë si përkufizim. Ne çmojmë se nuk mund të jetë përkufizim, sepse i gjithë neni 14 rregullon konceptin e zonave.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 14, me sugjerimin e bërë për pikën 3 nga zonja Bushka? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 14.

Neni 15 “Harta kadastrale”.

Jurgis Çyrbja – Kam një sugjerim, kryetar, aty ku thuhet “harta kadastrale duhet të tregojë detyrimisht” propozoj të shtohet edhe “sistemi koordinativ plus koordinatat përkatëse”.

Ulsi Manja – Te cila pikë?

Jurgis Çyrbja – Pra, te pika 3, germa “c” propozoj të shtohet “edhe sistemi koordinativ plus koordinatat përkatëse”, pra të shtohet si pikë më vete, germa “d”.

Ulsi Manja – Pra, kolegu Çyrbja propozon që në pikën 3 të nenit 15 të shtohet një germë “d” më vete me atë formulim që propozoi. Kush është dakord me nenin 15 bashkë me sugjerimin e bërë nga zoti Çyrbja? Kundër?

(Diskutime pa mikrofon)

Artan Lame – Mund të jetë me vend, por do të doja një moment reflektimi.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, të marrim një mendim!

Po, zoti Lame.

Artan Lame – Specialisti im po më thotë diçka, që më bën të mendohem edhe një herë. Të lutem, a mund të ma rithuash edhe një herë?

Ulsi Manja – Patjetër. Nuk e di sa eksperiencë ka specialisti në hipotekë, por ky zotëria që flet ka eksperiencë.

Artan Lame – Në cilin sistem janë koordinatat? Sot ZRPP-ja nuk i ka në sistemin gjeografik KRGJSH...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, se nuk bëj debat me ju. Në këtë moment i bie të bjerë i gjithë sistemi, pra, po e vumë sot...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Çyrbja, formuloje propozimin që ta hedhim në votë...

Jurgis Çyrbja – Propozimi im është: të shtohet sistemi koordinativ, plus koordinatat përkatëse, pra të jetë pikë më vete.

Artan Lame – Unë po ju them se aktualisht janë të paktën 4-5 sisteme koordinatave, e para cilin prej tyre do të vëmë? E dyta, sistemi i KRGJSH-së, që është i Shqipërisë, nuk përdoret nga ZRPP-ja, sepse nuk ka arritur ende ZRPP-ja ta aplikojë. Në këtë moment, në qoftë se e vëmë si detyrim të zyrës, që sot, praktikisht, e kemi nxjerrë jashtë lojë të gjithë hartografinë e ZRPP-së. Pa diskutim që duhet të ketë një qëllim se ku do të arrijë...

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Çyrbja, a tërhiqeni nga propozimi?

Artan Lame – Megjithatë, marr përsipër ta shohim bashkë, sepse është një gjë shumë e rëndësishme.

Jurgis Çyrbja – Është shumë teknik si përcaktim. Mund të rregullohet edhe dispozita transitore.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 15 sipas variantit të propozuar nga qeveria? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Për nenin 16 “Korrigjimi i gabimeve në të dhënat kadastrale”, nuk ka asnjë ndryshim nga varianti i qeverisë. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Për nenin 17 “Certifikata e pronësisë”, ka një sugjerim nga relatorët, ku ndryshon përmbajtja e nenit 17 sipas formulimit në tekstin integral.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 18.

Relatorët.

Klotilda Bushka – Ka dy ndryshime në pikat 1 dhe 2.

Ulsi Manja – Për nenin 18 “Certifikatat e humbura” sugjerohet të ndryshohen pikat 1 dhe 2, sipas formulimit në tekstin integral. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 19 “Aktet e tjera kadastrale”, edhe në këtë nen nuk ka ndryshime.

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet sipas variantit të qeverisë.

Në nenin 20 ka një sugjerim nga relatorët, ndryshon përmbajtja e pikës 2 të nenit 20. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 21 “Bashkimet dhe ndarja e dokumenteve mbi pronat kufitare me pronarë të njëjtë”. Për këtë nen nga relatorët sugjerohet të ndryshohet përmbajtja e pikës 3 sipas tekstit të bashkëlidhur.

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 21.

Kalojmë te kreu IV “Procesi i regjistrimit të titujve”. neni 22 “Regjistrimi i titujve të pronësisë”. Nga relatorët ka një sugjerim për ndryshimin e përmbajtjes së këtij neni.

Klotilda Bushka – Ndryshimi është për ta bërë më të qartë nga pikëpamja e teknikës legislative dhe për të dhënë nocionet e regjistrave të titujve të pronësisë.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 22 sipas propozimit? Kundër? Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Neni 23 “Pasojat juridike të regjistrimit”. Edhe në këtë nen ka një sugjerim, ku ndryshojnë përmbajtja e germës “b” të pikës 1 dhe përmbajtja e pikës 3, sipas variantit që bashkëshoqëron ligjin.

Urdhëroni!

Valdrin Pjetri – Zoti kryetar, në nenin 23 dua të shtoj një pikë. Nga ana teknike ne sot kemi shumë probleme. Kur lëshojmë një certifikatë pronësie, bëjmë 4-5 transaksione mbi këtë certifikatë pronësie, në transaksionin e pestë dhe të gjashtë specialisti shkon deri në origjinë të pronës, që pengon ofrimin e shërbimit të qytetarit. Kur lëshohet certifikata e pronësisë nuk mund të shkojë më në origjinën e pronës. Ky është problem teknik dhe i hasur shumë në zyrat tona.

Ulsi Manja – Ju lutem, na jepni një shembull konkret!

Valdrin Pjetri – Për shembull, një pasuri shitet disa herë: 4 herë, 5 herë, 6 herë dhe në rastin e 7 specialisti vendos që të shkojë në origjinën e pronës.

Vasilika Hysi – Çfarë do të thotë?!

Valdrin Pjetri - Do të shkojë te transaksioni i parë. Por, për sa kohë është lëshuar certifikata e pronësisë, është shitur: 4, 5, 6 apo 7 herë, nuk ka pse specialisti i zyrës të rikthehet në origjinë. Në momentin e parë, që certifikohet pasuria, duhet quajtur i mirëqenë fakti nga ana teknike.

(Diskutime pa mikrofon)

Ti ke 10 certifikata pronësie të lëshuara ndër vite dhe sot vjen ti për të shkuar tek origjina, sepse kjo bëhet pengesë dhe është tendencioze.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Pjetri!

Relatorja.

Klotilda Bushka – Në logjikë dhe në koncept është shumë e drejtë, sepse për sa kohë janë bërë disa transaksione, siguria juridike e atij titulli qëndron dhe nuk ka pse të preket nga punonjësi i institucionit. Është një çështje, e cila unë mendoj se e gjen zgjidhjen në veprimtarinë, në rregullat që rregullojnë veprimtarinë e një institucioni. Nuk mund t’ia japim zgjidhjen në ligj, sepse te neni që po flasim, flasim se çfarë detyrash ka institucioni, zyra

konkrete. Në qoftë se hyjmë se çfarë bën me origjinën e titullit në këto raste, i bie që të specifikojmë çdo veprim që bëhet nga kërkesat e qytetarit për një pasuri.

Për mendimin tim kjo ka të bëjë me procedurat e punës së zyrës. Kjo është një gjë që duhet të normohet me akt nënligjor. Po të doni që këtë gjë ta hapim si me çelës në ligj, ne mund të vendosim që procedurat e punës, së institucionit do të rregullohen, në mënyrë të detajuar nga rregullorja e punës që miratohet me vendim të bordit të këshillit siç e keni ju. Pra, nëse është kjo, unë këtë propozim kam.

Ulsi Manja – Ju thoni është çështje procedurale? Është procedurë e punës së përditshme të institucionit, rregull pune.

Pra, për nenin 23 “Pasojat juridike të regjistrimit”, ne kemi vetëm një sugjerim, për të ndryshuar përmbajtjen e germës “b” të pikës 1 dhe përmbajtjen e pikës 3.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 23.

Neni 24 “Regjistrimi i detyruar”.

Relatorja thotë se ndryshon titulli dhe përmbajtja e nenit. Titulli i nenit nga “Regjistrimi i detyruar” bëhet “Regjistrimi i detyruar dhe njoftimi i akteve”. Kush është dakord me nenin 24, sipas sugjerimeve të bëra nga relatorët? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 25.

Në nenin 25 vendoset titulli dhe ndryshon përmbajtja. Pra, kishim një nen pa titull, relatorët dhe grupi i punës e kanë titulluar nenin i 25 “Kërkesat për regjistrin dhe kamatëvonesat”, ku ndryshon edhe përmbajtja.

Kush është dakord me nenin 25 sipas këtij riformulimi? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 26 “Pamundësia për regjistrim”.

Te neni 26 sugjerohet që në pikën 3 togfjalëshi “zyra kadastrale” të zëvendësohet me togfjalëshin “drejtoria vendore e ASHK-së me urdhër të drejtorit”.

Kush është dakord me nenin 26, me sugjerimin e bërë nga relatorët? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Neni 27 “Vendosja e kufizimeve të përkohshme”.

Relatorja.

Klotilda Bushka – Te neni 27 kemi bërë vetëm një rregullim teknik në pikën 4.

Ulsi Manja – Neni 27, pika 4, togfjalëshi “mund të bëjë ankesë në gjykatë”, zëvendësohet me togfjalëshin “ka të drejtën e ankimit”.

Kush është dakord me nenin 27? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 28 “Garantimi i aksesit mbi ekstraktet”. Edhe në këtë nen propozohen ndryshime në pikën 5.

Urdhëroni!

Klotilda Bushka – Përveç ndryshimeve që kemi propozuar ne, si relatorë nëpërmjet grupit të punës, që në pikën 5 togfjalëshi “drejtori i përgjithshëm verifikon çdo 24 orë” zëvendësohet me “drejtoria e përgjithshme verifikon periodikisht”, kemi dy sugjerime, që ne i çmojmë të vlefshme për t’i marrë në konsideratë. Sugjerimi i parë vjen nga Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, i cili sugjeron që të shtohet, pas pikës 2, pika 2/1, me këtë përmbajtje: “Agjencia Shtetërore e Kadastrës siguron kushtet për krijimin, regjistrimin, administrimin dhe funksionimin e të dhënave dixhitale të pasurive të paluajtshme në sistemin e brendshëm të organizimit dhe të ndërveprimit me bazat e tjera të të dhënave shtetërore”. Në të njëjtin nen, po në pikat 2 dhe 3, ka sugjerime që vijnë po nga ky komision, por vijnë edhe nga deputetët e këtij komisioni, që kanë të bëjnë me të dhënat elektronike, të cilat duhen garantuar në saktësinë dhe në sigurinë e tyre duke iu referuar të gjithë shërbimeve të portalit e-Albania, që sot po jep Shqipëria. Kemi të bëjmë me shërbime, të cilat janë të reja, që kanë nevojë për kode sigurie, që kanë nevojë për standarde sipas legjislacionit në fuqi dhe sugjerohet që të shtohen këto pika: “Personave fizikë vendas apo të huaj u jepet kodi i hyrjes dhe e drejta e marrjes së ekstrakteve të të dhënave në mënyrë të drejtpërdrejtë vetëm nga portali e-Albania, duke garantuar teknikisht pamundësinë e manipulimit të saj nëpërmjet sistemit elektronik. Personat juridikë vendas apo të huaj, që kanë të drejtën për të pasur akses në portalin e-Albania, mund të marrin ekstrakte, dokumente elektronike pronësie me nënshkrim elektronik ose vulë dixhitale, në mënyrë të drejtpërdrejt, pasi kanë marrë pëlqimin e subjekteve që figurojnë të regjistruar si pronarë të pasurisë së paluajtshme”. Kjo u jep akses edhe noterëve, të cilët do të kenë të drejtën që të hyjnë në sistem, dhe shërbimeve të tjera publike, që kanë nevojë të ndërveprojnë me regjistrin e hipotekës, po e them të hipotekës në kuptimin që e kuptojmë të gjithë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Urdhëroni, zoti Pjetri!

Valdrin Pjetri –Kjo është në kuadër të *paperless*. Ne sot i kemi dhënë akses përmbartimit shtetëror , i kemi dhënë akses bashkisë, pra ato nuk duhet të dërgojnë më shkresa zyrtare, që

të presin një javë apo 10 ditë, por hyjnë *online* dhe kanë akses, pa pasur të drejtë të bëjnë modifikim, por vetëm të lexojnë statusin juridik të pasurisë për të marrë vendimet e tyre më pas.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Pjetri!

Kush është dakord me nenin 28 dhe me dy ndryshimet e bëra në pikën 5, ku togfjalëshi “drejtori i përgjithshëm verifikon çdo 24 orë” zëvendësohet me “drejtoria e përgjithshme verifikon periodikisht”, si dhe me sugjerimet e bëra nga Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, dhe për portalin e-Albania? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 29 “Kërkesa dhe afatet”.

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Mendoj se pika 4 e nenit 29 është e tepërt. Në pikën 3 thuhet: “Çdo kërkesë për shërbim kadastral që paraqet rregullisht trajtohet brenda 15 ditëve nga data e depozitimit”. Çfarë thotë pika 4?! “Në pamundësi drejtoria vendore njofton se do të trajtohet jo më pak se 15 ditë”, ndërkohë e rregullon pika 5? E dini pse e rregullon pika 5?! Në pikën 5 thuhet: “Këshilli i Ministrave miraton rregullat dhe procedurat e trajtimit të kërkesave”, mund ta vendosë atje, nuk ka nevojë për pikën 4.

Alket Hyseni – Në qoftë se e themi 15 ditë në ligj, si do të shkojë Këshilli i Ministrave ta shkurtojë.

Bashkim Fino – Nuk është shkurtim, e kuptuat gabim.

Në pikën 3 thuhet: “Zyra vendore për 15 ditë të kthen përgjigje ty si qytetarë.”

Alket Hyseni – Po kur nuk mundem?!

Bashkim Fino – Këshilli i Ministrave miraton rregullat dhe procedurat e trajtimit të kërkesave, kur ka raste që nuk kthehet përgjigja, do t’i thotë Këshillit të Ministrave.

Po të bëj një pyetje: po në qoftë se për 7 ditë nuk ke kthyer përsëri përgjigje? Sepse në pikën 4 thuhet: “brenda 7 ditëve, jo më pak se gjysma, duhet t’i kthesh përgjigje”. Pra, po nuk i ktheve përgjigje për 15 ditë, i jep kohë edhe 7 ditë të tjera. Po nuk i ktheve përgjigje për 7 ditë të tjera, çfarë do të bëhet?

Ulsi Manja – Urdhëroni, zoti Hyseni!

Alket Hyseni – Meqenëse e mora fjalën, por edhe meqenëse më bëri pyetjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Qëllimi ka qenë që të kornizojë një afat të caktuar, i cili mund të mos arrihet në ndonjë rast, por të mos ketë abuzivitet, pra ta lërë pa kufij. Si rregull afati është 15 ditë. Pika 4 ka pasur synimin që në raste pamundësie objektive... *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Për shembull, zyrat vendore funksionojnë me ndarje zonale, njëri nga personat që e kanë marrë praktikën në dorë, mund të sëmuret në limit të afatit, e kishte për ta dhënë ditën e 13 përgjigjen, ai u sëmur. Në këto raste ai nuk është në gjendje e ka gati praktikën, mbase duhet të ribëhet nga e para, sepse nuk e ka firmosur ai. Pra, në këto raste objektive, zyra i njofton personit, ku i thotë: “I nderuar qytetar, duke iu kërkuar ndjesë që nuk u përgjigjem për 15 ditë për arsye objektive, do të merrni përgjigje brenda një afati tjetër”. Ky ka qenë synimi. Por propozimi im është se këtë mund ta rregullojmë brenda pikës 3, duke thënë: “Trajtohet brenda 15 ditëve nga data e depozitimit dhe në asnjë rast jo më shumë se 21 ditë”.

Bashkim Fino – Kjo është tjetër gjë. Në rregull.

Alket Hyseni – Po thamë vetëm 15 ditë dhe më pas thua që Këshilli i Ministrave ta rregulloj këtë 7-ditshin, Këshilli i Ministrave nuk mund të shkelë afatin 15 ditë.

Ulsi Manja – Zoti Hyseni, përjashtimi të mos kthehet në normë, sepse mund të ketë drejtues të zyrave vendore që ja fut kafe ose raki me qofte dhe thotë kam arsye objektive, nuk përgjigjem brenda 15-ditëve!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë pika 4 shkrihet me pikën 3 dhe bëhet shtesa siç propozoi kolegu Hyseni: “Në çdo rast jo më vonë se 21 ditë”.

Kush është dakord me nenin 29, sipas propozimeve të zotit Fino dhe zotit Hyseni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 29.

Kalojmë te kreu V “Regjistrimi fillestar”.

Neni 30 “Fillimi i regjistrimit fillestar”. Në këtë nen ndryshon tërësisht përmbajtja e nenit. Përmbajtjen e nenit të ri lidhur me regjistrimit fillestar e keni në draftin integral.

Kush është dakord me nenin 30? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Për neni 31 “Konsultimi publik”, nuk ka vërejtje.

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Për neni 32 “Përfundimi i regjistrimit fillestar”, nuk ka vërejtje. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Për neni 33 “Trajtimi i ankesave”, nuk ka vërejtje. Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Te neni 34 “Regjistrimi fillestar i pasurisë publike” ndryshon titulli dhe përmbajtja e nenit dhe bëhet “Regjistrimi fillestar i pasurisë shtetërore” me përmbajtjen sipas tekstit.

Pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu VI “Trajtimi i mbivendosjes së pasurive. Neni 35.

Urdhëroni, zonja Bushka!

Klotilda Bushka – Nenet 35, 36 dhe 37 janë hequr, sepse kanë kaluar te ligji tjetër.

Ulsi Manja – Atëherë, unë duhet t’i votoj për t’i hequr nga teksti i projektligjit.

Nenet 35, 36 dhe 37, që përbëjnë të gjithë kreun e gjashtë, hiqen nga teksti i projektligjit dhe kanë kaluar te ligji “Për proceset kalimtare të përfundimit...

(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)

Ulsi Manja – ...të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu VII “Përmirësimi i regjistrit”, që fillon me nenin 38.

(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)

Titulli i nenit 38, ju lutem?

Bashkim Fino – “Përmirësimi i regjistrit”.

Klotilda Bushka – Nuk ka titull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Përmirësimi është pa titull?

Klotilda Bushka – Po, pa titull, sepse është sipas variantit të qeverisë.

Ulsi Manja – Atëherë, kush është dakord me nenin 38, sipas variantit të qeverisë?

Bashkim Fino – Do të bëhet ndryshimi i të gjithë nenit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Do të bëhet numërtimi i ri i neneve pas votimit të shfuqizimit të neneve nga 35-a deri te 37-a.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është pro?

Klotilda Bushka – Prit, t’i vëmë një titull, se nuk e paskemi parë!

Bashkim Fino – Në rregull jemi. Vazhdojmë me nenin 39.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Procesi i përmirësimit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po më ndiqni?

Meqenëse ky nen nuk është lëvizur, sepse në përmbajtje kemi qenë dakord me versionin që ka sjellë Këshilli i Ministrave, por meqenëse nuk paska një titull, sugjeroj t'i vëmë një titull këtij neni: “Procesi i përmirësimit të regjistrimit”.

(Deputeti Fino flet pa mikrofon.)

(Deputeti Hyseni ndërhyr pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Përmirësimi i regjistrimit, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Është titulli i kreut.

Ulsi Manja – Jo, kreu titullohet “Përmirësimi i regjistrimit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Në qoftë se titulli ka po këto fjalë, e vëmë “Procedura e përmirësimit”? Fjala kyçe duhet vënë patjetër.

(Deputeti Shameti ndërhyr pa mikrofon.)

Klotilda Bushka – Atëherë, ta vëmë “Kuptimi i procesit të përmirësimit”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – “Procesi i saktësisimit të kufijve” mund të ishte shumë e saktë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse thuhet që përmirësimi është procesi i saktësisimit të kufijve, të sipërfaqeve të pasurive të paluajtshme, pasqyrimin të drejtë në hartën kadastrale të pozicionit gjeografik, si dhe saktësisimit të të dhënave të regjistrimit të pasurive.

Klotilda Bushka – Nuk është vetëm saktësim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Atëherë, ngelet “Përmirësimi i regjistrimit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Mirë është.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Përmirësimi...

Alket Hyseni – Tjetër gjë është regjistrimi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Propozimi është “Përmirësimi i regjistrimit”. Kush është dakord me nenin 38 me titullin “Përmirësimi i regjistrimit”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 39, ku ndryshon numërtimi i nenit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Ç'rëndësi ka?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Rregullohen referencat në pikën 3 dhe ndryshon përmbajtja e pikës 5 të nenit 39.

Klotilda Bushka – Parimet.

Ulsi Manja – Po, janë parimet e procesit të përmirësimit.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 40.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te ky nen ndryshon numërtimi dhe vendoset një titull i nenit 40, i cili bëhet: “Nivelet e përmirësimit të regjistrimit”. Kush është dakord me nenin 40? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 41 “Rregullat e përmirësimit për pasuritë e llojit tokë”.

Nuk ka sugjerime për nenin 41. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 41, sipas variantit të qeverisë.

Neni 42 “Rregullat e përmirësimit për ndërtesat”. Nuk ka propozime për këtë nen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 42, sipas variantit të qeverisë.

Kalojmë te neni 43.

Klotilda Bushka – Nuk ka ndryshime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Neni 43 nuk ka titull.

Alket Hyseni – Të dyja këto mund të futen në një, se nuk...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 43, sipas variantit të qeverisë?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 44. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu VIII “Regjistrime të veçanta”, i cili fillon me nenin 45 “Regjistrimi i kontratës së shitjes”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga relatorët sugjerohet të ndryshohet përmbajtja e pikës 2 të këtij neni, sipas formulimit që është në tekst. Kush është dakord me nenin 45?

(Deputeti Çyrbja ndërhyr pa mikrofon.)

Po, zoti Çyrbja.

Jurgis Çyrbja – Propozoj të shtohet një pikë në nenin 45, në të cilën të thuhet: “Kontrata e shitjes me kusht nuk sjell ndryshim apo përfitim për sa kohë nuk është realizuar dhe plotësuar kushti”.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – E ka Kodi Civil.

Nejse, nuk prish punë: “përsëritja është mëma e dijes”, thonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Pjetri.

Valdrin Pjetri – Zoti kryetar, kam një propozim për titullin e kreut të tetë “Regjistrimet e veçanta”. Sot regjistrim të veçantë quajmë ato zona ku nuk kanë fare regjistrim fillestar dhe regjistrimi i veçantë kryhet nga kryeregjistruesi. Propozoj të ndryshojmë vetëm terminologjinë “risjell të drejtat reale”.

Vasilika Hysi – Kush tha që është e drejtë reale?

Valdrin Pjetri – Por kontrata e shitjes...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse regjistrimi i veçantë ka tjetër kuptim sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – ...kuptimin sot me termin.

Valdrin Pjetri – Shikojmë termin, sepse regjistrimi i veçantë është tjetër terminologji e përdorur sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Pjetri...

Artan Lame – Ndoshta nuk u kuptua, sepse është pak teknike...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Po, zoti Lame.

Artan Lame – Ndjesë, se e mora fjalën pa leje!

Sot termi “regjistrim i veçantë” përdoret për një kategori të veçantë regjistrimesh në terren. Kur nuk janë hedhur të gjitha zonat, bëhet regjistrimi për të gjithë fshatin dhe njërit fshatar, që e do patjetër, se do të bëjë shitje, i bëhet regjistrim i veçantë. Kjo kategori quhet regjistrim i veçantë. Në një kohë kur këtu ky kapitull ka kuptim komplet për tjetër gjë regjistrimesh, duhet ndërruar termi, pra të mos e përdorim edhe këtu termin “regjistrim i veçantë”, kjo është logjika.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Nëse do të ecim me këtë logjikë, formulimi i kreut mbetet të jetë “Regjistrime të veçanta”. Më kuptoni? Sepse ju do të vazhdoni me këtë metodë pune për rastet e regjistrimeve të veçanta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Ideja është se titulli i kreut ka lidhje me disa lloj regjistrimesh. Po të shohim, kemi regjistrimin e kontratës së shitjes, kemi pjesëtimin, kemi regjistrimin e vendimit të gjykatave...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund ta themi edhe “Llojet e regjistrimeve” dhe e mbyllim.

Valdrin Pjetri – Sepse regjistrimi i veçantë do të vazhdojë përsëri, pasi kemi ende zona që nuk janë në sistem sot.

(Deputetja Bushka flet pa mikrofon.)

Alket Hyseni – Jo, Klodi, i ke me zëra. Po të shohësh...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Hyseni, mua më duket se formulimi i kreut të tetë “Regjistrime të veçanta” i përmbledh të gjitha llojet e regjistrimeve që ka poshtë teksti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse do të vendosim llojet e regjistrimeve të veçanta, kam përshtypjen se do...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame – Atëherë, e tërheq shpjegimin. Jam i bindur se edhe kryeregjistruesi do të më..

Ulsi Manja – Ju lutem, ndizni mikrofonin!

Artan Lame – Edhe një herë, e tërheq shpjegimin, sepse regjistrimi i veçantë që bëjmë tek ai fshatari, po e quaj atë, termi i plotë i tij është “regjistrim fillestar i veçantë”. Kështu që, e lëmë termin këtu “regjistrime të veçanta”, sepse qëndron për kreun, ndërsa ai vetë të quhet “regjistrim fillestar i veçantë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Duke e emërtuar kreun “Regjistrime të veçanta”, të krijohet përshtypja sikur këta po i shkëpusim nga regjistrimet normale dhe po bëjmë disa regjistrime të veçanta, të cilat janë përjashtime nga rregulli. Ndërkohë, qëllimi i këtij kreu është numërtimi i disa proceseve regjistrimesh, që janë: një, dy, tre, dhjetë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në thelb janë kontrata.

Disa mund të mos jenë të mirëfilltë, sepse janë vendime gjyqate...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund ta themi edhe “Regjistrimi i titujve”.

Artan Lame – Por nuk janë të gjithë tituj.

Alket Hyseni – Tituj janë, edhe vendimi i gjykatës është titull.

Artan Lame – Po them se nuk janë të gjitha tituj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Dakord, se mund të jetë edhe sigurim padie.

Artan Lame – Ajo listë nuk është shteruese.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Por nuk mund të thuhet: “Regjistrime të veçanta”.

Artan Lame – Dakord. A keni propozim?

Alket Hyseni – Kam pra, dhe atë po them që titulli të vihet: “Regjistrimi i titujve dhe akte të tjera”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Qëllimi është për të evidentuar se cilat akte po regjistrohen, bie fjala, shitja.

Ulsi Manja – A t’ju bëj një pyetje? Çfarë na ndryshon...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë e prish titullin e kreut kështu siç është?

Alket Hyseni – Ta them unë se çfarë.

Ulsi Manja – Ma thoni.

Alket Hyseni – Ja t’jua shpjegoj.

Ulsi Manja – Më jepni një shembull, që do të sjellë problematikë nesër në praktikë.

Alket Hyseni – T’jua ilustruj me një shembull të thjeshtë?

Ulsi Manja – Po.

Alket Hyseni – Pyesni anëtarë të veçantë të komisionit këtu, zoti kryetar, dhe do ta kuptoni se cili është kuptimi i regjistrimit të veçantë.

Ulsi Manja – Sapo e tha kryeregjistruesi i Shqipërisë.

Alket Hyseni – Nëse këtu ke anëtarë të veçantë, atëherë e kupton se çfarë është regjistrimi i veçantë. Dakord? Përveç Adnorit, që është i veçantë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Këtu ka shumë të veçantë, por problemi është se unë kam një autoritet shtetëror që e kam thirrur këtu edhe për ta pyetur se çfarë është regjistrimi i veçantë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë këtu kam kryeregjistruesin e Shqipërisë.

Alket Hyseni – Kryeregjistruesi e tha dhe ishte dakord që duhet hequr si term.

Ulsi Manja – Tani, kryeregjistruesi jep një propozim që është përjashtues. A ka një propozim më komplementar?

Alket Hyseni – E thashë, por nuk më paskeni dëgjuar, zoti kryetar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Hyseni, ju propozuat formulimin: “Regjistrimi i titujve të pronësisë dhe akteve të tjera”.

Alket Hyseni – Jo e titujve, i titujve, pra jo titujve të pronësisë.

Por, dëgjo, që të kishim tituj dhe regjistrime të veçanta, ky formulim do të duhej të vinte pas një titulli “Regjistrimet e zakonshme”. Ne nuk kemi ndonjë kre për regjistrime të zakonshme, që të kemi edhe një kre për regjistrime të veçanta. Ky ishte argumenti që unë dhashë. Por...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Lame...

Alket Hyseni – ...për orën e vonë, unë do t’ju mirëkuptoja, le ta quani. Por...

Bashkim Fino – Pse të mos e vendosim titullin këtu thjesht “Regjistrimet” dhe fillojmë...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Uh, nuk qenkan të gjitha! Po tani, edhe ashtu, edhe kështu...!

Ulsi Manja – Ju lutem!

Bashkim Fino – Kjo “e veçantë” është si mbiemër. Pra, të vendosim një titull “Regjistrimet” dhe këtu i ke me gjithë nene: regjistrimi i kontratës së shitjes, regjistrimi i kontratës së dhurimit e me radhë.

Ulsi Manja – Zoti Fino...

Bashkim Fino – Thoni “Regjistrimet” dhe e keni në rregull, se ky është titulli i të gjithë kreut!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ka shumë të drejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Qëndron.

Bashkim Fino – Pra, është më mirë propozimi që bëj unë...

Alket Hyseni – Sepse nuk cenon asnjë...

Bashkim Fino – Titulli i kreut të jetë “Regjistrimet”, pra vetëm kaq, pa fjalët “i veçantë”, dhe pastaj vazhdojnë nenet me radhë. Janë me nëntituj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky është propozimi im, që ndihmon edhe Alketin.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Zoti Lame, ka një propozim që të hiqet fare fjala “e veçanta” dhe të lihet “Regjistrimet”. Pra, titulli i kreut të jetë “Regjistrimet”.

Artan Lame – Nuk shprehem dakord, pasi ky kre nuk flet për të gjitha regjistrimet, por vetëm për regjistrimet e veçanta, pra për një tipologji të caktuar. Domethënë, ky kre nuk është shterues.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Cilat janë regjistrimet e zakonshme, zoti Lame?

Po na sqaruat cilat janë... Më të zakonshme se kontrata e shitjes nuk ke, o drejtor, kontrata e shitjes është titulli më i zakonshëm që regjistrohet!

Bledar Çuçi – Pse nuk e vini “Regjistrime të detyrueshme”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Pjetri...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi?

Klotilda Bushka – Si e kemi sot?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ligji aktual e ka “Regjistrime të veçanta”.

Valdrin Pjetri – Vetëm “Regjistrimet” mund të rrijë mirë, pasi ka disa lloje regjistrimesh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Zoti kryetar, propozimi është që titulli i kreut të jetë: “Llojet e regjistrimeve”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Përsëriteni edhe një herë, ju lutem, se nuk e kishit mikrofonin të ndezur.

Bashkim Fino – Titulli i kreut të tetë të jetë “Llojet e regjistrimeve”, duke vijuar neni 45 “Regjistrimi i kontratës së shitjes”, dhe e zgjidhim problemin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë disa lloje këto tani. Ç'rëndësi ka?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu nuk i gjen dot kurrë. Pastaj kreu është ai, nuk humbet gjë.

Ulsi Manja – Ju lutem!

Zoti Lame, ju kemi thirrur si specialist këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino!

Si e ka ligji aktual këtë procedurë?

(Deputeti Hyseni flet pa mikrofon.)

Artan Lame – Ju lutem!

Alket Hyseni – Nëse është shumë mirë në ligjin aktual, e lëmë si në ligjin aktual.

Ulsi Manja – O, zoti Hyseni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame – Ju lutem!

Ulsi Manja – Zoti Hyseni, ju lutem, se unë mund ta ndërpres mbledhjen dhe nuk votohen as ditën e enjte këto!

Problemi është ky...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem!

Tani, t'i lëmë radhë njëri-tjetrit të flasë...

Alket Hyseni – Dakord.

Ulsi Manja – ...që të gjejmë një dakordësi si ta numëtojmë, më saktë, si ta titullojmë kreun.

Nëse do të flasim të gjithë njëherësh, nuk e zgjidhim dot këtë gjë!

T'i dëgjojmë zotërinjtë Lame dhe Pjetri, për të kaluar pastaj në votimin e propozimeve konkrete që keni ju, që ta ndajë vota këtë në fund: do të ngelet siç është, apo siç e propozoni ju? Prandaj jemi këtu me kuorum.

Zoti Lame, keni ndonjë propozim?

Artan Lame – Atëherë, ju bëtë një pyetje që mua më bllokoi dhe...

Ulsi Manja – Zhblllokohuni tani dhe jepni përgjigjen.

(Diskutime në sallë)

Artan Lame – Në përgjigje të pyetjes suaj: “Çfarë do të ndodhë në terren po e lamë kështu?”, nuk do të ndodhë asgjë. Pse? Sepse me këtë nivel hierarkik nuk merret qytetari, por

merren gjykatësi, juristi dhe regjistruesi. Pra, është e kotë t'i hyjmë, pasi nuk do të ngatërrohet njeri me këtë nivel. Le ta lëmë kështu siç është.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur vjen puna te hallet, qytetari është në nivelin e nënligjit apo i nënpikës. Pra, nuk ndryshon asgjë.

Ulsi Manja – Pra, propozimi i qeverisë është të mbetet siç është.

Vazhdojmë me propozime konkrete nga kolegët, për të vijuar me votimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Propozimin tuaj, zoti Hyseni, do ta hedh direkt në votë.

Alket Hyseni – Propozoj formulimin “Regjistrime të titujve dhe akteve”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, a ka mundësi ta hedhim në votim?

(Deputetët Hyseni dhe Fino flasin pa mikrofon.)

Zoti Fino...! Zoti Hyseni, e bëtë propozimin?

Alket Hyseni – A mund ta shpjegoj propozimin?

Ulsi Manja – Urdhëroni!

Alket Hyseni – E bëra këtë propozim në korrigjim dhe në vijim të propozimit të zotit Fino, sepse në thelb janë lloje, por për të mos sjellë konfuzionin meqenëse kemi edhe regjistrimin fillestar, si lloj, edhe regjistrimin përfundimtar, thashë ta titullojmë kreun “Regjistrime të titujve dhe akteve”, pasi të gjithë këta janë tituj dhe akte. Pa një akt nuk regjistron asgjë dhe pa një titull nuk regjistron asgjë. Dakord?

Mendoj se nga pikëpamja leksikore dhe juridike është e saktë. Nga ana tjetër, kundërshtoj fort termin “Regjistrime të veçanta”, për sa kohë që konfondon dhe lë të kuptojë se ka edhe regjistrime të zakonshme, që, në fakt, këto janë regjistrimet e zakonshme.

Nëse keni ndër mend të veçoni ndonjë regjistrim, hajdeni ta diskutojmë, por regjistrime të veçanta nuk mund të quhen ato që janë më të zakonshmet, si regjistrimi i titujve më të zakonshëm: i kontratës së shitjes e të tjerë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame – Në qoftë se nuk ka propozim, a mund të them diçka?

(Deputetja Bushka ndërhyr pa mikrofon.)

E gjetëm një term.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të vihet “Regjistrimi i titujve dhe akteve të tjera”.

Ulsi Manja – Këtë propozoi zoti Hyseni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ishit këtu, apo nuk ishit këtu?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, përfundimisht, titulli i kreut të tetë propozohet të bëhet “Regjistrimi i titujve dhe akteve të tjera”. Në rregull, por mbajeni mendjen në mësim të paktën kur bëni sugjerime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, kush është dakord me nenin...?

Në fakt, kishte edhe një propozim nga kolegu Çyrbja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Kush është dakord me titullin...?

Valdrin Pjetri – Nëse mundem, zoti kryetar, kam një propozim të fundit këtu, gjithnjë nga ana teknike, duke qenë se kemi pasur të bëjmë shumë edhe me anën teknike. Të shtojmë edhe një pikë tjetër, ku të themi: “Për pasuritë që kanë barrë dhe duan t’i shesin, të merret pëlqimi i palës që ka barrën”, që është banka në këtë rast.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – E ka Kodi Civil.

Ulsi Manja – Më falni, se tani jemi në votimin e titullit të kreut të tetë!

Kush është dakord me propozimin për titullin e kreut të tetë që të bëhet nga “Regjistrime të veçanta” në “Regjistrimi i titujve dhe i akteve të tjera”? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Bashkim Fino – Miratohet.

Ulsi Manja – Ndryshohet titulli i kreut të tetë. Pra, miratohet.

Bashkim Fino – Viojmë me nenin 45.

Ulsi Manja – Kalojmë te neni 45 “Regjistrimi i kontratës së shitjes”. Ndryshon përmbajtja e pikës 2 të nenit 45, sipas formatit bashkëlidhur tekstit të projektligjit. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 46. Ndryshon titulli dhe numërtimi i nenit, pra titulli “Regjistrimi i kontratës së dhurimit dhe heqja dorë nga e drejta e pronësisë” zëvendësohet me “Regjistrimi i kontratës së dhurimit”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tom Doshi – A mund të bëj një ndërhyrje këtu për kontratën e dhurimit? Çfarë parashikoni për sa u përket taksave?

Ulsi Manja – Pra, lidhur me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Valdrin Pjetri – Jo, i jap unë përgjigje deputetit Doshi.

Për sa i përket ndryshimit, siç është rasti i kontratave të dhurimit, kemi një udhëzim të ministrit të Financave dhe asaj të Drejtësisë, që parashikon pjesën e tatimit. Ju pyesni për pjesën e tatimit, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është e parashikuar në udhëzimin e dalë para pak kohësh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tom Doshi – Për aktin e dhurimit paguhet taksë?

Valdrin Pjetri – Po, taksohet.

Tom Doshi – Nuk është e drejtë. Nuk e ka asnjë vend i botës.

Vetëm në Shqipëri paguhet taksë për pronën që i dhuron fëmijës.

Valdrin Pjetri – Keni të drejtë. Për sa i takon brezit të parë ose të dytë është menduar që të bëhet një ligj tjetër që kjo kategori të mos jetë subjekt tatimi.

Tom Doshi – Kur keni menduar ta bëni, sepse ligjin do ta kalojmë sot? Kemi mundësi të bëjmë ndërhyrje.

Ulsi Manja – Bëhet me ligjin e taksave kombëtare.

Valdrin Pjetri – Kjo që thoni ju, zoti Doshi, qëndron, pasi po mendohet që në brezat e parë ose të dytë të mos ketë taksim. Por në këtë ligj nuk e bëjmë dot.

Ulsi Manja – Për sa kohë nuk bëhet në këtë ligj, por te ligji i taksave kombëtare, të shikohet ...

Tom Doshi – Asnjëherë nuk ka për t’u bërë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të gjithë jemi familjarë dhe me fëmijë. Për shembull, ti, Bashkim, ke dëshirë t’i dhurosh shtëpinë djalit, që është martuar dhe duhet të paguash taksë. Kjo nuk është e drejtë.

Ulsi Manja – Kalojmë te votimi i nenit 46.

Kush është dakord me nenit 46, me sugjerimet e bëra? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Neni 47.

Në nenin 47, pika 3, togfjalëshi “duhet detyrimisht të ketë” zëvendësohet me “përmban”. Në pikën 4, togfjalëshi “zyra kadastrale” zëvendësohet me “drejtoria vendore”.

Kush është pro nenit 47 me këto ndryshime? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Kalojmë te neni 48. Nuk ka ndryshime nga varianti i qeverisë.

Klotilda Bushka – Kemi rënë dakord t'i pranojmë Komisionit të Veprimtarive Prodhuese një sugjerim: pas pikës 1 të shtohen pika 1\1 dhe 1\2 me këtë përmbajtje: “Zyra e kadastrës korrigjon ose përditëson të dhënat kadastrale për pasuritë e paluajtshme në bashkëpronësi të dy bashkëshortëve, të fituara gjatë martesës para hyrjes në fuqi të këtij ligji, në rast se kjo kërkohet me shkrim nga bashkëshorti që nuk është i regjistruar dhe vërtetohet nga certifikata e gjendjes familjare në kohën kur është fituar pasuria. Paragrafi i parë dhe i dytë i këtij neni zbatohen për regjistrimin e pasurive të legalizuara, si dhe për regjistrimin e kontratës së sipërmarrjes, porosisë dhe premtimit për shitje kur këto të fundit synojnë kalimin e pronësisë së objektit në ndërtim në të ardhmen. Është një dispozitë me ndjeshmëri gjinore që kemi rënë dakord ta pranojmë.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 48 me sugjerimet e bëra nga Komisioni i Veprimtarive Prodhuese? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Neni 49. Regjistrimi i pasurisë së fituar me parashkrim fitues. Nuk ka ndryshim nga varianti i qeverisë.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Neni 50. Regjistrimi i kalimit të pronësisë me vendim gjykate ose akt administrativ. Nuk ka ndryshim nga varianti i qeverisë.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Neni 51. Regjistrimi i lejes së ndërtimit. Nuk ka ndryshim nga varianti i qeverisë.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Neni 52. Regjistrimi i karabinasë. Nuk ka ndryshime nga varianti i qeverisë.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Neni 53. Regjistrimi i kontratave të sipërmarrjes, porosisë apo premtim shitjeje. Te neni 53 ndryshon përmbajtja e pikës 3 sipas relatorëve dhe në fund të pikës 4 shtohet një fjali me këtë përmbajtje; “Veprimet juridiko-civile që bien ndesh me këtë pikë dhe me parashikimet e Kodit Civil nuk regjistrohen”.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Neni 54. Regjistrimi përfundimtar i ndërtimeve të reja. Ka një propozim për t'u hequr pikat 4 dhe pika 6 e nenit 54. Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Neni 55. Regjistrimi i mjediseve të përbashkëta në ndërtesa. Këtu sugjerohet të ndryshohet vetëm pika 3 me përmbajtje sipas draftit.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Neni 56. Regjistrimi i titujve që burojnë nga proceset kalimtare të pronësisë. Këtu ndryshon përmbajtja e nenit sipas relatorëve.

Bashkim Fino – Pikat 1 dhe 5.

Ulsi Manja – Po. Kush është dakord me nenin 56 sipas propozimit të bërë? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Neni 57. Regjistrimi i servituteve dhe ...

Bashkim Fino – Mos ka lidhje me nenin 54?

Klotilda Bushka – Po, ka.

Bashkim Fino – Duhet vënë ajo, pastaj kalojmë te neni 57.

Te neni 56 për regjistrimin e titujve e the përmbajtjen e nenit, bëre ndryshimet në pikën 1 dhe 5. Më pas...

Klotilda Bushka – Shtohet një nen i ri, Regjistrimi i heqjes dorë nga e drejta e pronësisë. Veprimi juridik e heqjes dorë nga e drejta e pronësisë regjistrohet në Regjistrin Publik të Pasurive të Pasurive të Paluajtshme në përputhje me dispozitat e Kodit Civil.

Bashkim Fino – Quhet neni 54, sepse kemi ndryshuar renditjen e neneve.

Pas nenit 56, që është në material (në fakt nuk quhet 56) shtohet neni i ri 54. Ne e kemi quajtur neni 54 duke pasur parasysh që hoqëm nja tre nene më parë.

Ti thuaj që pas nenit 56 shtohet nen i ri, e votojmë dhe...

Ulsi Manja – Shumë faleminderit që më ndihmove, por do ia lë ... punën e numërtimit të neneve.

Pas nenit 56 shtohet një nen i ri, që është neni 54 me përmbajtje...

Klotilda Bushka Ferhati - Regjistri i heqjes dorë nga e drejta e pronësisë. Veprimi juridik i heqjes dorë nga e drejta e pronësisë regjistrohet në Regjistrin Publik të Pasurive të Paluajtshme në përputhje me dispozitat e Kodit Civil.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Edhe njëherë të jem i qartë për këshilltarët dhe të gjithë ata që janë marrë me projektligjin. Mos numërtoni nene që hiqen dhe nene që shtohen, përveçse në përfundim të miratimit nen për nen të tekstit integral. Keni nga 20 vjet punë në Kuvend.

Kush është dakord me shtimin e nenit të ri? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 57. Regjistrimi i servituteve dhe shuarja e tyre. Nuk ka ndryshime nga varianti i qeverisë. Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 58. Regjistrimi i hipotekës dhe fshirja. Nuk ka ndryshime.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 59. Regjistrimi i kontratës së qirasë dhe enfiteozës. Nuk ka ndryshime nga varianti i qeverisë. Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Neni 60. Regjistrimi i së drejtës së parablerjes. Nuk ka ndryshime nga varianti i qeverisë.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 61. Regjistri i titujve në përdorim. Nuk ka ndryshime nga varianti i qeverisë. Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 62. Regjistrimi i prokurës. Nuk ka ndryshime nga varianti i qeverisë. Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 63. Regjistrimi i akteve të kryera në shtete të tjera. Përmbajtja e nenit ndryshon sipas variantit të propozuar nga relatorët.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 64. Regjistrimi i pemëve dhe i pasurive natyrore. Sugjerohet të hiqen pikat 3 dhe 4 të këtij neni. Kush është dakord me nenin 64, me sugjerimin që bën kolegu Hyseni? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kreu IX. Tarifat, Kundërvajtjet dhe Ankimi

Neni 65, Tarifat e shërbimit kadastral, nuk ka ndryshim nga varianti i qeverisë.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 66, kundërvajtjet, nuk ka ndryshime nga varianti i qeverisë. Pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 67, Ankimet kundër agjencisë, nuk ka ndryshim nga varianti i qeverisë. Pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 68, Kufizime të arsyeshme, ka një sugjerim nga relatorët. Ndryshon përmbajtja e pikës 1 të nenit 68 sipas variantit që keni në tabelë.

Pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kreu X . Dispozita të fundit dhe kalimtare.

Neni 69. Ngritja e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Nga relatorët ka një sugjerim për të ndryshuar përmbajtjen e pikës 2 të këtij neni sipas variantit në tekstin integral. Pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 70. Bashkëpunimi ndërinstitutional. Relatorët sugjerojnë të hiqet pika 3 e këtij neni. Pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Klotilda Bushka – Që t’u përgjigjemi kërkesave që kemi nga monitorimet që na bën MONEYVAL, grupi i veprimit financiar për parandalimin e pastrimit të parave dhe për luftën kundër krimit të organizuar, te ky nen do të vëmë një përkufizim për sigurimin e aksesit të drejtpërdrejtë mbi bazën dixhitale të Regjistratit të Pasurive të Paluajtshme për drejtoritë e hetimit tatimor të doganave, tatimeve, prokurorisë, SHISH-it, ILDKPI-së. Nuk do t’i shkruajmë si institucione specifike, por do të themi “me agjencitë ligjzbatuese që veprojnë në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit dhe krimit të organizuar”.

Ulsi Manja – Këtë e kemi detyrim nga MONEYVAL-i.

E kanë sugjeruar në takimin e djeshëm, por edhe sot në mëngjes që të ketë një përcaktim të ligji i kadastrës për masat financimit kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar.

Kush është dakord me nenin 70, duke hequr pikën 3 të këtij neni dhe duke bërë shtesën që propozoi relatorja? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Neni 71. Dispozitë kalimtare.

Relatorët propozojnë të ndryshohet përmbajtja e tij sipas variantit që propozohet.

Ju lutem, keni pak vëmendjen të dispozitat kalimtare, sepse këto janë dispozita që janë parë me vëmendjen e duhur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në këtë nen ndryshon përmbajtja sipas variantit në tekstin integral të projektligjit. Pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Neni 72. Përjashtimet dhe shuarja e kamatëvonesave në regjistrim. Nuk ka ndryshime nga varianti i qeverisë.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 73.

Sugjerohet nga relatorët të hiqet ky nen dhe përmbajtja e tij të bëhet pjesë e nenit 30.

Jeni dakord me këtë sugjerim? Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Pra, hiqet neni 73 dhe përmbajtja e tij bëhet pjesë e nenit 30.

Neni 74, “Baza e të dhënave”.

Edhe ky nen sugjerohet të hiqet, pasi përmbajtja e këtij neni është bërë pjesë e nenit 13 të këtij projektligji.

Kush është pro heqjes së këtij neni? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 75, “Aktet nënligjore” Ky nen nuk ka ndryshime nga varianti i qeverisë.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 76.

Klotilda Bushka – Tek aktet nënligjore duhet të vëmë një afat, se nuk kemi afat. Duhet 12 muaj.

Artan Lame - Siç e lamë te ligji tjetër, ta lëmë edhe këtu.

Ulsi Manja – Dakord.

Pra, të shtohet afati me 12 muaj te neni 76. Këtu sugjerohet të ndryshohet data e hyrjes në fuqi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, jemi te neni 76, “Shfuqizime”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Këtu shtohet pika 3.

Bashkim Fino – Kjo pikë nuk më shkon fare. “Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit “Për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme” qëndrojnë në fuqi dhe zbatohen për aq sa është mundur, deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore në zbatim të këtij ligji.”

Klotilda Bushka – A mund ta sqaroj, zoti Bashkim?

Po, sepse për sa kohë do të bëhet procesi i shkrirjes dhe për sa kohë nuk kanë dalë ende aktet nënligjore, se i kemi lënë 12 muaj në dispozicion për të nxjerrë aktet e reja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, kanë punë. Ideja është që zyra do të funksionojë për shërbimet, prandaj do të jetë e nevojshme të mbahen aktet nënligjore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Dakord.

Urdhëroni, zoti Hyseni!

Alket Hyseni – Duhet korrigjuar pikën 1 që të rrijë në fuqi pika 2, sepse kështu siç janë, ne shfuqizojmë ligjin dhe lëmë në fuqi aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.

Nuk mund të themi që shfuqizohet ligji i mëparshëm, por do të themi në pikën 1, që ligji i mëparshëm rri në fuqi për aq sa nuk bie ndesh me këtë ligj, deri në daljen e akteve nënligjore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më lejoni t’jua shpjegoj. Në pikën 1 ne themi: “Ligji nr. 33/2012, datë 21.3.2012, “Për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme”, i ndryshuar”, si dhe çdo dispozitë në ndonjë ligj tjetër që bie ndesh me këtë ligj, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji.”, ndërsa në pikën 2 themi: “Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit “Për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme”, qëndrojnë në fuqi dhe zbatohen për aq sa është mundur, deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore në zbatim të këtij ligji.”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk mund të rrinë në fuqi aktet nënligjore, kur është shfuqizuar ligji.

Ulsi Manja – Rrinë në fuqi aktet nënligjore në zbatim të ligjit të vjetër derisa të dalin aktet nënligjore në zbatim të ligjit të ri. Përndryshe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni - Ne do të themi se ligji nr. 33/2012...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Të lutem, Alket!

Nuk është hera e parë që veprojmë kështu. Kjo është tashmë një praktikë e konsoliduar e këtij Kuvendi. Pse shfuqizohet ligji nr. 33/2012? Bie nga fuqia, sepse do të hyjë në fuqi ligji që po miratojmë tani. Ai do të hyjë në fuqi në datën 1 shkurt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aktet nënligjore nuk dalin dot brenda 12 muajve. Kur të dalin aktet e reja nënligjore, sigurisht, do të veprojnë ato, por gjatë kësaj kohe transitore nga momenti që hyn në fuqi ligji i ri që po miratojmë sot, deri sa të dalin aktet e reja nënligjore, zyrat do të punojnë për aq sa është e mundur me ato akte nënligjore që janë në fuqi, sepse ky ligj shfuqizohet më 1 shkurt 2012 dhe kjo është një praktikë e konsoliduar. Është e kotë që e diskutojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni - Unë do të pranoj çdo logjikë që do të vendosni dhe jam dakord për të mirën e punës, por morali është tjetër gjë dhe ligji është tjetër gjë. Nëse ne shfuqizojmë një akt bazë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Parimi bazë i së drejtës është: nëse shfuqizojmë një akt bazë, të gjitha aktet që rrjedhin nga ai shfuqizohen automatikisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky është parim bazë. Prandaj unë propozova të korrigjojmë pikën 1 dhe të mos themi që ligji shfuqizohet, por në pikën 1 të themi: “Ligji nr. 33/2012, datë 21.3.2012, “Për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po prit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino, a doni të bëjmë 10 minuta pushim sa të flisni dhe më pas të vazhdojmë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Doshi,

E jap unë, nuk e kam fare problem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erdhëm deri te neni i fundit. E hedhim propozimin në votim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë problemi ka?

Alketi mendon se po u shfuqizua ligji, duhet të bien edhe aktet nënligjore. Në një moment të caktuar qytetarët do të kenë një vakum ligjor dhe do të presin 1 vit sa të dalin aktet nënligjore.

Alket Hyseni - Unë nuk thashë këtë. Nëse do të më citoni, më citoni saktë! Unë thashë se është parim bazë i së drejtës që kur bie akti kryesor, aktet e dala në zbatim të tij, bien. Thashë se meqë ka rënë ligji, kanë rënë dhe aktet nënligjore. Hajde të gjejmë si ta bëjmë që të mos krijojmë vakum. Si bëhet kjo? Mos ta shfuqizojmë automatikisht ligjin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ashtu?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po parimin nuk do ta shkelim dhe pa punë nuk do të rrimë. Atëherë, ose do të mbash pjesërisht ligjin e parë, ose do të fusësh pjesërisht ligjin e dytë në fuqi. Ky është propozimi.

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Fino!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni edhe ju një propozim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni!

Bashkim Fino – Po e them këtë, se jemi para votimit në tërësi. Neni i fundit është: “Ky ligj hyn në fuqi më 1 shkurt 2019.” Ky është një diskutim juridik, që ju nuk e zgjidhni dot. Nga pikëpamja logjike Alketi ka të drejtë. Kur një ligj i ri hyn në fuqi më 1 shkurt 2019, dhe kemi thënë në ligj që bie ligji i vjetër, automatikisht bien edhe aktet nënligjore të ligjit të mëparshëm. Kjo do të thotë që më 1 shkurt hyn ligji i ri, duhet që administrata të punojë me intensitet për të nxjerrë aktet nënligjore në funksion të ligjit të ri për të filluar puna për njerëzit. Kjo është logjika.

Tani mendojeni dhe gjeni një zgjidhje...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, zonja Bushka!

Zgjidhja është te paragrafi i dytë i nenit që nuk e keni lexuar: “Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit “Për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme” qëndrojnë në fuqi dhe zbatohen, për aq sa është e mundur, deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore.”

Pra, nëse këto akte nënligjore në fuqi nuk bien ndesh me ligjin e ri që hyn në fuqi më 1 shkurt 2019, do të zbatohen.

Atëherë, hedhim në votim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, zoti Doshi!

Tom Doshi – Kam një propozim: të shkurtojmë afatin. Pse ta lëmë me 31 janar? Ta vëmë më 10 janar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta vëmë në 10 janar, mbasi të vazhdojmë punën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Fino!

Nuk do ta votojmë në tërësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Doshi, zoti Hyseni,

A ka mundësi ta hedhim në votim propozimin tuaj? A i qëndroni propozimit?

Me votim ndahen gjërat, kur ka mendime të ndryshme. Zonja Hysi sugjeron që në paragrafin e dytë të hiqet fjala “zbaton për aq sa është e mundur” dhe të thuhet: “qëndron në fuqi dhe zbatohet për aq sa nuk bien ndesh me këtë ligj”.

Tani, nëse Alketi i qëndron propozimit të parë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Atëherë, kush është dakord me nenin 76, me sugjerimin e zonjës Hysi? Pro?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 77, “Hyrja në fuqi”

Ka një propozim: të hyjë në fuqi më 1 shkurt 2019.

Atëherë, kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 77.

Hedhim në votim në tërësi projektligjin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kë përfaqësoni ju?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë lidhje ka Shoqata e Gjeodetëve me këtë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë dua t’i trajtoj barabar të gjitha shoqatat. Megjithatë, fol për 3 minuta!

Të lutem, mos i bëj reklamë shoqatës tënde!

Përfaqësues i Shoqatës së Gjeodetëve – Faleminderit!

Jo, absolutisht.

Ulsi Manja – Vetëm 3 minuta, se ti ke ardhur për t’i bërë reklamë shoqatës tënde, jo për hallin tonë.

Ju lutem medieve, se kjo është reklamë!

Përfaqësues i Shoqatës së Gjeodetëve – Faleminderit!

Propozimet tona i kemi bërë të konsultuara në bashkëpunim me partnerët tanë europianë me seli në Bruksel, me Këshillin e Gjeodetëve të Europës. Në parlament do të keni mbas disa ditësh propozime konkrete të drejtuara nga Brukseli për projektligjin për kadastrën, të konsultuar tashmë me partnerët tanë europianë.

Ajo që dua të them sot para jush, janë 2 shembuj konkretë jo më larg nga Kosova dhe se Maqedonia. Keni zotin Murat Hoxha, ish-kryetar i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, inxhinier gjeodet; zotin Murat Meha, profesor, inxhinier gjeodet, ish-kryetar i Agjencisë Kadastrale të Kosovës; zotin Avni Ahmeti, drejtor aktual i Agjencisë Kadastrale të Kosovës, inxhinier gjeodet.

Shkojmë në Maqedoni, ku kemi zotin Afrim Hyseni, ish-kryetar i Agjencisë Kadastrale të Maqedonisë, inxhinier gjeodet; zotin Jakup Fetahi, ish-drejtues i Agjencisë Kadastrale të Maqedonisë, inxhinier gjeodet; zotin Boris Tuncevi, kryetar aktual i Agjencisë Kadastrale të Maqedonisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – A ka mundësi, zotëri?

Përfaqësues i Shoqatës së Gjeodetëve – Dy minuta harxhova. Kam e dhe 1 minutë të fundit dhe e mbarova.

Ulsi Manja – Po cili është problemi, zotëri?

Përfaqësues i Shoqatës së Gjeodetëve – Në nenin 10 të ligjit, e mirëkuptuam çështjen e presjes së inxhinierëve te posti drejtues, por në pikën 4 të nenit 10 kemi strukturat e varësisë. Në këtë nen nuk u hoq presja, zoti kryetar.

Ulsi Manja – Po pse do ta heqim presjen?

Përfaqësues i Shoqatës së Gjeodetëve – Sepse ju kur të keni një hall nesër në ASHK, të jeni të sigurt që do ta mbaroni punën, por kushërinjtë tuaj, në qoftë se atje do të jetë gjeologu apo inxhinieri i minierave, që po lënë gurët e çmuar e florinjtë dhe po hidhen te pronat, nuk kanë për të mbaruar punë kollaj, duke mos qenë profesionisti atje.

Ju lutem ta rishikoni këtë gjë!

Faleminderit!

Ulsi Manja – Shyqyr që kemi inxhinierë në Shqipëri një herë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka më të drejtë fjale!

Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë ishte ky, sekretari?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, s'kemi kohë!

Ju lutem, zoti Fino!

Mbani qetësi, se do të hedhim ligjin në votim!

Atëherë, kush është dakord në tërësi me projektligjin?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji “Për kadastrën në Republikën e Shqipërisë”.

Edhe ky projektligj së bashku me projektligjin tjetër “Për përfundimin e proceseve kalimtare në Republikën e Shqipërisë”, së bashku me raportet përkatëse do të votohen në seancë plenare.

Me votimin e këtij projektligji e mbyllim për sot mbledhjen e Komisionit të Ligjeve, duke ju falënderuar për durimin dhe për kontributin e dhënë në miratimin e këtyre dy projektligjeve, duke filluar nga zoti Fino, zonja Bushka, zoti Hyseni, zoti Lame, zoti Pjetri, zoti Doshi, këshilltaret e komisionit tonë dhe të gjithë grupin e punës, që ka punuar me këtë projektligj.

Falënderoj edhe zonjën Hysi!

Nesër...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artan Lame - Kryetar, ju falënderoj sinqerisht të gjithëve!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretare

Klotilda Bushka (Ferhati)

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit

Edlira Rama

